

Plani i Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet QARKU SHKODËR



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR VERSIONI DRAFT

Përgatitur nga:

Dr. Andrian VASO

31 Janar 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTIME	V
1. TË PËRGJITHSHME	1
1.1. Çfarë është VSM	1
1.2. Kuadri ligjor për VSM-në	2
1.3. Fazat kryesore të procesit të VSM-së	2
1.4. Metoda e punës	4
1.4.1. Të dhënat për përgatitjen e raportit të VSM-së	4
1.4.2. Metodologjia për përgatitjen e raportit të VSM-së	4
1.5. Procesi i hartimit dhe struktura e raportit të VSM-së	5
2. INFORMACION MBI PLANIN E MENAXHIMIT TË RREZIKUT NGA PËRMBYTJET – QARKU SHKODËR	7
2.1. Përmbledhje e procesit për hartimin e planit	7
2.1.1. Të përgjithshme	7
2.2. Hapat e punës dhe metodat për hartimin e planit	7
2.3. Marrëdhënia e PMRRP-së me strategjitë, programet dhe dokumentat përkatëse	9
2.3.1. Niveli ndërkombëtar - Kuadri i Direktivës së BE-së për Përmbytjet	9
2.3.2. Niveli kombëtar	10
3. GJENDJA E MJEDISIT DHE REGJIMET E MBROJTJES	12
3.1. Zona e projektit brenda pellgut të lumit Drin-Buna	12
3.2. Faktorët klimatikë	13
3.3. Sistemi Hidrik	15
3.4. Biodiversiteti	17
3.4.1. Informacion i përgjithshëm	17
3.4.1.1. Bashkia Shkodër	17
3.4.1.2. Bashkia Vau i Dejës	22
3.4.2. Zonat e mbrojtura	24
3.5. Popullsia dhe Shëndeti i Njeriut	26
3.6. Përdorimi i tokës	29
3.7. Trashëgimia kulturore	30
3.8. Peizazhi	32
3.9. Menaxhimi i mbetjeve	34
3.9.1. Menaxhimi i ujërave të përdorura	34
3.9.2. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta	35
3.10. Sektorët mjedisorë/socialë dhe legjislacioni përkatës sektorial	37
4. ZHVILLIMI POTENCIAL I MJEDISIT NË RAST TË MOSZBATIMIT TË PMRRP-SË – ALTERNATIVA “MOS BËJ ASGJË”	39
5. OBJEKTIVAT MJEDISORE LIDHUR ME ZBATIMIN E PMRRP-SË	40
5.1. Përcaktimi i Objektivave Mjedisore	40
5.2. Vlerësimi i përputhshmërisë së Objektivave të PMRRP me Objektivat Mjedisore të VSM	40
5.3. Analiza e përputhshmërisë së Objektivave të PMRRP me Objektivat Mjedisore të VSM	44
6. VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË ZBATIMIT TË PMRRP-SË	46
6.1. Masat e propozuara në PMRRP	46
6.2. Analiza e ndikimeve të pritshme	47
6.2.1. Popullsia dhe shëndeti i njeriut	47
6.2.2. Biodiversiteti	48
6.2.3. Toka	48
6.2.4. Uji	49
6.2.5. Faktorët klimatikë	49
6.2.6. Asetet materiale	49
6.2.7. Trashëgimia kulturore	50
6.2.8. Peizazhi	50
6.3. Përmbledhje vlerësimit të ndikimeve të zbatimit të PMRRP-së në OM-të	50

7.	NDIKIMET KUMULATIVE.....	57
8.	NDIKIMET NDËRKUFITARE	60
9.	MASAT ZBUTËSE	62
9.1.	Popullsia dhe shëndeti i njeriut.....	62
9.2.	Biodiversiteti.....	63
9.3.	Toka.....	64
9.4.	Uji.....	64
9.5.	Faktorët klimatikë	65
9.6.	Asetet materiale.....	65
9.7.	Trashëgimia kulturore.....	66
9.8.	Peizazhi.....	66
10.	MONITORIMI	67
11.	PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	72
11.1.	Përfundime	72
11.2.	Rekomandime specifike sipas sektorëve mjedisorë të VSM.....	74
11.2.1.	Popullsia dhe shëndeti i njeriut	74
11.2.2.	Biodiversiteti.....	74
11.2.3.	Toka.....	75
11.2.4.	Uji	76
11.2.5.	Faktorët klimatikë	77
11.2.6.	Asetet materiale.....	77
11.2.7.	Trashëgimia kulturore.....	78
11.2.8.	Peizazhi.....	78
12.	BIBLIOGRAFIA DHE REFERENCAT	80
13.	SHTOJCAT.....	83
13.1.	Shtojca 1 – Kuadri Institucional për Menaxhimin e Basenit Ujor Drin-Bunë.....	84
13.2.	Shtojca 2 – Konsultimet ndërkuftare: Praktika e Bashkeveprimit Ndërkufitar sipas Konventës ESPOO.....	91

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Fazat kryesore të procesit të VSM-së.....	2
Tabela 2: Lloji ose natyra e ndikimit të PMRRP-së në mjedis	4
Tabela 3: Gradat e përmasave të ndikimeve të PMRRP-së në arritjen e objektivave mjedisore	5
Tabela 4: Reshjet e pritshme 24-orëshe për periudha të ndryshme kthimi, rajoni verior i Shqipërisë	15
Tabela 5: Kullotat natyrore brenda territorit të Bashkisë Vau i Dejës	24
Tabela 6: Popullsia rezidente sipas gjinisë, grupmoshës dhe njësisë administrative.....	26
Tabela 7: Banorët që mund të preken (sipas skenarëve të përmbytjeve HQ010, HQ100, HQ500)	27
Tabela 8: Ndërtesat që mund të preken (sipas skenarëve të përmbytjeve HQ010, HQ100, HQ500).....	28
Tabela 9: Përdorimi total i tokës në Qarkun e Shkodrës	29
Tabela 10: Përdorimi i tokës në zonat që mund të përmbeten në pellgun e lumit Drin-Buna.....	29
Tabela 11: Objektet e rrezikut potencialisht të prekur të receptorit të rrezikut "trashëgimia kulturore" e diferencuar nga skenarët e përmbytjeve HQ010, HQ100, HQ500	32
Tabela 12: Sektorët mjedisorë/socialë dhe legjislacioni përkatës sektorial	37
Tabela 13: Objektivat e VSM.....	40
Tabela 14: Objektivat e VSM dhe pyetjet e vlerësimit	41
Tabela 15: Grafiku i verësimit të nivelit të përputhshmërisë mes objektivave	41
Tabela 16: Vlerësimi i përputhshmërisë së Objektivave të PMRRP me Objektivat Mjedisore të VSM	42
Tabela 17: Vlerësimi i përputhshmërisë së Objektivave të PMRRP me Objektivat Mjedisore të VSM - Përmbledhje.....	44
Tabela 18: Fushat e veprimit: struktura e katalogut të masave tip për PMRRP në Qarkun e Shkodrës	46
Tabela 19: Përmbledhje vlerësimit të ndikimeve të zbatimit të PMRRP-së në objektivat mjedisorë.....	52
Tabela 20: Krahasimi i masave tip specifike në varësi të përputhshmëri së tyre me OM-të, përqindjet e ndikimeve të vlerësuara.....	54
Tabela 21: Përputhshmëria në % e masave tip në lidhje me OM-të- Përmbledhje	55
Tabela 22: Aspektet dhe nën-aspektet në raport me përputhshmërinë në % të masave në lidhje me OM-të	55
Tabela 23: Modeli i programit të monitorimit të ndikimeve të konsiderueshme në mjedis nga PMRRP-ja	69

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Marrëdhëniet ndërmjet VSM-së dhe VNMS-së	1
Figura 2 - Cikli i MRRP-së sipas Direktivës së BE-së	9
Figura 3: Njësitë administrative të zonës së projektit: Bashkia Shkodër (e verdhë) me 7 NJQV dhe Bashkia Vau i Dejës me 1 NJQV në zonën e rrezikut nga përmbytjet	12
Figura 4: Harta e rrezikut nga përmbytjet në HQ500 të Qarkut Shkodër me 8 njësi administrative të projektit - bashkimi i Drinit dhe Bunës në jug të Shkodrës.....	12
Figura 5: Nën-pellgjet e pellgut të lumit Drin-Buna	13
Figura 6: Parashikimet vjetore të reshjeve [mm] pa dhe me ndryshime klimatike (skenari mesatar) në rajonin bregdetar verior të Shqipërisë (KTK, 2016)	14
Figura 7: Zona e degëve në Ultësirën Drin-Buna (INFRASTRUKTUR & UMWELT, 2013)	16
Figura 8: Harta e Biodiversitetit, Bashkia Shkodër	21
Figura 9: Harta e Zonave të Mbrojtura në zonën e projektit (MTM).....	25
Figura 10: Popullsia mesatare vjetore sipas grupmoshës dhe gjinisë në Qarkun Shkodër për vitin 2016. 27	
Figura 11: Zhvillimi demografik sipas gjinisë në Qarkun Shkodër 2016-2020	27
Figura 12: Popullsia e prekur nga përmbytjet e mundshme në Qarkun e Shkodrës ilustruar sipas NJA dhe skenarit të përmbytjeve (Burimi: PMRRP)	28
Figura 13: Popullsia e prekur nga përmbytjet e mundshme në Qarkun e Shkodrës ilustruar sipas NJA dhe skenarit të përmbytjeve (Burimi: PMRRP)	28
Figura 14: Tokë e kultivuar potencialisht e përmbytur në skenarët përkatës të përmbytjeve HQ010, HQ100 dhe HQ500 për njësi administrative të Qarkut Shkodër	30
Figura 15: Harta e trashëgimisë kulturore, Bashkia Shkodër.....	30
Figura 16: Kisha e vjeter e Shirqit (foto autori).....	32
Figura 17: Rrjeti KUZ për qytetin e Shkodrës	35
Figura 18: Vend depozitim ilegal Dajç (foto autori)	36
Figura 19: Vendgrumbullimet e mbetjeve në Bashkinë Vau i Dejës.....	36

SHKURTIME

AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
ARB	Agjencia për Basenet e Lumenjve
BK	Bordi i Kullimit
BMZ	Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin
DB	Drejtoria e Bujqësisë
DEM	Digital Elevation Model
DR	Drejtoritë Rajonale
DZHN	Departamenti për Zhvillimin Ndërkombëtar, Mbretëria e Bashkuar
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
GP-P	Grupi i Punës për Përmbytjet
HEC	Hidrocentral
IGJEUM	Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
IncREO	Rritja e Fleksibilitetit Përmes Vëzhgimit të Tokës
KESH	Korporata Elektroenergetike Shqiptare
KTK	Komunikimi i Tretë Kombëtar
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MRP	Menaxhimi i Rrezikut nga Përmbytjet
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
OM	Objektiva Mjedisore
PMRRP	Plani i Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet
REC	Qendra Rajonale e Mjedisit Shqipëri
SHN	Shoqëritë e Ndërtimit
SKMIBU	Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore
SZP	Strategjia për Zbatim të Përbashkët
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
VT	Vëzhgimi i Tokës
ZRF	Zvogëlimi i Riskut nga Fatkeqësitë
ZRSH	Zonë e Rëndësishme për Shpendët

1. TË PËRGJITHSHME

1.1. Çfarë është VSM

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një nga instrumentet kryesore për integrimin e shqetësimeve për aspektet mjedisore dhe të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin dhe vendimmarrjen strategjike. Ai është një mjet i njohur në nivel ndërkombëtar për planifikimin me pjesëmarrje i cili përdoret për të analizuar dhe integruar shqetësimet për aspektet mjedisore dhe shëndetësore në politikat, planet dhe programet e propozuara.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) mund të konsiderohet si “një proces sistematik dhe paraprak që ndërmerret me qëllim analizimin e efekteve mjedisore të planeve, programeve dhe masave të tjera strategjike të propozuara, si dhe integrimin e konkluzioneve në procesin e vendimmarrjes”.

Në përgjithësi, VSM zbatohet për planet, programet, politikat dhe dokumentet e tjera të një natyre strategjike (duke përfshirë mundësisht të gjitha dokumentet ligjore).




Figura 1: Marrëdhëniet ndërmjet VSM-së dhe VNMS-së

Burimi: Sustainability 2020, 12, 4039; doi:10.3390/su12104039

Qëllimi i VSM-së mund të përcaktohet si garantimi i informimit të vendimmarrjes strategjike nga aspektet mjedisore dhe integrimi i këtyre të fundit në të për të përkrahur zhvillimin e qëndrueshëm dhe të shëndoshë në aspektin mjedisor. Në veçanti, procesi i VSM-së mbështet autoritetet përgjegjëse për planet dhe programet, si dhe vendimmarrësit për të marrë në konsideratë:

- Tendencat, potencialin dhe kufizimet kryesore mjedisore me ndikim të ndërsjellë te plani apo programi
- Objektivat dhe treguesit mjedisorë me rëndësi për planin ose programin

- Efektet e mundshme mjedisore të një niveli të konsiderueshëm si rezultat i opsioneve të propozuara dhe i zbatimit të planit apo programit
- Masat për shmangien, reduktimin ose zbutjen e efekteve negative dhe ato për përforcimin e efekteve pozitive
- Pikëpamjet dhe informacionet nga autoritetet përkatëse, publiku dhe, sipas rastit, shtetet potencialisht të prekura

1.2. Kuadri ligjor për VSM-në

Kuadri ligjor për VSM-në përfshin në mënyrë të detyrueshme ligjin shqiptar për VSM-në, ndërkohë që, për qëllime koherence, nuk përjashtohet kuadri ligjor ndërkombëtar. Referencat ligjore përkatëse gjenden në vijim.

- ❖ **Ligji nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”**. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit dhe rishikimit të planeve a programeve me pasoja në mjedis. Ligji përcakton institucionet dhe detyrat e përgjegjësive të tyre, si dhe procedurat, sipas të cilave kryhet vlerësimi strategjik mjedisor. Ky ligj është përafshuar me Direktivën 2001/42/KE, datë 27 qershor 2001. Detaje të mëtejshme mund të gjenden në http://www.legislacioni.gov.al/frontend/change_documents/129.
- ❖ **VKM nr. 219, datë 11.3.2015** “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”.
- ❖ **VKM nr. 507, datë 10.6.2015**, "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor".
- ❖ **Direktiva 2001/42/KE e Komisionit Evropian** “Mbi vlerësimin e efekteve të disa planeve e programeve në mjedis” (Direktiva për VSM-në). Informacione të mëtejshme mund të gjenden në <http://ec.europa.eu/environment/eia/home.htm>.
- ❖ **Protokolli i VSM-së**, i miratuar në Kiev (Ukrainë) në vitin 2003, në një mbledhje të jashtëzakonshme të palëve të Konventës së ESPOO-s gjatë konferencës ministeriale "Mjedisit për Evropën" dhe i nënshkruar nga 36 shtete dhe nga Komuniteti Evropian. Informacione të mëtejshme mbi Protokollin e VSM-së mund të gjenden në http://www.unece.org/env/eia/sea_protocol.htm.

1.3. Fazat kryesore të procesit të VSM-së

Fazat kryesore të procesit të VSM-së përshkruhen në tabelën më poshtë:

Tabela 1: Fazat kryesore të procesit të VSM-së

Fazat	Përshkrimi
Ekzaminimi	Ekzaminimi identifikon nëse nevojitet zbatimi i VSM-së për një plan, program apo projekt specifik. Kjo fazë fokuson burimet te planet, programet dhe projektet që mund të rezultojnë potencialisht në efekte të konsiderueshme mjedisore dhe shëndetësore dhe përjashton nga sistemi i VSM-së ato me pasoja mjedisore dhe shëndetësore të pakonsiderueshme (ose pa pasoja). Synimi i fazës së ekzaminimit është të identifikojë nëse nevojitet zbatimi i VSM-së/VNMS-së për një plan, program apo projekt specifik.

Përcaktimi i fushës së zbatimit	Çështjet e identifikuar gjatë kësaj faze do të udhëheqin vlerësimin e gjendjes mjedisore ekzistuese, vlerësimin real të ndikimeve të mundshme dhe marrjen në konsideratë të alternativave ose opsioneve të mundshme. VSM merr në konsideratë përfshirjen e çështjeve mjedisore ose sociale më gjithëpërfshirëse, p.sh. përshtatjet ndaj ndryshimeve klimatike, mundësitë e punësimit etj. Synimi i fazës së përcaktimit të fushës së zbatimit është identifikimi i çështjeve kryesore që duhet të adresohen në raportin specifik të VSM-së.
Analiza e gjendjes ekzistuese	Analiza e gjendjes ekzistuese siguron një bazë për vlerësimin e ndikimit, hartimin e masave zbutëse dhe skemën e monitorimit. Për VSM-në është me rëndësi që të përmbledhë tendencat e ardhshme potenciale. Rrjedhimisht, me qëllim vlerësimin e zhvillimeve të mundshme në të ardhmen, nevojitet analizimi i tendencave të kaluara. Vlerësimi i ndikimeve të mundshme nuk mund të kryhet pa kuptuar siç duhet gjendjen ekzistuese lidhur me çështjet kryesore të identifikuar gjatë përcaktimit të fushës së zbatimit. <i>Synimi i analizës së gjendjes ekzistuese është arritja e përmirësimit të specifikimit të çështjeve kryesore dhe e identifikimit të problemeve kryesore lidhur me planin, programin apo projektin përkatës.</i>
Analiza e ndikimit dhe masat zbutëse	VSM analizon efektet e konsiderueshme negative si dhe pozitive të planit, programit apo projektit të propozuar. Një nga përfitimet kryesore të VSM-së është mundësia të identifikimit të efekteve mjedisore për një sërë propozimesh të përfshira në dokumentin strategjik dhe, rrjedhimisht, mundësia të adresimit të efekteve të mundshme kumulative të cilat mund të rezultojnë nga masat që zbatohen përgjatë një periudhe të caktuar kohore pa ndonjë peshë të konsiderueshme të marra individualisht, por me shumë peshë në tërësinë e tyre. Në vijim të rreziqeve dhe ndikimeve të identifikuar, VSM sugjeron masa për trajtimin e efekteve të mundshme negative, si dhe për përforsimin e ndikimeve pozitive që mund të rezultojnë nga plani, programi apo projekti. <i>Kjo fazë synon vlerësimin e efekteve të konsiderueshme negative e pozitive të një plani, programi apo projekti dhe, në vijim të konkluzioneve të analizës së ndikimeve, marrjen në konsideratë të alternativave dhe opsioneve, si dhe hartimin e masave për parandalimin, reduktimin dhe, për aq sa është e mundur, kompensimin e efekteve të konsiderueshme negative si pasojë e zbatimit të planit, programit apo projektit.</i>
Përgatitja e raportit të VSM-së	Raporti i VSM-së/VNMS-së duhet të përmbledhë të gjitha rezultatet dhe konkluzionet e arritura gjatë procesit të plotë të VSM-së/VNMS-së, si dhe duhet të shërbejë si referencë për konsultimet me autoritetet përkatëse dhe grupet e tjera të interesit. <i>Qëllimi i kësaj faze është përgatitja e një raporti të thjeshtë e të kuptueshëm, që të sigurojë në mënyrë të qartë të gjitha informacionet, të dhënat, konkluzionet dhe rekomandimet e rëndësishme dhe që, rrjedhimisht, të mundësojë konsultime efikase me autoritetet përkatëse dhe grupet e tjera të interesit.</i>
Miratimi	Dhënia e informacioneve mbi planin/programin e miratuar, mbi mënyrën se si janë marrë në konsideratë komentet e konsultimeve dhe mbi metodat për monitorimin e efekteve të konsiderueshme mjedisore të zbatimit të planit/programit.
Monitorimi	Monitorimi i efekteve të konsiderueshme mjedisore dhe marrja e masave të përshtatshme korrigjuese për të gjitha efektet të konsiderueshme dhe të paparashikuara në mjedis.

1.4. Metoda e punës

1.4.1. Të dhënat për përgatitjen e raportit të VSM-së

Për përgatitjen e raportit të VSM-së, u përdorën të dhënat publike dhe të dhënat e siguruara nga hartuesi i Planit të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet (PMRRP) të Qarkut Shkodër dhe nga institucionet kompetente (shih bibliografia).

1.4.2. Metodologjia për përgatitjen e raportit të VSM-së

Metodologjia për përgatitjen e raportit të VSM-së është në pajtueshmëri me ligjin nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor" i harmonizuar plotësisht me direktivën e BE-së: 2001/42/EC "Për vlerësimin e ndikimit të disa planeve dhe programeve në mjedis".

Në bazë të të dhënave të përfuara, u krye një analizë e masave të propozuara nga PMRRP. U përcaktuan ndikimet potenciale (pozitive dhe negative) të zbatimit të planit në komponentë individuale të mjedisit dhe u vlerësua shkalla e rëndësisë së ndikimeve. U mor gjithashtu një vendim dhe u dhanë sqarime në lidhje me marrjen në konsideratë dhe vlerësimin e mëtejshëm të ndikimeve të masave të përcaktuara në PMRRP tek elementët individualë të mjedisit. Janë zhvilluar objektivat mjedisore si dhe kriteret e vlerësimit.

Ndikimet e konsiderueshme të identifikuar gjatë fazës së vlerësimit u analizuan më në detaj gjatë përgatitjes së raportit të VSM-së, duke përcaktuar llojin ose natyrën e ndikimit.

Tabela 2: Lloji ose natyra e ndikimit të PMRRP-së në mjedis

Lloji ose natyra e ndikimit	Përshkrimi
Ndikim i drejtpërdrejtë	Ndikimi përcaktohet si i tillë në rast se PMRRP planifikon masa që ndikojnë drejtpërdrejtë në gjendjen e mjedisit.
Ndikim jo i drejtpërdrejtë	Ndikimi përcaktohet si i tillë në rast se PMRRP planifikon masa që kanë ndikime në gjendjen e mjedisit, të cilat vijnë si rezultat i zbatimit të planit dhe shfaqen në distancë nga pika e ndërhyrjes në mjedis.
Ndikim kumulativ	Ndikimi përcaktohet si i tillë në rast se PMRRP planifikon masa me ndikim të pakonsiderueshëm në gjendjen e mjedisit, por që së bashku me ndërhyrjet ekzistuese në mjedis dhe/ose ndërhyrjet e planifikuara dhe/ose të zbatuara në bazë të planeve/programeve të tjera kanë një ndikim të konsiderueshëm në mjedis; ose kur disa ndikime individuale, të pakonsiderueshme në aspektin mjedisor të lidhura me një ose disa masa të PMRRP-së kanë një ndikim efektet e të cilit në pjesë të caktuara të mjedisit nuk janë të pakonsiderueshme.
Ndikim sinergjik	Ndikimi përcaktohet si i tillë në rast se PMRRP planifikon masa me ndikime mjedisore që të kombinuara me njëra-tjetrën janë më të konsiderueshme në krahasim me shumën ndikimeve individuale.
Kohëzgjatja e ndikimit	Ndikim i përkohshëm: përbën një ndikim të një natyre të përkohshme. Ndikim afatshkurtër: është ndikimi efektet e të cilit në gjendjen e mjedisit përfundojnë pas (5) vitesh nga fillimi i zbatimit të masës së PMRRP-së. Ndikim afatmesëm: është ndikimi efektet e të cilit në gjendjen e mjedisit përfundojnë pas pesë (5) deri në dhjetë (10) vitesh nga fillimi i zbatimit të masës së PMRRP-së. Ndikim afatgjatë: është ndikimi efektet e të cilit në treguesit e caktuar të gjendjes së mjedisit përfundojnë pas (10) vitesh nga fillimi i zbatimit të masës së PMRRP-së. Ndikim i përhershëm: është një ndikim që lë pasojë afatgjatë në zbatimin e PMRRP-së.

Fillimisht u realizua analiza e përputhshmërisë mes objektivave mjedisore të VSM-së dhe objektivave të PMRRP-së. Kjo analizë përcakton nivelin e përputhshmërisë mes dy grupeve të objektivave.

Në vijim, ndikimet në arritjen e objektivave mjedisore u vlerësuan në bazë të shtrirjes së ndryshimeve të treguesve individualë të gjendjes së mjedisit dhe rëndësisë së tyre, masës së pajtueshmërisë me objektivat e mbrojtjes ose në bazë të kriterëve të tjera të vlerësimit, në varësi të gjendjes së mjedisit ose komponentëve të tij, mbrojtjes së burimeve natyrore, mbrojtjes së vlerave natyrore, ruajtjes së biodiversitetit, karakteristikave të popullsisë dhe shëndetit të njeriut.

Metodologjia e vlerësimit dhe kategoritë e përmasave të ndikimeve të PMRRP-së lidhur me arritjen e objektivave mjedisore përcaktohen në bazë të legjislacionit shqiptar mbi VSM-në dhe markohen sipas kategorive A deri në E dhe me X në rast të pamundësisë së vlerësimit të ndikimeve.

Tabela 3: Gradat e përmasave të ndikimeve të PMRRP-së në arritjen e objektivave mjedisore

Grada	Përkufizimi i Gradës
A	Zero ndikime ose ndikim pozitiv
B	Ndikim i pakonsiderueshëm
C	Ndikim i pakonsiderueshëm si rezultat i zbatimit të masave zbutëse
D	Ndikim i konsiderueshëm
E	Ndikim shkatërrues
X	Ndikim i papërcaktueshëm

Nëse vlerësimet e ndonjë prej pasojave të zbatimit të PMRRP-së klasifikohen në gradat A ose B, ndikimet masës në fjalë janë të pranueshme. Nëse vlerësimet e ndonjë prej pasojave të zbatimit të PMRRP-së klasifikohen në gradën C, ndikimet e masës në fjalë janë të pranueshme si pasojë e zbatimit të masave zbutëse. Nëse vlerësimet e ndonjë prej ndikimeve të zbatimit të PMRRP-së në objektivat mjedisore klasifikohen në gradat D ose E, ose nëse ndikimi është i papërcaktueshëm, ndikimet si rezultat i zbatimit të ndërhyrjeve të planifikuara, në arritjen e objektivave mjedisore, janë të papranueshme.

Masat e caktuara zbutëse shpjegohen si dhe përcaktohen në raport me kohën dhe vendin e zbatimit. Gjithashtu përcaktohet edhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës zbutëse.

1.5. Procesi i hartimit dhe struktura e raportit të VSM-së

Raporti i VSM-së u përgatit në bazë të dokumentit “FRM plan Shkodra Region 2021 draft vers02 incl annexes”, të datës 21 dhjetor 2021. Raporti i VSM-së konsiston në tre pjesë.

1. Pjesa e parë përfshin:
 - Metodologjinë e ndjekur për përgatitjen e raportit të VSM-së;
 - Informacionin mbi Planin e Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet (PMRRP) në Qarkun e Shkodrës;
 - Gjendjen e mjedisit dhe përcaktimin e çështjeve kryesore mjedisore.
2. Pjesa e dytë lidh dhe kombinon këto përmbajtje në kuadrin e:
 - Përcaktimit të objektivave mjedisore (OM) lidhur me VSM-në për PMRRP-në;
 - Identifikimit të masave të PMRRP-së në lidhje me secilën prej OM-ve;
 - Përcaktimit të kriterëve dhe metodave për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve;
 - Identifikimit të ndikimeve për secilën prej masave në lidhje me OM-të;

- Vlerësimin e ndikimeve si rezultat i zbatimit të masave të PMRRP-së tek OM-të (duke përfshirë ndikimet ndërkufitare);

3. Pjesa e tretë përmban:

- Përcaktimin e masave zbutëse dhe monitorimit lidhur me zbatimin e PMRRP-së;
- Përfundime dhe rekomandime.

Ndikimet e masave të renditura nga PMRRP merren në konsideratë në tërësinë e tyre në përputhje me secilën prej objektivave të veçanta mjedisore. Paraqiten vlerësimet lidhur me pranueshmërinë e ndikimeve dhe cilësohen masat zbutëse, si dhe rekomandimet dhe ndikimet ndërkufitare.

Objektivat e përcaktuara mjedisore konsiderohen në raport me sektorët përkatës të prekur nga zbatimi i PMRRP-së. Arsyeja është përcaktimi i objektivave në raportin e VSM-së, detyra e të cilit është verifikimi i shtrirjes së efektit, negativ ose pozitiv, të zbatimit të PMRRP-së në arritjen e objektivave të planit (p.sh. mbrojtja e natyrës, shëndeti i njeriut, mbrojtja e pronave dhe infrastrukturës, cilësia e ujit, etj.). Duhet theksuar gjithashtu se raporti i VSM-së përdor terminologjinë e marrë nga legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit.

2. INFORMACION MBI PLANIN E MENAXHIMIT TË RREZIKUT NGA PËRMBYTJET – QARKU SHKODËR

2.1. Përmbledhje e procesit për hartimin e planit

2.1.1. Të përgjithshme

Projekti fokusohet në zhvillimin e një Plani të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet (PMRRP) për njësitë administrative të prekura në Shkodër dhe përreth. Plani përfshin ekzaminimin e njësisë administrative Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethina, Shkodër dhe Velipojë në Bashkinë Shkodër dhe të Bushatit në Bashkinë Vau i Dejës.

Procesi bazohet në punën që tashmë është bërë në të kaluarën dhe kontributet e administratave përkatëse rajonale dhe vendore dhe palëve të tjera të interesuara.

Aspektet kryesore të përfshirjes së palëve të interesuara në zhvillimin e PMRRP janë:

- PMRRP udhëhiqet nga parimet e Direktivës së BE-së për Përmbytjet; Direktiva kërkon procese të forta të drejtuara nga palët e interesuara.
- PMRRP përfshin një katalog masash që lidhen me “Llojet e masave” të BE-së, të përshtatur me karakteristikat rajonale; katalogu është një propozim, i cili duhet të plotësohet dhe përshtatet nga aktorët dhe palët e interesuara vendore.
- Aktivitetet përfshijnë masa trajnimi për komunat me fokus në uljen e rrezikut, parandalimin e dëmeve dhe ndërgjegjësimin.
- Faktet dhe shifrat e përdorura për planifikimin e masave bazohen në njohuritë praktike të specialistëve vendas në çdo grup pune në nivel NJQV, të udhëhequra dhe verifikuara në masën maksimale të mundshme nga ekspertët e projektit.

2.2. Hapat e punës dhe metodat për hartimin e planit

Planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet fokusohen në parandalimin, mbrojtjen dhe gatishmërinë. Me synimin për t'u dhënë lumenjve më shumë hapësirë, të gjithë aktorët përkatës duhet të marrin në konsideratë ku është e mundur mirëmbajtjen dhe/ose restaurimin e zonave të përmbytura, si dhe masat për parandalimin dhe reduktimin e dëmtimit të shëndetit të njerëzve, mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe aktivitetit ekonomik. E rëndësishme për një qasje moderne në Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet (MRRP) është mbështetja tek masat parandaluese dhe mbrojtëse që mbulojnë të gjithë ciklin e MRRP, që nga përgatitja dhe menaxhimi i fatkeqësive deri në fazën e rikuperimit. Të gjithë aktorët e mundshëm që mund të kontribuojnë në zbutjen e rrezikut u përfshinë në procesin e hartimit të PMRRP.

Procesi ka përfshirë:

- Identifikimi i NJQV-ve të prekura bazuar në përvojën e përmbytjeve, hartat e rrezikut nga përmbytjet, vlerësimi dhe analiza e dokumenteve dhe studimeve të mëtejshme të planifikimit;
- Ngritja e një grupi pune ndërministror për MRRP duke përfshirë të gjithë aktorët përkatës lokalë, rajonalë dhe kombëtarë;
- Vlerësimi dhe diskutimi mbi situatën e rrezikut, pikat kryesore të nxehta dhe nevojat e përgjithshme për veprim për Qarkun e Shkodrës së bashku me autoritetet lokale dhe rajonale dhe palët e interesuara;
- Zhvillimi dhe pajtimi me objektivat e duhura për MRRP, proceset në projekt dhe hapat specifikë duke përfshirë përgjegjësitë për hapat;

- Zhvillimi dhe marrëveshja për masat për uljen e rrezikut, vlerësimi i statusit të zbatimit të secilës masë dhe marrëveshja për listën e masave në PMRRP, duke përfshirë një tablo të përbashkët të prioritetëve të masave të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet dhe aktivitetëve të mëtejshme për rajonin;
- Hartimi i raportit të PMRRP, publikimi i draftit dhe konsultimi me grupin ndërmintor të punës (drafti i parë) dhe publikun (drafti i dytë);
- Përfundimi i PMRRP për periudhën 2022 - 2027

Fokusi kryesor në këto detyra ishte identifikimi dhe klasifikimi në një proces pjesëmarrës me aktorët përkatës, masat dhe përgjegjësitë e mundshme për lloje të ndryshme masash. Një vlerësim i përbashkët indikativ për masat në lidhje me kriteret e thjeshta (ndikimi i përgjithshëm i masave, pengesat për realizim, burimet e nevojshme), i dokumentuar në kapitullin "prioritetet", bën transparent, përfshirjen e shumë aktorëve të ndryshëm dhe përgjegjësitë për secilën masë. të jetë i përcaktuar qartë. Jo vetëm masat strukturore me kosto intensive i zgjidhin problemet dhe shumë masa mund të merren pa përpjekje të mëdha brenda hapave "normalë" të planifikimit të zhvillimit.

Në hapin e parë të punës, u analizuan hartat e rrezikut nga përmbytjet të vitit 2021 në lidhje me shtrirjen e përmbytjeve dhe përdorimin e tokës si dhe objektet në rrezik.

Sipas direktivës së BE-së për përmbytjet, në hartat e rrezikut dhe në PMRRP janë paraqitur dhe vlerësuar rreziqet për objektet e grupeve të mëposhtme:

- Shëndeti i njeriut (njerëzit, veçanërisht të moshuarit, fëmijët dhe invalidët);
- Mjedis (peizazhi i mbrojtur, zogjtë dhe kafshët e egra, flora dhe fauna e ndjeshme si dhe cilësia e ujërave nëntokësore);
- Trashëgimia kulturore (gjithashtu kishat, varrezat);
- Aktivitetet ekonomike (biznese, ferma, toka bujqësore).

Sipas direktivës së BE-së për përmbytjet është marrë në konsideratë rreziku nga skenarët e mëposhtëm të përmbytjeve, sipas të dhënave statistikore:

- Periudha e kthimit të shpeshtë (periudha e shkurtër e kthimit, një herë në < 10 vjet);
- Periudha mesatare e kthimit (një herë në 50 – 100 vjet);
- Përmbytje ekstreme ose periudha e gjatë e kthimit (përmbytja më e lartë e mundshme ose një herë në 200 ose 500 vjet ose më shumë).

Përveç hartave të përditësuara të rrezikut nga përmbytjet (të prodhuara në këtë projekt nga viti 2019-2021 në bashkëpunim me grupin teknik ndërkombëtar të punës nga 4 vendet bregore të basenit të lumenjve Drin/Buna) u analizuan informacionet ekzistuese për ngjarjet e mëparshme të përmbytjeve. Vlerësimi i ngjarjeve të vitit 2010 si ngjarjet më të mëdha në vitet e kaluara (*shih gjithashtu GIZ-studimin e 2015 dhe Mott McDonald, 2012a*) u përfshi në analizë.

Vlerësimi i situatës së rrezikut nga përmbytjet u bazua në dy hapat e parë të punës (rreziku nga përmbytjet dhe hartat e rrezikut) dhe hartoi një përshkrim statistikor dhe të hartëzuar të shpërndarjes së rreziqeve në zonë. Bazuar në vlerësimin e rrezikut janë zhvilluar, hartuar dhe përshtatur objektivat e duhura për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet sipas konsultimit të grupit të punës.

Në hapin e dytë të punës, katalogu i masave (i cili bazohet në Direktivën e BE-së për Përmbytjet) u përdor si një listë kontrolli për të përzgjedhur dhe përcaktuar masat (instrumentet administrative,

aspektet e mbrojtjes, aspektet teknike të mbrojtjes nga përmbytjet, aspektet e gatishmërisë, etj.). Identifikimi i mëtejshëm i masave përfshinte si përzgjedhjen ashtu edhe përshkrimin e masave dhe përgjegjësive përkatëse. I rëndësishëm ishte vlerësimi i statusit të zbatimit sipas kategorive të statusit (nga fillimi dhe në vazhdim deri në përfundim) sipas nomenklaturës raportuese të BE-së. Gjithashtu u përcaktuan prioritetet, bazuar në një vlerësim të përbashkët tregues të masave në lidhje me kriteret e thjeshta përshkruese (ndikimi i përgjithshëm i masave, pengesat për realizim, burimet e nevojshme, kriteret mjedisore dhe kriteret sociale). Prioritetet e planit të veprimit tregojnë:

- cilat masa me kosto të ulët mund të ndërmerren fillimisht,
- çfarë vlerësime shtesë mund të jenë të nevojshme,
- cilët janë aktorët përgjegjës, dhe
- për cilat masa duhet fonde shtesë.

Hapi i fundit ishte dokumentimi për sa i përket raportit përfundimtar dhe shtojcave plotësuese (lista e masave). PMRRP është përmbledhja e vlerësimit të rrezikut dhe e planeve të veprimit.

2.3. Marrëdhënia e PMRRP-së me strategjitë, programet dhe dokumentat përkatëse

2.3.1. Niveli ndërkombëtar - Kuadri i Direktivës së BE-së për Përmbytjet

Direktiva Evropiane 2007/60/EC për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet kontribuon në ngritjen e një kuadri ligjor për menaxhimin e integruar të ujit duke përfshirë menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet për të gjitha shtetet anëtare evropiane. Ajo bazohet tek ndryshimi i strategjisë në luftën kundër rrezikut nga përmbytjet: qasja tradicionale ishte mbrojtja e njerëzve, të mirave ekonomike dhe tokës bujqësore nga përmbytjet (që zakonisht dështon kur përmbytjet ekstreme kalojnë punimet mbrojtëse). Qasja moderne e direktivës është bashkëpunimi me të gjithë aktorët përkatës ndaj “jetës me përmbytjet” për të mbrojtur nëse është e mundur, të përshtaten përdorimet dhe punimet ndaj rrezikut nga përmbytjet në zonat respektive dhe veçanërisht për tu përgatitur për përmbytjet me një qasje holistike me të gjithë njerëzit, organizatat, administratat dhe bizneset e prekura nga to.

Masat e planit për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet duhet të trajtojnë të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet (shih Figurën 2). Ato duhet të përfshijnë masat për parandalimin e përmbytjeve, mbrojtjen parandaluese kundër përmbytjeve, dhe gatishmërinë. Ato duhet të përfshijnë gjithashtu masa për periudhat përpara ardhjes së përmbytjeve, për kohën kur ndodh një përmbytje dhe për periudhat e rikuperimit pasi ka ndodhur përmbytja.



Figura 2 - Cikli i MRRP-së sipas Direktivës së BE-së

[grafik: INFRASTRUKTUR & UMWELT, projekti i BE STRIMA 2014, i ndryshuar]

Në përgjithësi, direktiva e BE për përmbytjet parashikon tre hapa, që duhet të zbatohen në të gjitha shtetet anëtare brenda afateve të paracaktuara për të gjithë basenet lumore:

1. Identifikimi i zonave të mundshme me rrezik të madh përmbytjeje;
2. Hartat e rrezikut dhe të shtrirjes së rrezikut nga përmbytjet;
3. Planifikimi i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.

Për qarkun e Shkodrës, direktiva e BE-së nuk është e detyrueshme sepse nuk bëhet fjalë akoma për një shtet anëtar të BE-së. Megjithatë, ndërmjet partnerëve u ra dakord që kur projekti të detajohej të ndiqej direktiva sa më shumë që të ishte e mundur për të kontribuar në integrimin Evropian.

Hartimi i PMRRP për Qarkun e Shkodrës ndjek në përgjithësi hapat dhe qasjet metodologjike të BE-së për zbatimin e direktivës. Detaje të mëtejshme janë të dokumentuara në dokumentet e grupit të punës të BE-së për përmbytjet (GP-P) dhe në grupet e punës që koordinojnë procesin CIS (strategjia e përbashkët e zbatimit)¹.

2.3.2. Niveli kombëtar

Në procesin e përafrimit me BE-në, Shqipëria po punon për harmonizimin e legjislacionit të saj drejt përmbushjes së kriterëve të Direktivës 2007/60/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 23 Tetor 2007 për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet. Autoriteti përgjegjës kryesor në Shqipëri është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ka katër fusha kryesore sipas legjislacionit shqiptar dhe politikave që lidhen me menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet (*Mott MacDonald, 2012a*):

- Legjislacion për mbrojtjen civile që lidhet me planifikimin dhe përgjigjen ndaj një emergjence;
- Politikat dhe rregulloret për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (ZRF);
- Mbrojtja nga përmbytjet, dhe
- Planifikimi i zhvillimit që rregullon dhe kontrollon zhvillimin e infrastrukturës në zonat me rrezik përmbytjeje.

Menaxhimi i rrezikut nga përmbytjet rregullohet aktualisht me **Ligjin Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”**, miratuar në 18 korrik 2019, duke zëvendësuar ligjin 8756/2001 “Për shërbimet e emergjencave civile”. Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” përbën kuadrin ligjor kryesor, prezanton konceptin e Zvogëlimin të Riskut nga Fatkeqësitë (ZRF) dhe promovon mbrojtjen civile. Ajo pret hartimin e:

- strategjive kombëtare dhe lokale për ZRF²,
- vlerësimin të rrezikut nga fatkeqësitë në nivel kombëtar dhe lokal, dhe
- planeve të emergjencës në të gjitha nivelet në përputhje me Planin Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC)³.

Strategjia Kombëtare për ZRF: Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile drejton procesin e zhvillimit për të qenë në përputhje të plotë me Kornizën Sendai për ZRF.

Vlerësimi i rrezikut nga fatkeqësitë në nivel qendror: Ky dokument bazohet në tre hapa kryesorë që përfshijnë identifikimin e llojeve të rrezikut, shpërndarjen e elementeve të rrezikut dhe vlerësimin e dobësive.

¹ Guidat e CIS janë publikuar në http://ec.europ.eu/environment/water/flood_risk.implem.htm

² Në bashkëpunim me UNDP, Shqipëria po përgatit Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë

³ PKEC është miratuar në datën 3 dhjetor 2004 me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 835/2004

Planin Kombëtar për Emergjencat Civile: PKEC synon të përcaktojë procedurën që duhet ndjekur nga pushteti vendor në rastet e emergjencës. Ka një fokus të fortë në parandalimin dhe investimet për të reduktuar rrezikun.

Përsa i përket mbrojtjes nga përmbytjet, kuadri ligjor bazohet në politikën kombëtare për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet dhe erozionin nën kujdesin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR). Në këtë drejtim, ligji nr. 24/2017, i miratuar në 9 mars 2017 **“Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit”**, lehtëson ngritjen dhe funksionimin e detyrave dhe përgjegjësi kryesore të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit, bashkive dhe shoqatave të përdoruesve të ujit, duke synuar kështu ndërtimin e kuadrit institucional dhe funksional në përputhje me politikën kombëtare për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet. Një nga tre objektivat e ligjit nr.24/2017 është rritja e produktivitetit bujqësor duke plotësuar nevojat për ujë të fermerëve si dhe duke përmirësuar kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet e të gjitha zonave që mund të drenazohen⁴. Gjithashtu, në **Strategjinë e Ujitjes dhe Kullimit në Shqipëri**, të vitit 2017, përcaktohen synimet e politikave dhe objektivat strategjike. Nga katër objektivat, mbrojtja nga përmbytjet është një nga fushat kryesore të vëmendjes.

Përsa i përket çështjeve të planifikimit, Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” deklaron se planet e zhvillimit urban do të hartohen në përputhje me dokumentet dhe strategjitë e vlerësimit të rrezikut nga fatkeqësitë (Ligji 45/2019, neni 12). Kështu që Bashkia Shkodër ka hartuar dhe miratuar **Planin e saj të Përgjithshëm Vendor (PPV)**⁵. PPV nuk specifikon vetëm përdorimin e tokës dhe planifikimin e territorit për të gjithë territorin administrativ të bashkisë, si për shembull tokën bujqësore dhe zonat e lidhura me ujin. por përfshin edhe elementë të ZRF-së, identifikimin e zonave në rrezik nga fatkeqësitë natyrore dhe rrezikun e tyre.

Krahas këtyre, PMRRP ka lidhje edhe me fusha të tjera të legjislacionit dhe politikave si çështjet ekonomiko- financiare, mjedisi, burimet natyrore, bujqësia dhe turizmi.

⁴ Ekziston një plan veprimi i vitit 2017 për shërbimet e kanaleve kulluese në Bashkinë Shkodër: http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/plan_veprimi_per_sherbimin_e_kullimit_1373.pdf

⁵ PPV për Bashkinë Shkodër është në fuqi për periudhën kohore 2015-2030

3. GJENDJA E MJEDISIT DHE REGJIMET E MBROJTJES

3.1. Zona e projektit brenda pellgut të lumit Drin-Buna

Zona e projektit ndodhet në Shqipërinë veriperëndimore në kufi me Malin e Zi. Ajo karakterizohet nga fusha lymore në breg të lumenjve Drin dhe Buna, male që e rrethojnë – rrëzë Alpeve Shqiptare – me lartësi deri në më shumë se 1,700 metra (Mali i Cukalit, në lindje të Shkodrës) dhe liqeni i Shkodrës, një liqen i madh i brendshëm që ndahet ndërmjet dy shteteve Shqipërisë dhe Malit të Zi. Lumi i Bunës në pjesën jugore të liqenit është rrjedha e vetme që derdhet në Detin Adriatik pas bashkimit me Lumin Drin afër me qytetin e Shkodrës.




Figura 3: Njësitë administrative të zonës së projektit: Bashkia Shkodër (e verdhë) me 7 NJQV dhe Bashkia Vau i Dejës me 1 NJQV në zonën e rrezikut nga përmbytjet

Përmbytjet janë të shpeshta gjatë periudhës nëntor-mars, kur rajoni merr rreth 80-85 për qind të reshjeve vjetore (Bogdani, 2006). Kjo zonë me rrezik potencial në qarkun e Shkodrës mbulon njësitë administrative të Bashkisë Shkodër: Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethina, Shkodër dhe Velipojë e Bushat si të vetmet njësi administrative të prekura të Bashkisë Vau i Dejës (shih Figurën 4).




Figura 4: Harta e rrezikut nga përmbytjet në HQ500 të Qarkut Shkodër me 8 njësi administrative të projektit - bashkimi i Drinit dhe Bunës në jug të Shkodrës

Ultësira Drin-Bunë është pjesë e Drinit të zgjeruar ndërkuftar me vendet bregdetare të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi. Sipërfaqja e përgjithshme e pellgut ujëmbledhës është afërsisht 20,380 km² (LWI, 2014) dhe përfshin Drinin e Zi, Drinin e Bardhë dhe lumin Buna, si dhe liqenet e Shkodrës, Ohrit dhe Prespës. Drini i Zi buron nga liqeni i Ohrit dhe derdhet në veri duke kaluar kufirin midis Maqedonisë dhe Shqipërisë. Në Kosovë ngrihet Drini i Bardhë. Dy përrenjtë derdhen në rezervuarin e Fierzës. Prej aty lumi Drin kalon kaskadën e digave të tre rezervuarëve Fierzë (73 km²), Komanit (12 km²) dhe Vaut të Dejës (25 km²) të operuara nga korporata elektrike shqiptare KESH (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare). Digat janë ndërtuar deri në vitin 1975 (diga më e ulët e Vaut të Dejës). deri në 1978 (diga më e lartë Fierzë) dhe deri në 1985 (Koman) (LWI, 2014). Prodhimi i hidrocentraleve në lumin Drin është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë duke prodhuar rreth 90% të energjisë elektrike të vendit. Më tej në rrjedhën e poshtme Drini bashkohet me daljen e liqenit të Shkodrës, me lumin Buna dhe humbet emrin e tij.




Figura 5: Nën-pellgjet e pellgut të lumit Drin-Buna

[grafika: INFRASTRUKTUR & UMWELT, bazuar në të dhënat me burim të hapur]

Lumi Buna shtrihet nga derdhja e liqenit të Shkodrës deri në detin Adriatik dhe ka një gjatësi prej 44 km. Në kilometrat e fundit - para se të bashkohet me detin - lumi Buna rrjedh pjesërisht përgjatë kufirit midis Malit të Zi dhe Shqipërisë. Ultësira Drin-Bunë përfaqëson një sistem ujqor shumë kompleks ku ndërveprojnë lumenjtë, liqenet, ligatinat dhe ujërat nëntokësore. Përveç shumë vlerave natyrore, pellgu i Drinit është i rëndësishëm për ekonominë e vendeve bregdetare. Përdoruesit kryesorë të ujit janë energjia, bujqësia dhe blegtoaria, furnizimi me ujë dhe kanalizimet, minierat dhe industria, mjedisi, peshkimi, turizmi dhe transporti.

3.2. Faktorët klimatikë

Gjatë dy dekadave të fundit, Shqipëria i ka kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi dhe ndryshimeve klimatike në veçanti. Vetë Kushtetuta e Shqipërisë ka përfshirë “një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezin e tanishëm dhe atë të ardhshëm” si një prej objektivave sociale që duhet të merren në konsideratë nga të gjitha institucionet shtetërore.

Shqipëria është palë nënshkruese e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK), të miratuar në “Samitin e Tokës në Rio” më 1992 dhe të ratifikuar nga Parlamenti shqiptar më 1994, e cila ka përcaktuar objektivin për luftën kundër ndryshimeve klimatike përmes stabilizimit të përqendrimeve të GES-ve në atmosferë dhe kufizimit të rritjes së temperaturave mesatare globale për të përkrahur zhvillimin e qëndrueshëm. Në kuadrin e KKKBNK-së, Shqipëria ka nisur procesin e ndryshimit të statusit të saj nga një vend në zhvillim në një vend të zhvilluar. Ky proces është pjesë thelbësore e procesit të integritimit në BE dhe përfshin zhvillimin e kapaciteteve në nivel kombëtar për monitorimin dhe raportimin vjetor të Gazeve me Efekt Serrë (GES-ve), dhe përshtatjen me ndryshimet klimatike, si dhe transpozimin dhe zbatimin e tërësisë së legjislacionit të BE-së për ndryshimet klimatike.

Për shkak të reshjeve të shumta në stinën e dimrit nga njëra anë dhe potencialit të kufizuar të shkarkimit nga ana tjetër, përmbytjet janë një fenomen i rregullt natyror në Ultësirën Drin-Bunë. I gjithë pellgu ujëmbledhës Drin-Bunë karakterizohet nga një klimë kryesisht mesdhetare me deri në më shumë se 3000 mm reshje mesatare vjetore në pjesët malore të pellgut. Reshjet bien kryesisht nga nëntori deri në mars dhe ka një variacion të gjerë të sasisë totale dhe shpërndarjes hapësinore të reshjeve në pjesë të ndryshme të pellgut ujëmbledhës.

Për të vlerësuar ndikimet e ndryshimeve klimatike në rajon, ecuria e temperaturës, reshjeve, erës dhe ngjarjeve ekstreme të motit të shkaktuara nga ndryshimet klimatike është analizuar në kuadër të Komunikimit të Tretë Kombëtar të Republikës së Shqipërisë për Ndryshimet Klimatike (KTK) në KKKBNK⁶. Rezultati jepet në skenarët e ndryshimeve klimatike. Në lidhje me vitin 1990, parashikimet tregojnë rritje të temperaturave vjetore, ulje të reshjeve vjetore dhe rritje të nivelit të detit.




Figura 6: Parashikimet vjetore të reshjeve [mm] pa dhe me ndryshime klimatike (skenari mesatar) në rajonin bregdetar verior të Shqipërisë (KTK, 2016)

Sipas parashikimeve, reshjet vjetore do të jenë rreth 1300 mm për rajonin bregdetar verior. Edhe pse parashikohet një ulje, pritet një ndryshueshmëri e lartë siç shihet në fushën gri të paraqitur në Figurën 6.

⁶ Shqipëria ka ratifikuar Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike. Me mbështetjen e UNDP dhe GEF, KTK është publikuar dhe dorëzuar në KKKBNK në qershor 2016.

Reshjet e dendura pritet të intensifikohen. Parashikimet tregojnë se do të ketë një rritje të reshjeve të rrezikshme për qarkun e Shkodrës me rreth 1-2 ditë deri në vitin 2030, rreth 2-3 ditë deri në vitin 2050, 4-5 ditë deri në vitin 2100 në lidhje me vitin 1990. Projektionet e reshjeve 24-orëshe siç shihet në tabela e mëposhtme rezultojnë me vlera mbi pragun që konsiderohen si të rrezikshme të afta për të shkaktuar dëm ekonomik. Në projeksione, nivelet e lumenjve në pjesët e sipërme të pellgut pritet të rriten për shkak të rritjes së nivelit të detit duke përkeqësuar rrezikun e përmbytjeve ku sasi të mëdha toke të punueshme parashikohen të bëhen të papërdorshme për shkak të rritjes së kripësisë. Tendenca e shtuar në frekuencë dhe intensitet të reshjeve të dendura mund të përkeqësojë cenueshmërinë e Qarkut të Shkodrës ndaj përmbytjeve, duke kërkuar strategji afatgjata. (KTK, 2016)

Tabela 4: Reshjet e pritshme 24-orëshe për periudha të ndryshme kthimi, rajoni verior i Shqipërisë

Reshjet [mm]	Periudha e kthimit		
	10 vite	50 vjet	100 vjet
	158 ± 14	215 ± 21	239 ± 25

Burimi: KTK, 2016, përshtatur

Temperaturat vjetore pritet të rriten deri në 15.9°C në veri të Shqipërisë. Deri në vitin 2100 temperatura vjetore ka të ngjarë të rritet deri në 17.8°C. Kjo nënkupton uljen e sasisë së reshjeve të dëborës dhe pritet shkrija e hershme që do të ndikojë në modelet e rrjedhjeve, p.sh. zvogëlimin e pranverës dhe zhvendosjen e vlerave të pikut drejt muajve të dimrit, pra përmbytjet në dimër dhe thatësitrat në verë po bëhen gjithnjë e më të pranishme në Shqipëri. (KTK, 2016)

Intensiteti i përmbytjeve varet fuqishëm nga ndërhyrja e modelit të reshjeve në pjesë të ndryshme të të gjithë pellgut ujëmbledhës. Shkrija e borës në pranverë është një tjetër kontribues kryesor i përmbytjeve. Ultësira Drin-Buna është veçanërisht e prekur nga përmbytjet kur të gjitha degët kanë ngarkesa të mëdha uji në të njëjtën kohë: lumi Drin dhe Gjadër që vjen nga malet në lindje dhe juglindje të Shkodrës, lumi Kir që vjen nga verilindja dhe lumi Buna që është e vetmja dalje e Liqenit të Shkodrës. Për më tepër, bilanci uJOR i Liqenit të Shkodrës (377-530 km²), i ndarë mes Shqipërisë dhe Malit të Zi, është ndikuar shumë nga lumenjtë Moraça dhe Zeta të cilët kullojnë vargun malor verior të nënpellgut të Malit të Zi.

Krahas kësaj, një faktor tjetër është ndryshimi i nivelit të detit që ndikon pjesën jugore të ultësirës Drin-Buna. Fenomeni i erozionit të detit është i dukshëm përgjatë bregdetit të lagunës së Vilunit deri në fund të rrjedhës së lumit Buna. Përgjatë bregdetit pushtimi i detit është rreth 2 metra veçanërisht afër me deltën e Bunës. Duke pasur parasysh këtë përparim të detit, humbja e bregdetit mund të jetë më dramatike sesa vlerësimet mesatare të 50 vjetëve të fundit, gjë që e vendos atë në 500 metra. Një prej faktorëve që favorizon përparimin e detit drejt tokës dhe intensifikimin e erozionit është bllokimi i aluvioneve që vinin nga lumi Drin dhe ndërtimi i HEC-eve në shtratin e tij (LEAP i Velipojës – REC, 2006).

3.3. Sistemi Hidrik

Në Figurën 7 më poshtë paraqitet zona e degëve lumore në ultësirën Drin-Buna.




Figura 7: Zona e degëve në Ultësirën Drin-Buna (INFRASTRUKTUR & UMWELT, 2013)

Rreziku i madh i përmbytjeve në këtë rajon vjen nga një devijim i rrjedhës së lumit Drin në shekullin e 19-të. Deri në vitin 1848, lumi Drin rridhte drejt detit Adriatik duke kaluar Bushatin, Gramshin (këtu bashkohej me lumin Gjadër) dhe më pas derdhej në det pranë Lezhës. Si pasojë e përmbytjeve në 1848, 1858 dhe 1896, rrjedha e Drinit u vetdevijua (REC, 2010). Ndryshimi i natyrshëm i rrjedhës më vonë u mbështet nga ndërtimi i kanaleve për përdorimin e energjisë ujore për mullinjtë në jug të Shkodrës dhe nga mbyllja e pjeshme e ish-shtratit të lumit Drin (Schwarz, 2009). Sot lumi Drin shkarkohet kryesisht nëpërmjet lumit Buna. Shtrati i tij i vjetër është pjesë e sistemit të kullimit por pa potencial të madh shkarkimi.

Sistemi ekzistues i mbrojtjes nga përmbytjet daton që nga vitet 1960 dhe mbështetet në një seri digash dhe kanalesh kullimi (Mott McDonald, 2012a). Këto janë ndërtuar kryesisht pas përmbytjes katastrofike të viteve 1962-1963. Në këtë kohë janë kryer investime të mëdha në pjesën e poshtme të lumenjve Drin dhe Buna. Megjithëse shumë prej masave teknike për mbrojtjen nga përmbytjet kanë qenë të dobishme gjatë përmbytjeve që vijuan – si për shembull ajo e dimrit 1970-71, ato kanë nxitur gjithashtu një zgjerim të vendbanimeve në fushat lymore të lumenjve, duke e rritur kështu mundësinë për dëmtime nga përmbytjet.

Në të njëjtën kohë, kaskada hidroenergetike u realizua për të siguruar kërkesat për energji nga shqiptarët. Rrjedha ujore e Drinit i është nënshtruar ndryshimeve të shumta pas ndërtimit të digave të mëdha në pjesën e sipërme në fillim të viteve 1970, shfrytëzimit të tepërt të zhavorrit nga zona pak më poshtë se diga kryesore në Vaun e Dejës dhe kohët e fundit nga ndërtimi i hidrocentralit të Ashtës. Kjo e fundit e ndryshoi Drinin nga një lumë me shumë rrjedha në një të ashtuquajtur sistem lumor i degëzuar, duke ndryshuar këtu rrjedhat e ujit, vendosjen e vendbanimeve dhe duke pakësuar habitatet tipike (Schwarz, 2009).

Sot, kapaciteti hidraulik i shtratit lumor aktual dhe i fushave lumore natyrore të tij lejon vetëm kalimin e përmbytjeve të vogla. Në pjesën e parë pa prita me 9.5 km pas bashkimit me Drinin, lumi Buna ka një kapacitet transportues maksimal prej 1,500 m³/s (Mott MacDonald, 2012a). 32 kilometrat e poshtëm deri në deltën e Bunës janë të mbrojtura me prita dhe kanë një kapacitet prej 2,200 m³/s. Shkarkimi

vjetor mesatar i Drinit-Bunës është rreth 680 m³/s, nga të cilat 360 m³/s vijnë nga vetë Drini dhe 320 m³/s nga Buna – nga liqeni i Shkodrës (Mott MacDonald, 2011). Përmytjet e mesme deri të mëdha kanë shkaktuar vërshime dhe dëmtime të mëdha në të kaluarën.

Krahas kësaj, së bashku me rrjedhën natyrore të ujit, zona është ndryshuar shumë nga njerëzit për qëllime të bonifikimit të ultësirës me anë të drenazhimit dhe ujitjes. Vetë sistemi i drenazhimit mund të konsiderohet si një sistem i menaxhimit të ujërave nëntokësorë që lidhet me menaxhimin e përmytjeve në kohët kur uji është në nivele të larta. Sistemi luan një rol të rëndësishëm në çlirimin e presionit dhe rrjedhës së ujit dhe mbron tokën dhe shtëpitë në të gjithë zonën nga rritja e nivelit të ujit. Kur sipërfaqja e zonës përmytet, kanalet e vogla të drenazhimit kanë një ndikim të vogël në rrjedhën e ujit në sipërfaqe. Kanalet kryesore që çojnë ujin drejt detit (nëpërmjet kanalit të Murtemzës drejt liqenit të Vilunit) mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme për rritjen e shkarkimit nga ultësira në det, duke pakësuar kështu grumbullimin e ujit në fushën e Trushit (Mott MacDonald, 2012b).

Sistemi përbëhet nga diga, prita, pengesa dhe kanalet të mëdha drenazhimi. Këto janë vendosur kryesisht përgjatë lumit të Bunës, komunës së Bushatit dhe komunës së Velipojës. Ndërhurjet më të rëndësishme në infrastrukturë janë pritat në komunën e Dajçit, kanalet parësore të drenazhimit (kanalet K1) në Bushat, prita në Selmanaj në Velipojë, prita e Torovicës, kanali i Murtemzës në Velipojë dhe dy pritat në Ças dhe Vilun.

Aftësia e këtij sistemi të funksionojë si një sistem ndërveprues varet shumë nga mirëmbajtja e kanaleve dhe pjesë të tjera të tij. Nga fermerët dhe përgjegjësit vendorë raportohet se për shkak të mosmirëmbajtjes, vërshime të vogla shkaktojnë përmytjen e fushave në disa zona. Nga ana tjetër, p.sh. ndërtimi i një prite të re në Ças për mbrojtjen e tokës bujqësore në jug të kalimit të Murtemzës ka ndërprerë ish zonën ujëmbajtëse dhe mund të përbëjë një pengesë tjetër.

3.4. Biodiversiteti

3.4.1. Informacion i përgjithshëm

3.4.1.1. Bashkia Shkodër⁷

E gjithë zona e Shkodrës është shumë e pasur në florën dhe faunën, vecanërisht zonat e mbrojtura (liqeni Shkodrës, Parku Kombëtar Theth, peizazhi mbrojtur Bunë-Velipojë) edhe pse gjatë dy dekadave të fundit është dëmtuar në saj të gjuetisë informale dhe ka një numur të konsiderueshëm të specieve të rrezikuara që po shkojnë drejt zhdukjes. Rajoni i Shkodrës ka një gamë të gjerë flore dhe faune. Ekzistojnë specie bimësh në përqindje të lartë në raport me sipërfaqen e rajonit. Flora e zonës është e pasur me pyje bredhi, ahu, pisha, si dhe pemë frutore, bimë dekorative. Zona e Pultit, Shalë dhe Shosh, janë të pasura me një biodiversitet të shumëllojshmërisë të druveve të pyjeve të larta si pisha, ahu, bredhi, shkurre të shumëllojshme që krijojnë një peizazh kompleks dhe tërheqës.

Biodiversiteti si tërësi e specieve dhe ekosistemeve tokësore e ujore në territorin e Bashkisë Shkodër, shënon diferenca midis zonave dhe habitateve. Liqeni i Shkodrës, PK Theth, zona peizazhistike Bunë-Velipojë, janë nga zonat me biodiversitet të pasur të florës dhe faunës.

Liqeni i Shkodrës

Ky liqen ka një biodiversitet të pasur ujqor të florës dhe të faunës. Në këtë liqen janë përcaktuar dhjetra habitate, ku janë gjetur shumë shoqërime bimorei dhe specie dominante. Shumëllojshmëri peshqish dhe

⁷ VSM e PPV, Bashkia Shkodër

shpendë. Liqeni i Shkodrës përfaqëson një habitat të përmasave të mëdha, mjaft interesant, unikal dhe shumë kompleks. Këto karakteristika kanë lidhje me regjimin e tij ujqor, që ndryshon sipas stinëve, me luhajtjen e vëllimit të ujit, deri në afër dyfish. Liqeni i Shkodrës karakterizohet nga cekëtësia dhe në stinët e ngrohta sidomos në pjesën veriore, por edhe lindore e juglindore të zhvillohen sipërfaqe të mëdha kënetore. Ky përfaqëson zonë të ndërmjetme midis sistemeve tokësore dhe ujore, ku tokat janë të përmbytura për një pjesë të vitit, kënetat dhe pyjet kënetore. Në pjesën perëndimore, prej daljes së Bunës e deri në Kepin e Radushës bregu është shkëmbor. Ka shumë gjire, kepe dhe ishuj të vegjël që kanë interes dhe rëndësi lozin rol të rëndësishëm në biologjinë e liqenit, pasi janë mjedise relativisht të izoluara, me bimësi interesante, strehë dhe vende riprodhimi për shpendët dhe kafshët e tjera. Liqenin e Shkodrës mund ta konsiderojmë si një kompleks shumë të pasur habitatesh.

Sistemi i habitateve të Liqenit të Shkodrës zhvillohet në kohë. Në muajt e ftohtë, kur uji i liqenit shtohet, temperatura e ujit zbrit dukshëm, turbullimi rritet prej erave dhe shirave, bimësia pakësohet, karakteret e habitateve thjeshtohen. Prandaj në dimër numri i habitateve në Liqenin e Shkodrës bie dukshëm.

Flora: Gjendja ekologjike e basenit të liqenit të Shkodrës është e larmishme me grupe të florës dhe faunës. Në grupin e flores janë 122 specie. Liqeni dhe pellgu i tij ujëmbledhës përfaqëson një kompleksitet habitatesh, të përshtatshme për praninë e një larmie organizmash të gjallë. Ky diversitet i lartë biologjik i dedikohet veprimit të faktorëve favorizues kryesisht të karakterit ekologo-gjeografik. Këtu përfshihen disa tipe, nëntipe dhe shumë njësi klasifikimi më të vogla, si: lakustrine, palustrine, riverine, limnetike, litorale, emergjente, submergjente, notuese, pyll, shkurre, kaçube, bar etj. specie bimore dhe 600 specie shtazore. Në pellgun e liqenit të Shkodrës njihen 1900 specie bimore dhe 3500-4000 specie shtazore. Ky diversitet habitatesh u jep strehë një numri të madh bimësh dhe kafshësh.

Komuniteti bakterial në sipërfaqe të sedimenteve është shumë herë më i lartë se ai në shtresat e sipërme të ujit. Algat mikroskopike mund të përdoren për vlerësimin e gjendjes ushqyese dhe cilësisë së ujërave, mund të prodhojnë substanca të rrezikshme për zooplanktonin, molusqet, peshqit dhe organizmat e tjerë ujorë.

Lista e bimëve sipas zonave vertikale bimore (M.Rakaj) bazuar në studime të ndryshme bimësia në pellgun e liqenit shtrihet në katër breza:

- (i) **Zona e makjeve** shtrihet në lartësi 400-500 m lartësi mbi nivelin e detit. Prej drurëve dhe shkurreve gjethembajtëse, më të përhapura të kësaj zone, janë: ilqja, dëllinja e kuqe, shqopa, ulliri, mareja, dafina etj. Prej drurëve dhe shkurreve gjetherënëse mund të veçojmë: qelbësi, shega, shkoza e zezë, murrizi një bërthamësh, manaferra, driza, krekëza, thanukla, vidhi i bardhë, amorfa shkurre, gjineshtra, frashër uji, frashëri i bardhë, plepi i bardhë, plepi i zi, shelgu i zi, shelgu i kuq, vërri i zi, fiku etj.
- (ii) **Zona e dushkut** në lartësitë 300-700 metra mbi nivelin e detit. Speciet më të përhapura të gjinisë Quercus të kësaj zone: bulgëri, qarri, shparthi, etj. Drurë dhe shkurre të tjerë të kësaj zone janë: panja rrapë, panja mali, panjë, gështenjë, vodhëviçëza, vodha, mëlleza, blini, lajthia, murrizi pesëbërthamësh, dëllinja e zezë etj.
- (iii) **Zona e ahut** në lartësitë 600-1700 m mbi nivelin e detit dhe së bashku me nënëzonën e pishës shkon deri 1900 m. në këtë zonë gjinden drurët: ahuj, panja mali, si dhe shkurret: borbulli i padhëmbëzuar, mjedra, boronica etj. Nga halorët më shumë gjinden: rrobulli, pisha e zezë e më pak të tjerat,
- (iv) **Zona e kullotave alpine** 1800-1900 m mbi nivelin e detit. Disa gjini dhe specie bimore më të përhapura të kësaj zone janë: trëndafili i egër, saminë, shelg zvarritës, flokësa, bishtpelëz, përrëgjaksja, luluza italiane, barthek, këlerie, gentian pranverore, lulekëmbana, klokëza.

Në tërësi, Liqeni i Shkodrës dominohet një rritje të ushqyesve mbi vlerat normale. Kjo është pasojë e ndikimit të njeriut, si ndotja prej qytetit të Shkodrës dhe zonave të tjera të banuara përreth (Shirokë, Zogaj) dhe aktiviteteve të tjera të kryera përgjatë bazenit të tij. Kjo shtron si domosdoshmëri monitorimin e mëtejshëm të ujërave të liqenit, me qëllim mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore të tij, nga procesi eutrofikimit, rreziqet për gjallesat dhe sigurisë ushqimore nëpërmjet konsumit të produkteve të toksifikuara të peshkut (veprimi i zinxhirit ushqimor).

Fauna: Fauna e liqenit është e pasur me të gjitha kafshet ujore, peshq, molusqe (Dhora Dh, 2003). Në Liqenin e Shkodrës dhe ujërat e Pellgut Ujëmbledhës të tij janë gjetur 54 specie molusqesh, brenda në Liqen janë gjetur 30 specie, gaforreve 87 të tilla, prej të cilave 62 janë gaforre të ulta dhe 25 të larta. Prej studimeve të bëra numri i specieve të insekteve në këtë pellg mund të sillet rreth 6000 dhe mbi 100 specie janë endemike të këtij pellgu.

Pellgu Ujëmbledhës i Liqenit të Shkodrës përmban 57 specie gjitarësh, lakuriqve të natës, prej 20 specieve, 12 specie brejtësish dhe 11 specie mishngrënëse, 28 reptilë, 1900 bimë ujore (Dhora Dh, 2005, Liqeni Shkodres dhe Libri kuq I Faunes Shqiptare).

Peshqit: Liqenit të Shkodrës përmban 60 specie, 30% janë autoktone dhe prej këtyre të fundit 9 janë introduktuar nga njeriu. Peshqit më të rëndësishëm të liqenit janë: blini, kubla, trofta e gjucës, gjuca, krapa, njila, karasi i artë, mëlyshi, skorta e verdhë, lloska, sharmaku, levreku, ngjala, qefulli i verës, qefulli i vjeshtës, shoja. Nder llojet me të perhapur janë familja e Krapit ka 26 lloje, ose 43,3 %, ndërsa familja e troftave ka 8 lloje, ose, 13,3. Te tjera familja e kavallëve (kavalli i detit, kavalli i lumit, kavalli i përroit), Familja e blinjve (blini, blini i Adriatikut, blini turigjatë), Familja e kublave (kubla, kubla liqenore), Familja e troftave (trofta e malit, trofta liqenore, trofta e gjucës, trofta e mermertë, trofta e Cemit, trofta e Zetës, trofta e artë, trofta e ylbertë). Familja e krepëve (amuri i bardhë, amur i zi, ballëgjieri i bardhë, ballëgjieri larosh, barbuqi, gjuca, idhtaku, karasi i artë, krapa, lina, lloska, mëlyshi, mëlyshi i Moraçës, mrena, mrena e lumit, njila, njila shkodrane, notaku, pëllëmbëza, pëllëmbëza e bardhë, skorta e bardhë, skorta malazeze, skorta e pellgjeve, skorta e verdhë, skorta me vizë, skorta e zezë, Familja e levrekëve (levreku), Familja e burdullakëve (burdullaku i mermertë, burdullaku i vogël), Familja e ngjalave (ngjala), Familja e qefujve (qefulli i vjeshtës, qefulli i verës) etj.

Amfibët: Lista e amfibëve që i përket rrjetit hidrologjik të Liqenit të Shkodrës përmban 17 lloje. Prej tyre 4 lloje nuk gjenden në Liqen, por në ujërat që lidhen me të, ndonëse në distancë të largët prej tij, ose dhe në ujëra të tjerë të izoluar, por që i takojnë pellgut të Liqenit të Shkodrës. Amfibët janë një grup interesant dhe i rëndësishëm për këtë ekosistem. Një rol të madh luajnë tri llojet më të përhapura: Bufo viridis, Rana balcanica, Rana lessonae dhe hibridi i dalë prej dy llojeve të fundit. Amfibët jetojnë në ujëra të cekëta, brigjeve të Liqenit të Shkodrës. Në mënyrë të veçantë llojet e gjinive Bufo dhe Rana jetojnë në sipërfaqet e kënetëzuara të brigjeve.

Zvarranikët: Në listën e përgatitur nga ekspertët paraqiten 33 lloje zvarranikësh që gjenden në pellgun ujëmbledhës të Liqenit të Shkodrës, nga të cilat 4 lloje jetojnë në ujërat e Liqenit të Shkodrës. Këto janë Emys orbicularis, Mauremys caspica, Natrix natrix dhe Natrix tessellata

Shpendët: Është një habitat që shquhet për praninë e llojeve të shpendëve. Në ujërat e Liqenit, në brigjet rreth tij dhe habitatet e këtyre brigjeve jetojnë rreth 281 lloje. Në mënyrë të veçantë po përmendim 12 lloje çapcash (Ardeidae), 28 lloje të familjes së rosave (Anatidae), 29 lloje rrëmbenjësish të ditës (Falconiformes), 28 lloje baltakësh (Charadriiformes), 8 lloje pulëbardhash (Larus), 7 lloje rrëmbenjësish të ditës (Strigiformes), 7 lloje qukapikësh (Piciformes) dhe 117 lloje të rendit të

harabelorëve (Passeriformes), prej të cilit 6 lloje mëllenjash (Turdus), 5 lloje çikash (Acrocephalus), 7 lloje bilbilthash (Silvia), 7 lloje cerlash (Emberiza). Në pjesën shqiptare të pellgut të Liqenit janë konstatuar 236 lloje. Në këtë numër përfshihen llojet migruese të rregullta, jo të rregullta dhe të rralla. (*Dhora Dh, 2010, lista e specieve të bimëve dhe kafshëve të liqenit të Shkodrës*).

Lista e përgjithshme e shpendëve ujqorë dimëruës në Liqenin e Shkodrës përfshin 46 lloje. Siç shihet, më tepër lloje kanë rosorët (Anseriformes) dhe baltakët (Charadriiformes). Llojet që kanë numrin më të madh të individëve janë: Podiceps nigricollis, Phalacrocorax carbo, Phalacrocorax pygmeus, Anas penelope, Anas crecca, Anas platyrhynchos, Aythyaferina, Aythya fuligula, Fulica atra, Vanellus vanellus, Larus ridibundus. Duke krahasuar këto shifra me ato të inventarit të bërë për gjithë Mesdheun, dalin disa të dhëna interesante. Numri i Phalacrocorax pygmeus i Liqenit të Shkodrës përbën 10-20 % të numrit total të kësaj specie në Mesdhe. Po kështu për Gallinago gallinago, numri del rreth 5 % të totalit të Mesdheut.

Shpendët jo ujqorë dimëruës në liqen. Janë evidentuar 50 lloje shpendësh. Prej tyre, 42 lloje i takojnë harabelorëve (Passeriformes). Prej të gjithë numrit të individëve numrin më të madh e kanë Galerida cristata, Alauda arvensis, Motacilla alba, Turdus pilaris, Sturnus vulgaris, Passer domesticus, Carduelis carduelis, Carduelis cannabina.

Shpendë ujqorë folezues në liqen. Lista e shpendëve limikolë folezues përmban 11 lloje. Përveç Rallus aquaticus, Himantopus himantopus dhe Actitis hypoleucos, që u gjetën vetëm me 1999, 8 lloje e tjera u gjetën në të dy rastet. Tachybaptus ruficollis, Podiceps cristatus dhe Ixobrychus minutus folezojnë kryesisht nëpër kallamishte. Llojet e tjera përgjithësisht folezojnë në pjesë më të thata dhe më të zhveshura të bregut. Mungesa e kolonizimit të çapkave dhe karabullakëve në pjesën shqiptare duhet të lidhet me mungesën e habitateve të përshtatshme për folezim. Siç dihet këto lloje 36 kërkojnë për folezim vegjetacion drunor dhe kallamishte të dendura, larg zhurmave, shqetësimeve dhe njeriut.

Shpendët jo-ujqorë, folezues në liqen Janë numëruar çiftet e 45 llojeve të shpendëve jo-ujqorë, folezues në pjesën shqiptare të Liqenit. Përveç 9 llojeve, 36 të tjerat i takojnë rendit Passeriformes. Numrin më të madh të çifteve e kanë lloje Hirundo rustica, Delichon urbica, Motacilla flava, Cettia cetti, Acrocephalus scirpaceus, Acrocephalus arundinaceus, Passer domesticus, Passer hispaniolensis, Miliaria calandra.

Liqeni i Shkodrës dhe pellgu ujëmbledhës i tij ka një numër të lartë kafshësh të rrezikuara, shumë nga të cilat kane status kërcënimi rajonal apo ndërkombëtar (Europian dhe botëror). Kjo është një arsye tjetër që tregon rëndësinë ndërkombëtare të Liqenit të Shkodrës. Molusqe 39, Peshq, 63, Amfibët 17, Reptilët 33 (4 ujore), Shpendët 281 (50 ujore) Gjitarët 37 (1 ujore).

Nga Dhora & Sokoli (2000) është publikuar një listë me 124 kafshë ujore të rrezikuara të liqenit. Nëse do të merren parasysh edhe llojet tokësore, lista e faunës së rrezikuar të liqenit dhe pellgut ujëmbledhës do të ishte shumë më e madhe. Nga këto 124 lloje kafshësh ujore të rrezikuara, 9 janë molusqe, 33 janë peshq, 12 amfibe, 4 reptilë, 65 shpende dhe 1 është gjitar. Vihet re një përqindje e lartë e kafshëve të rrezikuara ndërmjet peshqve, amfibëve dhe shpendeve, ku përfshihen lloje me rëndësi globale.




Figura 8: Harta e Biodiversitetit, Bashkia Shkodër

Burimi: VSM e PPV Bashkia Shkodër

Lumi i Bunës

Përgjatë brigjeve të lumit Buna ka një biodiversitet me vlera të larta natyrore. Bimësia pyjore dikur ka qenë shumë më e pasur sesa sot. Një prej faktorëve kryesore degradues ka qenë prerja e paligjshme e drurëve deri në kufijtë e një shpyllëzimi të plotë. Bimësi pyjore gjendet në NJA malore, brigjet e lumit në Rezervatin e Velipojës, Ishullin Ada, në fshatrat Reç, Sutjel, Shënkoll dhe në ishullin e Bahçallekut. Bimësia e sipërfaqeve pyjore të zonës ulët përbëhet kryesisht nga disa lloje plepash (*Populus*), shelgjesh (*Salix*), frashëri (*Fraxinus*), dushqesh (*Quercus*) rrushkulli (*Ruscus aculeatus*), akacia (*Robinia pseudoacacia*), thana (*Cornus mas*), shkoza (*Carpinus betulus*), marina (*Tamarix parviflora*), etj.

Në lumin Buna gjenden mbi 30 llojë peshqish, që gjenden edhe në Liqenin e Shkodrës: krapi (*Cyprinus carpio*), karasin (*Carassius auratus gibelio*), gjucën (*Alburnus alburnus alborella*), njiën (*Chondrostoma nasus ohridanus*), skortën e zezë (*Pachychilon pictum*), lloskën (*Scardinius erythrophthalmus scardafa*), mëlyshin (*Leuciscus cephalus albus*), sharmakun (*Perca fluviatilis*), barburiqin (*Blenius fluviatilis*), etj.

Buna është rrugë kalimi për 13 lloje e nënlloje peshqish të konstatuar që migrojnë nga liqeni për në det dhe anasjelltas. Ndër to përmendim blinin (*Acipenser sturio*) që është lloj globalisht i rrezikuar, kublën (*Alosa fallax nilotica*), ngjalën (*Anguilla anguilla*), levrekun (*Dicentrarchus labrax*), qefullin e verës (*Mugil cephalus*), qefullin e vjeshtës (*Liza ramada*), shojzën (*Platichthys flesus luscus*), etj. Në hapësirën e grykëderdhjes së Bunës ka mbi 50 lloje të tjerë peshqish, ku ndër më të njohurit janë açuga (*Engraulis encrasicolus*), çeliku (*Aphanius fasciatus*), gjilpërëza turigjatë (*Syngnathus tenuirostris*), korbi i zi (*Sciaena umbra*), korbi i bardhë (*Umbrina cirrosa*), sargu (*Diplodus sargus sargus*), murra (*Lithognathus mormyrus*), aterina (*Atherina hepsetus*), gjuhëza e Adriatikut (*Solea vulgaris*), etj.

Buna, së bashku me ujërat pranë saj, përfaqëson një nga sipërfaqet më të pasura me shpend në rajon.

Grykëderdhja e Bunës, Rezervati i Velipojës, Këneta e Domnit, Laguna e Vilunit, Liqeni i Shasit, kriporja e Ulqinit, sipërfaqja kënetore e Shtojt të Poshtëm të Ulqinit janë të populluara me shpendë, veçanërisht në dimër. Këto sipërfaqe përfshihen në një rreth prej tre rrugëve të migrimit të shpendëve të Evropës

Në Bunë janë numëruar rreth 50 lloje shpendësh ujore. Ndër to kredharaku i vogël (*Tachybaptus ruficollis*), karabullaku i vogël (*Phalacrocorax pygmeus*), kryekuqja e madhe (*Anas penelope*), rosa e vendit (*Anas platyrhynchos*), rosa sqeplugë (*Anas clypeata*), rosa kërre (*Anas crecca*), kryekuqja e mjeme (*Aythya ferina*), rosa me katër sy (*Bucephala clangula*), bajza (*Fulica atra*), cinja (*Vanellus vanellus*), pulëbardha e zakonshme (*Larus ridibundus*), etj.

Rëndësi të veçantë ka pulëbardha e vogël (*Larus minutus*) dhe dallëndyshja e detit (*Sterna sandvicensis*), numri i të cilave konsiderohet i rëndësishëm ndaj numrit të përgjithshëm për Shqipërinë dhe Mesdheun. Veçohet gjithashtu kriporja e Ulqinit e cila aktualisht është një nga mjediset më të përshtatshme për folezim të shumë llojeve si laraska e detit (*Haematopus ostralegus*), gjelaci symadh (*Burhinus oedicnemus*), kalorësi (*Himantopus himantopus*), sqepbiza (*Recurvirostra avosetta*), bisht-dallëndyshja (*Glareola pratincola*), vrapuesi gushëbardhë (*Charadrius alexandrinus*), dallëndyshja e vogël e detit (*Sterna hirundo*), etj.

3.4.1.2. Bashkia Vau i Dejës⁸

Territori i Bashkisë Vau i Dejës është i ndërthurur dhe është pjesë e një areali të pasur faunistik dhe floristik, ku janë të gjitha kushtet për zhvillimin e faunës dhe të florës mjaft të larmishme, për ruajtjen e së cilës duhet të kujdeset e të kontribuojë i gjithë komuniteti.

Në këtë territor, takohen një sërë ekosistemesh si ato ujore, shkurre mesdhetare përherë të blerta dhe gjetherënëse, pyje gjethegjerë e halore dhe të përziera, livadhe e kullota.

Fauna: Sipas studimeve dhe monitorimeve të institucioneve të ndryshme shkencore dhe akademike, për sa u përket shpendëve, mund të thuhet se këta përbëjnë një pjesë të konsiderueshme me vlera për llojet e ekosistemet të cilat takohen brenda këtij territori.

Në ujërat e ekosistemeve ujore (lumenjve dhe liqeneve) kemi një shumëllojshmëri të popullatave të peshqve ku si më me vlera mund evidentohen këto lloje kryesore: Krapa (*Cyprinus carpio*), Ngjala (*Anguilla anguilla*), Kavalli i lumit (*Lampetra fluviatilis*). Ky i fundit është lloj i rrezikuar dhe duhet që të merret në mbrojtje.

Shpendët dhe gjitarët, janë elementët më tërheqës dhe më të rëndësishëm në përbërje të biodiversitetit në këtë zonë. Në ekosistemet pyjore të territorit të Bashkisë Vau i Dejës, rriten dhe strehohen gjitarë e shpendë nën mbrojtje të veçantë. Në kafshët më të rralla dhe që janë me statusin e llojeve të cënuara apo në rrezik zhdukjeje mund të përmenden: Derri i egër (*Sus scrofa*) dhe Macja e egër (*Felis silvestris*).

Por, përveç këtyre, takohen edhe gjitarë të mëdhenj si: Ujku (*Canis lupus*), Çakalli (*Canis aureus*), Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Kunadhja (*Martes foina*), Zardafi (*Martes martes*), Baldosa (*Meles meles*), Qelbësi (*Mustela putorius*), Ketri (*Sciurus vulgaris*), Lepuri i egër (*Lepus Capensis*), Nuselala (*Mustela nivalis*), Lundërza (*Lutra lutra*), Rriqebulli (*Lynx*), etj.

⁸ VSM e PPV Bashkia Vau i Dejës

Ndërsa në llojet e rralla të shpendëve që kanë këto statuse dhe që hasen në pyjet e rajonit janë: Thëllëza e fushës (*Perdix perdix*), Kumuria (*Steptopelia decaocto*), Skifteri (*Acipiter nisus*), Gakthi (*Bataurus stelboris*), Shkaba (*Gyps fulvus*), Gjeraqina (*Accipiter gentilis*), Huta me kalca (*Butea lagopus*).

Gjithashtu, takohen dhe një sërë zvarranikësh, ku për vlera të veçanta përmendim Nepërkën me brirë (*Vipera amodytes*), Bollën leopard (*Eiapha situla*), etj.

Flora: Përsa i takon diversitetit biologjik, mund të thuhet se territori i Bashkisë Vau i Dejës është mjaft i pasur në lloje bimësh dhe drurësh pyjore që gjejnë kushte të përshtatshme për rritje e zhvillim, që nga 30 e deri në lartësinë 1.800 m mbi nivelin e detit. Ato janë natyrale dhe të kultivuara.

Pyjet dhe kullotat zënë një sipërfaqe të konsiderueshme me vlera ekonomike, mjedisore, rekreative, turistike. Pyjet shpërndahen në të gjithë territorin e bashkisë, por veçanërisht në zonën malore, ku gjenden pyjet e lartë dhe me vlera të larta peizazhistike.

Duke u bazuar në ndarjen e re territoriale dhe në ligjin për administrimin e pyjeve dhe kullotave, rezulton se pjesa më e madhe e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të territorit të Bashkisë Vau i Dejës janë nën administrimin e saj.

Me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, Bashkise Vau i Dejës i është transferuar një sipërfaqe e konsiderueshme prej rreth 28.465 ha, nga e cila:

- Sipërfaqe pyjore 18.478.22 ha;
- Sipërfaqe kullosore 2.349 ha;
- Sipërfaqe djerrë, joproduktive dhe bimësi pyjore 7 .581.01 ha.

Grupet kryesore të llojeve të drurëve janë:

- Llojet halorë, 2.319.6 ha;
- Llojet fletorë, 16.158.62 ha.

Në grupin e parë bëjnë pjesë:

Pisha e butë (*Pinus pinea*), Pisha e egër (*Pinus halepensis*), Pisha e zezë (*Pinus nigra*), Pisha radiate (*Pinus radiata*), Selvia (*Cupressus sempervirens*), Hartina (*Pinus sylvestris*), etj.

Në grupin e dytë bëjnë pjesë:

Lisi (*Quercus pubescens*), Bunga (*Quercus Petraea*), Qarri (*Quercus cerris*), Ilqja (*Quercus ilex*), Akacia, Plepi i bardhë (*Populus alba*), Plepi i zi (*Populus nigra*), Shelgjet (*Salix alba*, *Salix purpurea*, *Salix fragilis*), Shkozat (*Carpinus betulus* dhe *Carpinus orientalis*), Frashëri gjethengushtë (*Fraxinus angustifolia*), Frashëri i bardhë (*Fraxinus ornus*), Gështenja (*Castanea sativa*), Arra (*Juglans regia*), Lajthia (*Corylus avellana*), Bliri (*Tilia ophisinalis*), Panja (*Acer platanooides*), Rrapi (*Pistanus orientalis*), Verri (*Alnus cortex*), Verri i zi (*Alnus glutinosa*), Dafina (*Laurus nobilis*), Bushi (*Buxus sempervirens*), Shqopa (*Erica arborea*), Mareja (*Arbutus unedo*), Thana (*Cornus mas*), Shqeme (*Rus coriaria*), etj.

Gjithashtu sipërfaqet pyjore dhe kullosore të Bashkisë Vau i Dejës, janë mjaft të pasura edhe me një grup tjetër të rëndësishëm sikurse janë bimët mjekësore, eterovajore e tanifere si: Trëndafili i egër (*Rosa canina*), Agulicja (*Primula veris*), Trumza (*Saturea montana*), Zhumbrica (*Thimus spergillum*), Çikorja (*Cichorium intybus*), Grami (*Cynodon dactylon*), Barpate (*Polygonum aviculare*), Thundërmushkë (*Tussilago farfara*), Luleshtrydhe (*Fragaria vesca*), Netulla (*Verbascum thapsiforme*), Njëmijëfletëshi (*Aquillea miliefolium*), Lulëkuqja (*Papaver rhoeas*), Sherebela (*Salvia officinalis*), Lisna (*Thymus*

longicaulis), Mjedra (*Rubus idoeus*), Xina (*Pistacia lentiscus*), Bari i gjarprit (*Teucrium chamaedrys*), Zogëla (*Frangula alnus*), Shpendra (*Helleborus edaurs*), Gjuhëusja (*Ononis Spinosa*), Lulebasani (*Hypericum perforatum*), Rigoni i kuq (*Origionium vulgare*), Veronika mjekësore, (*Veronica officinalis*), Boronica (*Vaccinium myrtillus*), Xherrokulli (*Colchicum autumnale*), Murrizi (*Crataegus monogyna*), Gjineshtra (*Spartium junceum*), Driza (*Paliuris aculeatus*), Rrushkulli (*Ruscus aculeatus*), Vjeshtull lisi (*Viscum album*), Salepi (*Orchis mascula*), Bleri, Dëllinjat, Hithra (*Urtica dioica*), etj.

Kullotat natyrore brenda territorit të Bashkisë Vau i Dejës, sipas të dhënave të marra nga Kadastra e Fondit Pyjor dhe Kullosor, kanë një sipërfaqe të përgjithshme prej 2.349 ha, e cila sipas periudhës së shfrytëzimit të tyre jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5: Kullotat natyrore brenda territorit të Bashkisë Vau i Dejës

Tipi i kullotes	Sipërfaqja (ha)
Dimërore	779.6
Verore	1.569.4
Totali	2.349

Burimi: VSM e PPV Bashkia Vau i Dejës

3.4.2. Zonat e mbrojtura

E gjithë zona e projektit brenda grykëderdhjes së Bunës njihet si zonë e mbrojtur edhe nga shteti edhe nga institucionet ndërkombëtare. Është gjithashtu një zonë ndërkufitare e mbrojtur që ndahet me Malin e Zi. Grykëderdhja së bashku me liqenin e Shkodrës është një vend i njohur ndërkombëtarisht dhe i mbrojtur nga Konventa Ramsar, përcaktuar në vitin 2006. Mbrojtja nga Konventa Ramsar përfshin konkretisht Lumin e Bunës, zonën pyjore, kënetat me ujë të ëmbël dhe kullotat me ujë. Kërcënimi kryesor për vendin, i renditur në citimin e Konventës Ramsar, përfshin bonifikimin e tokës nëpërmjet drenazhimit, zhvillimit të bujqësisë dhe ndryshimit të regjimit të ujit. Speciet e bimëve të cituara në Konventën Ramsar përfshijnë dymbëdhjetë specie të rrezikuara, dymbëdhjetë specie vulnerabel dhe dhjetë specie të rralla. Gjithashtu, ajo përkrah 36 specie kafshësh të kërcënuara në botë. Kënetat e Domnit, ngjitur me Kolektorin e Murtemzës, njihet gjithashtu ndërkombëtarisht si një zonë e rëndësishme për shpendët (ZRSB) (Mott MacDonald, 2012a). Plani i Mbrojtjes së Biodiversitetit të Bashkisë Shkodër 2017 thekson përdorimin e detyrueshëm të qëndrueshëm të zonave të përcaktuara si zona të mbrojtura për hir të ruajtjes së biodiversitetit.

Ligji Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” parashikon gjashtë kategori të menaxhimit të zonave të mbrojtura për mbrojtjen e habitateve apo specieve në përputhje me Bashkimin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Për të gjithë zonën përreth Deltës së Bunës dhe Liqenit të Shkodrës aplikohen Kategoritë III, IV dhe V (Mott MacDonald, 2019):

- **Kategoria III Monument i Natyrës:** Pylli në Deltën e Bunës (i pasur me bimësi ligatinore, habitat i rëndësishëm për folenizimin e shpendëve)
- **Kategoria IV Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror:** Liqeni i Shkodrës (26,535.00 ha)
- **Kategoria V Peizazh i Mbrojtur:** Lumi Buna – Velipojë (23,027.00 ha)

Liqeni i Shkodrës si 'Rezervat Natyror i Menaxhuar/Zonë Menaxhimi për Habitatet dhe Speciet e Kategorisë IV është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.684, datë 02.11.2005, ndërsa zona përreth deltës së Bunës (Lumi Buna – Velipojë).) si 'peizazh i mbrojtur' i Kategorisë V është miratuar me VKM Nr. 682 në 02.11.2005.

Neni 9 i ligjit nr. 81/2017 përcakton objektivat për të gjitha zonat e mbrojtura mjedisore brenda ligjit.

Neni 9e deklaron për shembull parandalimin e çdo 'ndryshimi të gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve ligatinore'.



Figura 9: Harta e Zonave të Mbrojtura në zonën e projektit (MTM)

Situata e zonave të mbrojtura sipas Direktivës Kuadër të Ujit për pellgun e lumit Drin-Buna përfshin jo vetëm zonat e sipërpërmendura të përcaktuara për mbrojtjen e habitateve ose specieve, por gjithashtu edhe sa më poshtë:

- **Zonat e Mbrojtura Sanitare:** Aktualisht, pusët që përdoren për nxjerrjen e ujit të pijshëm nga shoqëritë e ujësjellësit dhe pusët private nuk janë të regjistruara si zona mbrojtëse sanitare për ujë të pijshëm. Kjo vlen për disa pusë në zonën e projektit siç janë pusët në Trush/Velipojë, Badica Zogaj, Badica Zues dhe në Oblikë. (Mott MacDonald, 2019)
- **Zonat e përcaktuara për mbrojtjen e specieve ujore me rëndësi ekonomike:** Autoriteti përgjegjës është MBZHR, i cili nuk ka shpallur zonë të mbrojtura peshkimi, por ka krijuar dy zona bashkëmenaxhimi me qëllim garantimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve të peshkimit dhe mbrojtjen e biodiversitetit ujor, konkretisht Liqeni i Shkodrës dhe Lumi Buna dhe Liqeni i Ohrit, i cili nuk është brenda zonës së projektit. (Mott MacDonald, 2019)
- **Trupa ujore të përcaktuara si ujëra rekreative dhe për larje:** Shpallja e zonave për larje është detyrë

e Pushtetit Vendor, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, si dhe menaxhimi i zonës është në përgjegjësinë e tyre. Në rrethin e pellgut të lumit Drin-Buna, zonat kryesore të banjës janë Plazhi i Velipojës dhe Plazhi i Shëngjinit (Plazhi i Shëngjinit nuk është në zonën e projektit). (Mott MacDonald, 2019)

Shqipëria nuk e ka transpozuar Direktivën e Nitrates. Legjislacioni shqiptar, në vend të kësaj, i referohet Ligjit nr. 9244/2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” dhe Ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”. I pari synon mbrojtjen e burimeve ujore nga inputet bujqësore, ndërsa i dyti përcakton përgjegjësitë institucionale siç është AMBU që është përgjegjëse për mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja bujqësore. (Mott MacDonald, 2019)

3.5. Popullsia dhe Shëndeti i Njeriut

Aktualisht, zona e projektit ka një popullsi prej 139,055 banorësh. Pas Shkodrës që përbën më shumë se gjysmën e popullsisë së zonës së projektit, njësitë administrative Rrethinat (15,2%) dhe Bushati (10,2%) janë të banuara me numrin më të madh të popullsisë.

Për të gjithë Republikën e Shqipërisë për sa i përket shpërndarjes gjinore, vihet re një mbipeshë e qartë e meshkujve tek të rinjtë rezidentë deri në 39 vjeç, e cila zëvendësohet nga mbipesha e femrave me rritjen e moshës. Gjatë viteve të fundit, numri i banorëve është ulur në total, me një rritje diskrete të përqindjes së banorëve femra dhe një rënie të përgjithshme të meshkujve. Shifrat më të mëdha janë për grupmoshat 15-34 dhe 50-64 vjeç.

Këto prirje janë pasqyruar në analizë edhe për qarkun e Shkodrës. Popullsia përjeton një tendencë plakjeje dhe zvogëlimi me një numër pak më të lartë të banorëve femra në qark.

Tabela 6: Popullsia rezidente sipas gjinisë, grupmoshës dhe njësisë administrative

NJA	Gjinia dhe grupmosha						Total NJA	Përqindja e tërë popullisë
	Meshkuj			Femra				
	0-14	15-64	65+	0-14	15-64	65+		
Bashkia Shkodër								
Ana e Malit	380	1,249	280	372	1,290	287	3,858	≈ 2.8%
Berdicë	661	1,919	343	593	1,891	366	5,773	≈ 4.2%
Dajç.	310	1,244	331	285	1,354	361	3,885	≈ 2.8%
Guri i Zi	946	2,677	444	952	2,567	499	8,085	≈ 5.8%
Rrethinat	2,870	6,708	1,040	2,632	6,836	1,113	21,199	≈ 15.2%
Shkodër	7,823	25,072	4,735	7,080	27,034	5,331	77,075	≈ 55.4%
Velipojë	550	1,662	310	494	1,693	322	5,031	≈ 3.6%
Bashkia Vau i Dejës								
Bushat	1,473	4,601	983	1,409	4,664	1,019	14,149	≈ 10.2%
Shuma	15,013	45,132	8,466	13,817	47,329	9,298		139,055
% e tërë popullisë	≈ 10.8%	≈ 32.5%	≈ 6.1%	≈ 10.0%	≈ 34.0%	≈ 6.7%		100%

Burimi: INSTAT Censusi 2011




Figura 10: Popullsia mesatare vjetore sipas grupmoshës dhe gjinisë në Qarkun Shkodër për vitin 2016

Burimi: INSTAT Censuri 2011




Figura 11: Zhvillimi demografik sipas gjinisë në Qarkun Shkodër 2016-2020

Burimi: INSTAT

Minoritetet dhe grupet e marginalizuara shpesh kundërshtojnë shifrat zyrtare, duke pohuar një numër më të lartë të popullsisë së vendit.

Për zonën e projektit ka kryesisht komunitete rome në përgjithësi dhe të zhvendosur nga zonat malore. Sipas ekspertizës lokale numërohen gjithsej 173 familje të vendosura rreth zonës urbane, liqenit të Shkodrës dhe bregut të lumit Drin. Burimi kryesor i tyre i të ardhurave është mbledhja e mbetjeve të riciklueshme si metalet, letra dhe kartoni dhe plastika, krahas lypjes për lëmshë dhe bamirësi. Si të tilla, këto komunitete nuk mund të mbështeten në shërbimet publike në zonat e tyre pasi nuk u shërbejnë. Natyrisht, ekziston një përjashtim i përgjithshëm i këtyre komuniteteve rome. Megjithatë, rreth 130 fëmijë nga këto familje vijojnë shkollën.

Për përshkrimin e rrezikut nga përmbytjet, referuar receptorit të rrezikut “shëndeti i njeriut” rëndësi ka përshkrimi i banorëve, shtëpive dhe banesave potencialisht të prekura. Këto janë si më poshtë.

Tabela 7: Banorët që mund të preken (sipas skenarëve të përmbytjeve HQ010, HQ100, HQ500)

Njësia Administrative	Banorët e prekur		
	HQ010	HQ100	HQ500
Bashkia Shkodër			
Ana e Malit	490	510	510
Berdicë	800	2990	3140
Dajç	700	3350	3390
Guri i Zi	340	1210	1350
Rrethinat	50	210	240
Shkodër	2730	9660	11,140
Velipojë	850	1430	1690
Bashkia Vau i Dejës			
Bushat	470	1410	1720
Total	6430	20770	23,180
% e tërë popullsisë (= 139,055 banorë)	≈ 4,6%	≈ 14,9%	≈ 16,7%

Burimi: PMRRP




Figura 12: Popullsia e prekur nga përmbytjet e mundshme në Qarkun e Shkodrës ilustruar sipas NJA dhe skenarit të përmbytjeve (Burimi: PMRRP)

Tabela 8: Ndërtesat që mund të preken (sipas skenarëve të përmbytjeve HQ010, HQ100, HQ500)

Njësia Administrative	Banorët e prekur		
	HQ010	HQ100	HQ500
Bashkia Shkodër			
Ana e Malit	125	130	130
Berdicë	223	830	871
Dajç	433	2065	2093
Guri i Zi	81	292	325
Rrethinat	19	88	99
Shkodër	672	2380	2743
Velipojë	770	1289	1520
Bashkia Vau i Dejës			
Bushat	282	856	1043
Total	2605	7930	8824

Burimi: PMRRP




Figura 13: Popullsia e prekur nga përmbytjet e mundshme në Qarkun e Shkodrës ilustruar sipas NJA dhe skenarit të përmbytjeve (Burimi: PMRRP)

Gjatë ngjarjes së përmbytjes në dhjetor 2010 (e konsideruar si ngjarje ekstreme përmbytjeje) numri i përgjithshëm i dokumentuar i të prekurve përkatësisht. banorët e evakuuar në këtë zonë ishte rreth 12,145 dhe numri i shtëpive të prekura ishte rreth 7,120 (4,540 shtëpi të përmbytura dhe 2580 shtëpi të rrethuara me ujë). Me këto të dhëna, vlerësimet e GIS-it duken të besueshme.

Referuar gjithë popullsisë së qarkut të Shkodrës, popullsia e prekur në të gjithë skenarët e përmbytjeve


është e rëndë edhe pse nga njëra anë emigracioni i lartë vihet re në zonat e Anës së Malit (fshati Obot) dhe Gurit të Zi (Kuç dhe Rrencë; nga ana tjetër. Përshtatja e ndërtesave dhe banesave kundër përmbytjeve është realizuar për shembull në Berdicë dhe Dajç Heqja e themeleve të ndërtesave të reja në fshatrat Fshat i Ri, Mali i Jushit, Hoten, Rranxa dhe Konej në NJA Bushat janë aktualisht në vazhdim.

3.6. Përdorimi i tokës

Aktiviteti ekonomik në qarkun e Shkodrës dominohet nga bujqësia, pylltaria dhe peshkimi, gjë që reflektohet në shifrat e sipërmarrësve aktivë dhe në të dhënat e përdorimit të tokës. Përdorimi i tokës u analizua bazuar në të dhënat evropiane të mbulimit të tokës Corinne (2012), të përmirësuar nga të dhënat e Copernicus të Atlasit Urban (2012) dhe Harta "Open Street" (PMRRP).

Tabela 9: Përdorimi total i tokës në Qarkun e Shkodrës

Kategoria e përdorimit të tokës	Sipërfaqja [ha]
tokë arë	22,538
kullotë	11,407
banim	5,055
ujë	2,204
pyll	1,244
kënetë	1,221
shkëmb	858
trafik & transport	603
industri	544
tjetër	106
parkim	60
Total	45,840



Burimi: PMRRP

Përdorimi i tokës në nën-pellgun e pellgut të lumit Drin/Drim-Buna/Bojana në Shqipëri karakterizohet kryesisht nga zona gjysmë natyrore (kullota natyrore, bimësi sklerofile, pyje-shkurre kalimtare dhe zona me bimësi të rrallë). Ca. 29% e rajonit është pyll (kryesisht pyll gjethegjërë). Kultivimi fokusohet në pellgun e Bunës dhe në rajonin e liqenit të Shkodrës. Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë të tokave potencialisht të prekura të klasifikuara sipas përdorimit.

Tabela 10: Përdorimi i tokës në zonat që mund të përmbeten në pellgun e lumit Drin-Buna

Kategoria e përdorimit të tokës	Sipërfaqja [ha]	Sipërfaqja e prekur [ha]			Përqindja e sipërfaqes së prekur [%]		
		HQ010	HQ100	HQ500	HQ010	HQ100	HQ500
tokë arë	22,538	9,485	12,980	13,524	42.1%	57.6%	60.0%
pyll	1,244	0	0	1	0.0%	0.0%	0.0%
kullotë	11,407	970	1118	1,165	8.5%	9.8%	10.2%
industri	544	70	147	160	12.9%	27.0%	29.4%
kënetë	1,221	1,088	1,098	1,100	89.1%	89.9%	90.1%
tjetër	106	11	28	31	10.0%	26.3%	29.4%
parkim	60	4	6	6	7.5%	10.5%	10.8%
shkëmb	858	91	111	118	10.6%	12.9%	13.7%
banim	5,055	411	1,082	1,174	8.1%	21.4%	23.2%
trafik & transport	603	75	166	179	12.4%	27.4%	29.7%
ujë	2,204	1,128	1,179	1,184	51.2%	53.5%	53.7%
Total	45,840	13,333	17,915	18,643	29.1%	39.1%	40.7%

Burimi: PMRRP

Kategoria e përdorimit të tokës më të prekur nga përmbytjet është toka e kultivuar - rreth 9,500 ha në HQ010, 13,000 ha në HQ100 dhe 13,500 ha në HQ500 (shih Figurën e veçantë 30). Sipas dëshmimeve të Drejtorisë së Zhvillimit dhe Trajtimit Rural të AMTP 3201 në qark, gjatë përmbytjeve të kaluara në mars 2018, toka e kultivuar dhe bujqësore janë prekur shumë me një dëm ekonomik prej rreth 303,729,000 lekë të gjitha së bashku në Anën e Malit, Bërdicë, Dajç, Rrethina dhe Velipojë.

Duke mbledhur kullota me vlerë për bagëtinë prej rreth 1,100 ha, shuma e tokës potencialisht të prekur për aktivitetin ekonomik bujqësor është e barabartë me 10,600 ha në HQ010, 13,100 ha në HQ100 dhe 13,600 ha përkatësisht në skenarin e përmbytjes HQ500. Në ngjarjen e përmbytjes së dhjetorit 2010, edhe disa bagëti u rrethuan nga uji dhe u mbytën (rreth 32,634 kafshë u evakuuan).




Figura 14: Tokë e kultivuar potencialisht e përmbytur në skenarët përkatës të përmbytjeve HQ010, HQ100 dhe HQ500 për njësi administrative të Qarkut Shkodër
Burimi: PMRRP

3.7. Trashëgimia kulturore

Bashkia Shkodër⁹ ka në territorin e saj një numër të konsiderueshëm veprash të trashëgimisë kulturore dhe historike. Kryesisht ato shtrihen në territorin e qytetit të Shkodrës, pjesë e të cilit është shpallur edhe si qendër historike.




Figura 15: Harta e trashëgimisë kulturore, Bashkia Shkodër
Burimi: PPV, Bashkia Shkodër

⁹ Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër

Përsa i përket trashëgimisë kulturore Shkodra ka 2 monumente objekt kulti të kategorisë së I. Ka tre monumente vepra inxhinierike të kategorive I, II, dhe III. Gjithashtu, ka 102 monumente të arkitekturës vernakulare të pozicionuara kryesisht në territorin e qytetit të Shkodrës. Mbi 90% e tyre janë monumente të kategorisë së parë, ndërkohë që pjesa tjetër të kategorisë së II. Në vitet e fundit ka pasur disa iniciativa për restaurimin e këtyre monumenteve, ku dallon veçanërisht investimi në pedonalen e Shkodrës si dhe në rrugën Gjuh'a'Dol. Këto investime kanë ndihmuar edhe në përmirësimin e imazhit të qytetit dhe tërheqjen e shumë vizitorëve. Gjithashtu, ato kanë ndihmuar dhe në zhvillimin e bizneseve lokale. Në territorin e bashkisë Shkodër ka 2 monumente "vendbanime" të kategorisë së parë si dhe tre monumente "vepra arti" të kategorisë së parë. Gjithashtu ka disa 2 monumente të varrezave dhe disa zonifikime të rëndësishme arkeologjike. Në fund ka dhe 11 monumente "ndërtesa të projektuara" të cilat janë të kategorisë së parë dhe të dytë.

Bashkia e Vaut të Dejës¹⁰, përfshin në juridiksionin e saj një territor mjaft të gjerë dhe të pasur me objekte të trashëgimisë kulturore, të shpallura me status "monument kulture" si dhe objekte të tjera me vlerë, pa status.

Objekte të Trashëgimisë Kulturore të shpallura me status "Monument Kulture"¹¹:

- Kalaja e Sapës, shek. VII p.e.s., vendndodhja Nenshat
- Kalaja e Vigut, shek. I, vendndodhja Vig
- Zona Arkeologjike "A" dhe "B" e Vendbanimit të Komanit shek.I, vendndodhja Koman
- Varrezat e lashta të Komanit, shek.VI-IX, vendndodhja Koman
- Kalaja e Dalmacës, shek. VI VIII-IX, vendndodhja Koman
- Kisha e Shën Mërisë, shek.VIII, vendndodhja Vau Dejës
- Kalaja e Vau Dejës, shek. XIV, vendndodhja Vau Dejës
- Rrënojat e Kishës së Shën Markut, shek.VIII-IX, vendndodhja Vau Dejës
- Kalaja e Shurdhahut, shek. XI, vendndodhja Vau Dejës
- Kompleksi Ndre Mjeda dhe Zona Mbrojtëse, shek. XX, vendndodhja Kukel

Pjesa më e madhe e këtyre vlerave të trashëgimisë kulturore për shkak të rrethanave historike, kanë mbërritur deri në ditët tona në gjendje rrënojë, ardhur si pasojë e shkatërrimeve të bëra nga pushtuesit osmanë. Njoftimet më të vjetra edhe pse të pakta për këto monumente, gjenden ndër burime historike të periudhës mesjetare. Në këto dokumente ka të dhëna me mjaft vlerë për numrin dhe vendndodhjen e monumenteve, madhësinë dhe mënyrën e ndërtimit të tyre. Studimet e para të arkitekturës së këtyre ndërtimeve janë të fundit të shekullit XIX, nga konsulli i atëhershëm austriak në Shkodër Teodor Ippen.

Gjatë luftërave për nënshtrimin e Ilirisë dhe Epirit romakët dogjën dhe shkatërruan një numër të madh qytetesh të fortifikuar dhe kështjellash. Në shekujt e parë të erës sonë vihet re një ndërprerje e veprimtarisë fortifikuese që përkon me të ashtuquajturën "paqe romake", për më tej për të përballuar dyndjet e "barbarëve" dhe lëvizjet e brendshme, ajo rinis sërish. Veprimtaria e ndërtimit të fortifikimeve në periudhën e vonë antike fillon nga fundi i shek.111 dhe fillimi i shek. IV.

Ndërtimet e kultit të Shqipërisë së Veriut, në drejtim të arkitekturës së tyre paraqesin një sërë veçantish të kushtëzuara nga lidhja gjithnjë e peshkopatave të kësaj zone me kishën e Perëndimit. Në këto rrethana, kemi krijimin e trajtave të veçanta, të kushtëzuara nga influencat arkitekturale të Bizantit apo perëndimit.

¹⁰ Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vau i Dejës

¹¹ http://iktk.gov.al/site/wp-content/uploads/2020/10/Monumentet_-_Qarku-Shkoder.pdf

Mangësite e burimeve të shkruara nga Mesjeta e hareshme shqiptare ndikuan që t'u jepej përparësi kërkimeve arkeologjike shqiptare si një nga mundësitë parësore për të ndriçuar këtë periudhë të hershme ku ndërthuren tre kultura të ndryshme të të gjithë trevës së Veriut: Malësisë, Mirditës dhe Zadrimës.

Si pjesë e receptorit të rrezikut "trashëgimia kulturore", objektet në rrezik të identifikuar në të dyja bashkitë janë:

- Vendet fetare, përkatësisht xhamitë dhe kishat,
- Varrezat, dhe
- Monumentet e kulturës



Figura 16: Kisha e vjeter e Shirqit (foto autori)

Në total rrezikohen 13 objekte në HQ010, 36 në HQ100 dhe 37 objekte në rast përmbytjesh ekstreme (HQ500). Situata e rrezikut nuk ka ndryshuar që nga viti 2014.

Tabela 11: Objektet e rrezikut potencialisht të prekur të receptorit të rrezikut "trashëgimia kulturore" e diferencuar nga skenarët e përmbytjeve HQ010, HQ100, HQ500

Objekti i rrezikut	Skenari i përmbytjes		
	HQ010	HQ100	HQ500
703-kishë	6	12	13
704-hotspot kulturor	2	5	5
705-varreza	3	8	8
709-xhami	2	11	11
Total	13	36	37

Burimi: PMRRP

Në Gur të Zi është ndërtuar një xhami e re me tipare të përshtatura ndaj përmbytjeve. Niveli i rrezikut vlerësohet të jetë i ulët.

3.8. Peizazhi

Në territorin e Bashkisë Shkodër¹² ekziston një gamë e gjerë peizazhike natyrore, që nga malet deri tek vija bregdetare e Adriatikut, nga brigjet e liqenit më të madh në Ballkan deri në muret shkëmbore të

¹² Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër

Kështjellës së Rozafës. Peizazhi është i dallueshëm si peizazh liqenor i Liqenit të Shkodrës me bimësinë përreth liqenit, Mali i Taraboshit me veshjen pyjore, peizazhi pyjor i Thethit dhe zonave të tjera të mbrojtura, peizazhi urban i qytetit të Shkodrës, peizazhi i gjërë natyror, peizazhi lumor i Drinit dhe Bunës me gjelbërimin e brigjeve, vendkalimet, bimësia etj.

Bashkia e Shkodrës ndodhet në influencat e baseneve lumore (Drini, Buna, Kiri, Shala), liqenit të Shkodrës, maleve përreth, Alpeve; territori përmban ekosisteme të ndryshëm ekologjikisht, habitate karakteristike dhe të rendësishme që janë cënuar nga disa ndikime në mjedis. Vlera ekologjike të zonave me veriore (Pult, Shalë, Shosh) qëndron në burimet natyrore si pyjet, alpet, ujërat, biodiversiteti, vlerat peizazhike dhe mjedisore. Zona e Nënshkodrës karakterizohet nga kthimi i lumenjve në fushorë me impakte mjedisore, në veçanti përmbytjet.

Analiza Peizazhistike e territorit të bashkisë Shkodër përbëhet nga një sërë komponentësh peizazhformues të cilët kategorizohen në peizazh Urban, Rural, Natyror dhe Ujor/Liqenor.

Megjithëse këta komponent kanë tipologji ndryshe nga njeri-tjetri dhe gjenden në zona të ndryshme të territorit duke ofruar shumëllojshmëri peizazhistike brenda territorit të Bashkisë.

Peizazhi Urban: përbëhet nga zona rezidenciale, komerciale nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore, pemë apo grupime pemësh zbukurimi, parqe si dhe zona buferike. Shkodra karakterizohet nga mungesa e parqeve masive të gjelbra për frymë të popullsisë.

Peizazhi Rural: karakterizohet nga toka të hapura në të gjithë territorin e Nënshkodrës me grupime pemësh/shkurresh, fasha natyrore e krijuar në bregun e detit, me pisha të kultivuara.

Peizazhi Natyror: karakterizohet nga sipërfaqe pyjore, fusha të hapura, koridore të gjelbër, trupa ujorë, diku i fragmentuar për shkak të zhvillimit bujqësor. Interes të veçantë ka korridori peizazhik që krijohet në të gjitha njësitë administrative rurale, fasha e gjelber që krijohet në brigjet e lumenjve Buna në të gjithë gjatesinë prej grykederdhjes deri në hyrje të Shkodrës e veshur me vegjetacion të shkëputur, fasha e gjelber e brigjeve të Drinit në të gjithë gjatesinë e bregut e veshur me bimësi të ndryshme si shelg, plep, mare, frashër etj.

Peizazhi liqenor: që formohet nga pellgu ujembledhës, pasqyra ujore, bimësia barishtore e drunore, pyje të kufizuar, livadhet rreth bregut të liqenit, mali Taraboshit, pika lidhëse me Bunën. Trupat ujorë mund të luajnë një rol të rëndësishëm si koridore kalimi nga një fashë peizazhistike në tjetrën, për jetën e egër, si dhe të biodiversitetit. Fasha peizazhike e sipërfaqeve ujore, e cila karakterizohet nga të gjithë trupat ujorë sipërfaqësor duke përfshirë lumenjtë, rezervuaret, kanalet vaditëse, shatërvanet dhe zonat ujëmbajtëse sezonale. Peizazhi ujor dominohet nga lumenjtë Drin, Buna, Kir, Shala, Liqeni Shkodrës të cilët shtrihen në fashën rurale përgjatë NjAve Velipojë, Dajç, Bërdice, Guri Zi, Rrethinat, Ana Malit, Shosh, Pult, Shalë.

Pjesë dominuese dhe e pandashme e peizazhit urban, **rrugët** ashtu si edhe sipërfaqet ujore shtrihen në mbare territorin e Bashkisë duke krijuar “çarje” të tipologjive peizazhistike; në anën tjetër ato krijojnë edhe lidhje fizike e vizive mes tipologjive peizazhistike.

Identifikimi i elementeve peizazhistik në fashën natyror të territorit të Bashkisë Shkodër, ku pjesë e pandashme e kësaj fashë janë edhe sipërfaqet të cilat i përkasin Fondit Pyjor dhe Zonave të Mbrojtura Natyrore mer rëndësi të veçantë, pasi identifikimi i këtyre elementeve ndikon drejtpërsëdrejti në të

kuptuarin e biodiversitetit lokal, potencialin e eko-turizmit si dhe gjendjen e fondit pyjor përfshirë këtu mbrojtjen e tij dhe fashës natyrore në tërësi nga rreziqet natyrore dhe njerëzore. Element të peizazhit natyror të gjendur në territorin e Bashkisë Shkoder në NjA-të Shosh, Pult, kryesisht në PK të Thethit luajnë një rol të rëndësishëm edhe në krijimin e mikroklimës në zonat ku ato shtrihen.

Gjithashtu në tërësi nga elementët përbërës të peizazhit natyror në Bashkinë Shkodër mbizotërojnë: trupat ujore (lumenjte, liqeni Shkodres), tokat e lagura, korridoret lidhës, rripat e gjelbër, trupat ujorë dhe parcelat e ndara, etj.

Sa i takon Bashkisë Vau i Dejës¹³, sistemi territorial nga i cili është e përbërë bashkia e re Vau-Dejës për shkak të bashkimit administrativ të gjashtë njësive të mëparshme Vau-Dejës, Bushat, Hajmel, Vig-Mnelë, Shllak, Temal, paraqet diversitet të dukshëm nga pikëpamja e profilit peizazhistik dhe territorial.

Në fakt, bëhet fjalë për një territor që, kur vërehet nga jugu në veri, nga kufiri me Bashkinë e Lezhës dhe Shkodrës, drejt njësive që i përkasin zonës së mbrojtur të Alpeve Shqiptare, duket kryesisht e karakterizuar nga tre lloje peizazhesh:

- A. zona fushore bujqësore, e karakterizuar nga sistemi i gjerë kullues afër rrjedhës kryesore ujore (lumi Drin), drejt bashkimit të saj me pellgjet ujore të rajonit të Shkodrës, ku zhvillimi i vendbanimeve ka qenë më i madh, shpesh duke dëmtuar tokat bujqësore me pjellori të lartë;
- B. territori ujor, i përbërë nga lumi Drin, i zgjeruar nga ndërtimi i hidrocentraleve të mëdha duke filluar nga fundi i viteve '60 (diga e Vau-Dejës dhe e Komanit);
- C. zona gjerë dhe pothuajse e pabanuar malore, një prelud për zhvillimin e sistemeve malore më të larta të rajonit, objekte të mbrojtjes mjedisore (Parku Kombëtar i Alpeve).

Ky klasifikim i peizazheve mbizotëruese, i realizuar vetëm për qëllimin strategjik të programit, nuk përfshin disa "përjashtime" lokale, të cilat gjithashtu duhen marrë parasysh për të pasur një analizë më të plotë dhe që mund të jenë një prelud për një artikulum të mëtejshëm të rregullave të përgjithshme, të cilat duhen zhvilluar në pjesën e rregullores së planit të ri:

- Peizazhi i korridorit infrastrukturor që përbëhet nga rruga kombëtare dhe linja hekurudhore;
- Peizazhi i kodrave që ngrihen brenda zonës fushore, dhe në të cilin gjenden vendbanimet e ultësirës.
- Peizazhi i qendrave të mëdha urbane, Bushat dhe Vau-Dejës, që ende nuk ngrihen në rangun e realiteteve të mirëfillta urbane, por që tashmë paraqesin një përqendrim urban të rëndësishëm nëse krahasohen me përqendrimin e ulët të vendbanimeve në zonat e tjera, sidomos në zonat malore.

3.9. Menaxhimi i mbetjeve

3.9.1. Menaxhimi i ujërave të përdorura

Problemi i menaxhimit të ujërave të përdorura në Bashkinë e Shkodrës është përmirësuar, por mbetet i pa zgjidhur. Sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane në Shkodër është ndërtuar në vitet 1980. Ujrat e ndotura me përjashtim të Shirokës, ku përpunohen para shkarkimit në Liqenin e Shkodrës, deri tani, të gjitha ujërat e qytetit dhe të njësive të tjera të perfshira në sistem, derdhen të pa përpunuara, krahas depozitimit në zonën rurale në gropa septike pa standarte.

Sistemi ekzistues i kanalizimeve mbulon 70% të territorit të qytetit, ndërsa zonat periferike i grumbullojnë në gropa septike. Me rritjen e dendësisë në qytet, shumë prej kanaleve ekzistuese janë

¹³ Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vau i Dejës

mbi kapacitetin e projektuar apo kanë kapacitet të reduktuar si pasojë e depozitimit të mbetjeve të akumuluar në kohë dhe që nevojitet të ristrukturoren. Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve (KUZ) e Bashkisë Shkodër, është përgjegjëse për kanalizimet të ujërave të zeza. Shumë nga zonat me zhvillim të shpejtë nuk kanë menaxhim efektiv të ujërave të ndotura. Janë ndërtuar kanalizime të paligjshme që derdhen drejt e në lumenj, ndërsa në njësite administrative përdoren gropat septike, të cilat shpesh janë standardit dhe rrjedhin, duke shkaktuar ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.




Figura 17: Rrjeti KUZ për qytetin e Shkodrës
Burimi: PPV, Bashkia Shkodër

Menaxhimi i ujërave të zeza, mbetet një ndër problemet prioritare mjedisore për zgjidhje në territorin e Bashkisë Shkodër, veçanërisht në derdhjet në liqen, duke shkaktuar probleme të eutrofikimit të ujërave, dëmtim të gjallesave dhe peshkut si dhe të sigurisë ushqimore të popullsisë, në sajë të konsumit të metaleve të rënda toksike nëpërmjet produkteve të peshkut.

3.9.2. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta¹⁴

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në të tri rajonet ku shtrihet baseni ujqor Drin-Bunë, karakterizohet nga mungesa e vendgrumbullimit të mbetjeve në zonat rurale, transporti i papërshtatshëm, mungesa e trajtimit dhe e venddepozitimeve të përshtatshme. Të tria rajonet depozitojnë mbetjet e ngurta të tyre në vendgrumbullimet e improvizuara shpesh pranë shtratit të lumit duke ndotur Basenin Ujqor Drin-Bunë dhe ujërat e tij. Shkodra është një nga rajonet e pakta që kanë një vendgrumbullim higjieno-sanitar (landfilli i Bushatit). Megjithatë, Qarku i Shkodrës gjithashtu ka 4 zona të papërshtatshme për vendgrumbullimin e mbetjeve të ngurta (vendshkarkime).

¹⁴ VKM Nr. 849, datë 4.11.2020 “Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujqor Drin-Bunë”




Figura 18: Vend depozitim ilegal Dajç (foto autori)

Venddepozitimet e Velipojës në Shkodër ndodhet rreth 670 metra nga lumi Drin, ndërsa Kukësi ka dy venddepozitime në distancë rreth 500m dhe 70m nga Drini i Zi dhe Liqeni i Fierzës respektivisht. Peshkopia gjithashtu ka një venddepozitim afër lumit në një distancë jo më shumë se 220 metra nga Përroi i Llixhave, degë e Drinit të Zi. Në mënyrë të ngjashme, edhe pse ekzistojnë plane paraprake për të ndërtuar impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në të tria rajonet, ujërat e ndotura komunale ende derdhen drejtpërdrejt në degët e Basenit Ujor Drin–Bunë pa trajtim.

Shqetësimet për ndotjen e lumit nga mbetjet e ngurta vetëm do të rriten në të ardhmen pasi prodhimi i tyre rritet nga viti në vit, megjithëse ka pasur një tendencë për të ndryshuar këtë trend në dy vitet e fundit me një rritje të riciklimit. Në Shkodër shkalla e prodhimit të mbetjeve të ngurta për person është rritur me 70% nga viti 2005 deri në 2014 (respektivisht 0.167 deri 0.237 kg/person/ditë). Sasia e rritur e mbetjeve të ngurta të gjeneruara rrit presionin mbi lumenjtë për sa kohë që rajonet nuk kanë impiante të trajtimit të ujërave të ndotura dhe vendgrumbullime higjieno-sanitare për të depozituar mbetjet komunale dhe ato industriale.




Figura 19: Vendgrumbullimet e mbetjeve në Bashkinë Vau i Dejës
Burimi: VSM e PPV, Bashkia Vau i Dejës

Së fundi, AMBU-ja në bashkëpunim me ASIG, ka përfshirë informacione për depozitimin e mbetjeve të ngurta urbane në Geoportalin e Autoritetit Shtetëror për Informata Gjeohapësinore, të cilat mund të shihen në: <http://geoportal.asig.gov.al>.

3.10. Sektorët mjedisorë/socialë dhe legjislacioni përkatës sektorial

Ligjet dhe rregulloret kryesore në fuqi dhe sektorët përkatës mjedisorë dhe socialë renditen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 12: Sektorët mjedisorë/socialë dhe legjislacioni përkatës sektorial

Nr.	NËNFUSHA E ZBATIMIT	AKTI LIGJOR	FAZA		LLOJI DHE NR. I AKTIT	
			Faza e ndërtimit	Faza operacionale	konsumatorit	Numri
1	Ekologjia	“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar	X	X	LIGJ	41/2013
		“Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”	X	X	LIGJ	43/2013
		“Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”	X	X	LIGJ	61/2016
		“Për mbrojtjen e biodiversitetit”	X	X	LIGJ	68/2014
2	Vlerësimi i ndikimit në mjedis	“Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”	X	X	LIGJ	12/2015
3	VSM	“Për vlerësimin strategjik mjedisor”	ne	ne	LIGJ	91/2013
4	Mjedisi	“Për mbrojtjen e mjedisit”	X	X	LIGJ	10431/11
		“Për lejet e mjedisit”	X	ne	LIGJ	60/2014
		“Për miratimin e rregullores së teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, kreu 6, seksioni, 2, referencat për karrierat	X	ne	VKM	533/2005
		“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”	X	ne	VKM	42/2008
		“Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”	X	ne	VKM	410/2012
5	Zonat e mbrojtura	Ligji “Për zonat e mbrojtura” VKM “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”	X	X	LIGJ VKM	81/2017 67/2002
6	Mbetjet	“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar	X		LIGJ	10463/2011
		“Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”; i ndryshuar me ligjin 10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”	X	X	LIGJ	10137/2009
		“Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”	X		VKM	229/2014
		“Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”	X		VKM	371/2014
		“Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme” i ndryshuar me Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009; dhe Ligji Nr. 9890, datë 20.03.2008;	X	X	LIGJ	9537/06
		“Për funksionimin dhe menaxhimin e regjistrit të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve, miratimin e listës së veprimtarive dhe ndotësve, që janë subjekt i këtij regjistri, si dhe formularit	X	X	VKM	742/2015

Plani i Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet - Qarku Shkodër

		të deklarimit të të dhënave për shkarkimet dhe transferimin e ndotësve nga operatori”				
		“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar	X	X	LIGJ	32/2013
		“Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”	X		VKM	575/2015
7	Trashëgimia kulturore	Ligji “Për trashëgiminë kulturore”	X	X	LIGJ	27/2018
8	Ajri	Ligji “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” VKM “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të ambientit dhe kërkesat për disa ndotës të caktuar që lidhen me të”	X	X	LIGJ VKM	162/2014 352/2015
		“Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”	X	X	VKM	435/2002
9	Uji	“Për menaxhimin e ujërave të përdorura”, i ndryshuar me ligjin Nr. 60/2014 “Për një ndryshim në Ligjin Nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar	X	X	LIGJ	60/2014
		“Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”			LIGJ	6/2018
10	Zhurmat	“Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” Udhëzimi Nr. 8, datë 27.11.2007, “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”	X	X	LIGJ	39/2013
11	Pyjet	“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”	X	X	LIGJ	36/2013
12	Përdorimi i tokës	“Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar	X	X	LIGJ	38/2013
		“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”	X	X	LIGJ	10257/10
13	Bujqësia	“Për një ndryshim dhe shtesë në Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar VKM “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”	X	X	LIGJ VKM	131/2014 373/2018
		“Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”	X	X	LIGJ	24/2017
14	Shpronësimet	“Për disa shtesa në Ligjin Nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”	X	X	LIGJ	20/2016
15	Planifikimi territorial	“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”	X	X	LIGJ	107/2014
16	Lejet	“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”	X	X	LIGJ	6/2015
17	Çështjet sociale	“Për ratifikimin e “Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”	X	X	LIGJ VKM	8672/2000 16/2012
18	Puna	“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”	X	X	LIGJ	135/2016
19	Shëndetësia	“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7643, datë 2.12.1992 “Për inspektoratin sanitar shtetëror”	X	X	LIGJ	45/2013
20	Çështjet gjinore	“Për barazinë gjinore në shoqëri”	X	X	LIGJ	9970/2008

4. ZHVILLIMI POTENCIAL I MJEDISIT NË RAST TË MOSZBATIMIT TË PMRRP-SË – ALTERNATIVA “MOS BËJ ASGJË”

Analiza e alternativës “Mos bëj asgjë” bazohet në supozimin se regjimet ekzistuese të mirëmbajtjes do të vazhdojnë dhe metodat e përdorimit të tokës dhe planifikimit hapësinor do të mbeten të njëjta.

Gjithashtu supozohet se nuk janë bërë përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin dhe edukimin e komunitetit në lidhje me rrezikun nga përmbytjet; për të përmirësuar metodat e regjistrimit të përmbytjeve; nuk kryhen studime të rrezikut nga përmbytjet; publiku nuk është i informuar për rrezikun nga përmbytjet; grupet dhe autoritetet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet nuk zhvillohen e forcohen; dhe nuk ofrohen këshilla apo financime për skemat lokale.

Këto supozime do të rezultojnë në një rrezik potencial për pronat dhe komunitetet nga përmbytjet e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore krahas përmbytjeve nga rrjedhat e zakonshme ujore.

Alternativa “Mos bëj asgjë” në terma afatgjatë do të konsiderohet të ketë një ndikim negativ, pasi gjasat për përmbytje rriten për shkak të ndryshimeve klimatike. Në të ardhmen, ndikimet e këtyre ndryshimeve ka të ngjarë të rezultojnë në ngjarje më të shpeshta dhe më të rënda përmbytjesh. Kjo do të rezultojë në efekte negative në drejtim të rritjes së rrezikut nga përmbytjet dhe dëmtimit të shkaktuar nga përmbytjet për njerëzit, infrastrukturën, pronën, bizneset, asetet historike dhe tokën.

Për shkak të kërcënimeve të tilla efekti i moszbatimit të planit mbi mjedisin natyror është negativ. Pritet që mund të ndodhë humbja e habitatit për shkak të përmbytjeve që do të ndikojnë në biodiversitetin; gjithashtu do të ketë rritje të ndotjes si pasojë e përmbytjeve;

5. OBJEKTIVAT MJEDISORE LIDHUR ME ZBATIMIN E PMRRP-SË

5.1. Përcaktimi i Objektivave Mjedisore

Përcaktimi i Objektivave Mjedisore (OM) të VSM është bërë bazuar në direktivat përkatëse të BE-së (Direktiva 2001/42/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 27 qershor 2001, “Për vlerësimin e efekteve të disa planeve dhe programeve në mjedis”), kuadrin legjislativ kombëtar, si dhe praktikat më të mira kombëtare e ndërkombëtare, që përcaktojnë kërkesat minimale për vlerësimin e efekteve të zbatimit të planeve në sektorët përkatës mjedisorë, mbi faktorët klimatikë, burimet natyrore, biodiversitetin, shëndetin e njeriut etj. dhe raportet e ndërsjella ndërmjet tyre.

Gjithashtu, në përcaktimin e objektivave mjedisore janë marrë parasysh edhe ndikimet e pritshme të PMRRP-së në sektorët përkatës mjedisorë.

Tabela më poshtë identifikon objektivat mjedisore të VSM sipas tematikave mjedisore.

Tabela 13: Objektivat e VSM

Tematika	Objektivat mjedisore të VSM	Kodi
Popullsia dhe shëndeti i njeriut	Mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së njerëzve përmes përmirësimit të cilësisë së mjedisit	OM1
Biodiversiteti, fauna dhe flora	Ruajtja dhe, sipas rastit, përmirësimi i llojeve, habitateve dhe biodiversitetit	OM2
Toka	Mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i funksionit dhe cilësisë së tokës	OM3
Uji	Parandalimi i përkeqësimit, mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i mjedisit ujor	OM4
Faktorët klimatikë	Kontribut në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike	OM5
Asetet materiale	Kontribut në mbrojtjen e pronës dhe infrastrukturës	OM6
	Reduktim i konsumit të burimeve	OM7
Trashëgimia kulturore	Mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i karakterit, diversitetit dhe cilësive të veçanta të trashëgimisë kulturore dhe mjedisit historik	OM8
Peizazhi	Mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i karakterit, diversitetit dhe cilësive të veçanta të peizazheve	OM9

5.2. Vlerësimi i përputhshmërisë së Objektivave të PMRRP me Objektivat Mjedisore të VSM

Objektivat e përcaktuara mjedisore duhet të jenë në përputhje me Ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, objektivat e përcaktuara në SKZHI II dhe Direktivën 2001/42/KE, të cilat janë të rëndësishme për të vlerësuar aspektet kryesore dhe projektet që parashikon PMRRP për të arritur objektivat e tij. Për të përcaktuar rëndësinë e objektivave mjedisore, duhet të vlerësohet përputhshmëria e objektivave të PMRRP me objektivat e përcaktuara mjedisore. Vlerësimi i përputhshmërisë mund të krijojë konflikte apo veprime të ndërsjellta mes objektivave të ndryshme, si dhe konflikte të theksuara interesi mes objektivave; të gjitha këto duhen vënë në dukje veçanërisht në pjesën e vlerësimit të masave specifike të PMRRP.

Vlerësimi i përputhshmërisë së objektivave merr në konsideratë objektivat e përgjithshme dhe specifike të përcaktuara në PMRRP dhe masat e specifikuar në të. Në këtë kuadër, për secilën nga objektivat

mjedisore janë përcaktuar disa pyetje vlerësuese, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e ndikimeve të mundshme të planit në mjedis. Këto janë paraqitur në Tabelën 14 më poshtë.

Tabela 14: Objektivat e VSM dhe pyetjet e vlerësimit

Tematika	Objektivat mjedisore të VSM	PMRRP.....
Popullsia dhe shëndeti i njeriut	Mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së njerëzve përmes përmirësimit të cilësisë së mjedisit	Synon komunitetet më të rrezikuara nga përmbytjet?
		U ndikimin e përmbytjeve tek komunitetet?
		Sjell përfitime për shëndetin dhe mirëqenine e njerëzve?
Biodiversiteti, fauna dhe flora	Ruajtja dhe, sipas rastit, përmirësimi i llojeve, habitateve dhe biodiversitetit	Shmang ndikimet e padëshiruara zonat e mbrojturat?
		Shmang ndikimet e padëshiruara dhe përmirëson llojet dhe habitatet e tjera të mbrojtura (përfshirë zonat me interes të veçantë shkencor)?
		Është në përputhje me proceset natyrore?
Toka	Mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i funksionit dhe cilësisë së tokës	Ruan cilësinë, sasinë dhe funksionin e tokës, duke përfshirë edhe tokat e vlefshme siç janë ato bujqësore dhe tokat e pasura me karbon?
Uji	Për të parandaluar përkeqësimin, mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i mjedisit ujor	Ruan dhe përmirëson mjedisin ujor?
Faktorët klimatikë	Kontribut në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike	Siguron përshtatshmëria ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike në të ardhmen?
		Kontribuon në reduktimin e emetimeve të GHG?
Asetet materiale	Kontribut në mbrojtjen e pronës dhe infrastrukturës	Mbron pasuritë materiale p.sh. infrastrukturën, pronat?
	Reduktim i konsumit të burimeve	Promovon efikasitetin e burimeve, duke përfshirë reduktimin e përdorimit të energjisë, mbetjeve, ujit dhe mineraleve?
Trashëgimia kulturore	Mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i karakterit, diversitetit dhe cilësive të veçanta të trashëgimisë kulturore dhe mjedisit historik	Mbron mjedisin historik dhe zonën rreth tij?
		Përmirëson cilësinë e mjedisit ku është ndërtuar?
Peizazhi	Mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i karakterit, diversitetit dhe cilësive të veçanta të peizazheve	Mbron, përmirëson apo restauron cilësinë e peizazhit?
		Shmang efektet negative në peizazhet e mbrojtura?

Për të kryer vlerësimin numerik të nivelit të përputhshmërisë është përdorur grafiku i vlerësimit që jepet në Tabelën 15 më poshtë.

Tabela 15: Grafiku i verësimit të nivelit të përputhshmërisë mes objektiveve

Niveli i përputhshmërisë	Vlerësimi numerik absolut	Vlerësimi numerik mesatar
Objektivat përputhen plotësisht	3	2.50 – 3.00
Objektivat përputhen pjesërisht	2	1.50 – 2.49
Lidhja mes objektiveve është e zbehtë	1	0.00 – 1.49
Nuk ka lidhje mes objektiveve	0	0.00
Objektivat nuk përputhen	-1	negativ

Rezultatet e vlerësimit të përputhshmërisë së objektiveve të PMRRP me objektivat mjedisore të VSM janë paraqitur në Tabelën 16 më poshtë.

Tabela 16: Vlerësimi i përputhshmërisë së Objektivave të PMRRP me Objektivat Mjedisore të VSM

Nr.	Objektivat e PMRRP	Objektivat Mjedisore të VSM									Mesatarja
		OM1 Popullsia & shëndeti	OM2 Biodiversiteti	OM3 Toka	OM4 Uji	OM5 Faktorët klimatikë	OM6 Asetet materiale - Prona	OM7 Asetet materiale - Burimet	OM8 Trashëgimia kulturore	OM9 Peizazhi	Vlerësimi numerik Mesatar
0.	Objektiva e përgjithshme: organizimi dhe kapacitetet për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet										1.73
0.1	Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstytucional, shkëmbimi i informacionit dhe shkëmbimi i të dhënave në fushën e reduktimit të rrezikut të lidhur me ujin	3	1	2	3	1	3	1	1	1	1.78
0.2	Rritja e kapaciteteve dhe aftësive për t'u përgatitur dhe për t'u përgjigjur përmbytjeve, si dhe kapacitete teknike dhe profesionale.	3	1	2	3	1	2	1	1	1	1.67
1.	Parandalimi i rreziqeve shtesë në zonat e rrezikuara nga përmbytjet										1.85
1.1	Të mos ketë rritje të shkarkimeve ekzistuese. Mbrojtja e funksioneve mbajtëse (fusha që përmbytjen) në lumenj/përrenj.	1	2	1	1	-1	0	0	0	2	0.67
1.2	Parandalimi i shtimit të aktiviteteve për vendbanimet në zonat e rrezikuara nga përmbytjet nëse nuk merren masa paraprake për mbrojtjen nga përmbytjet (shmangia në HQ ₁₀₀ nëse është e mundur / në zonat HQ _{ekstreme} vetëm nëse nuk ka alternativa dhe nëse i përshtaten rrezikut).	3	1	2	2	2	3	2	1	2	2.00
1.3	Parandalimi i rreziqeve shtesë në të gjitha zonat e rrezikuara nga përmbytjet (HQ _{ekstrem}): punimet mbrojtëse ose përshtatja ndaj rrezikut për ndërtesat dhe objektet e tjera infrastrukturore (furnizimi me ujë, ujërat e zeza, energjia, telekomunikimi, etj.). Shmangia e këtyre në HQ ₁₀₀ .	3	1	2	2	2	3	2	1	2	2.00
1.4	Parandalimi i praktikave industriale në zonat e rrezikuara nga përmbytjet që mund të shkaktojnë rrjedhje të kimikateve të rrezikshme në rrugët ujore gjatë përmbytjeve (parandalimi trajtimit të substancave që rrezikojnë ujin, pa kryer përshtatjen ndaj përmbytjeve).	3	3	3	3	1	1	1	1	2	2.00
1.5	Parandalimi i rreziqeve të reja të erozionit dhe rrëshqitjeve të dheut në zonat e rrezikuara nga	3	2	3	2	2	2	3	1	3	2.33

Plani i Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet - Qarku Shkodër

	përmbytjet me prioritet përafritet jostrukurore, duke pasur parasysh funksionin e rëndësishëm të pemëve/pyjeve										
1.6	Inspektimi, mirëmbajtja dhe, sipas rastit, përmirësimi i strukturave teknike të mbrojtjes nga përmbytjet.	3	2	3	3	2	3	1	1	1	2.11
2.	Reduktimi i rreziqeve ekzistuese në zonat e rrezikuara nga përmbytjet										1.91
2.1	Vlerësimi dhe reduktimi i potencialit të dëmtimit në zonat e rrezikuara nga përmbytjet (përshtatja dhe rritja e rezistencës së ndërtesave ekzistuese, sistemeve të transportit, infrastrukturës, përdorimit të tokës, punimeve mbrojtëse etj.).	3	1	3	3	2	3	1	1	1	2.00
2.2	Rritja e ndërgjegjësimit mbi rreziqet nga përmbytjet në procesin e planifikimit dhe në projektet e ndërtimit.	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3.00
2.3	Përmirësimi i depozitimit natyror të ujit me efekte pozitive në situatën e përmbytjeve (zvogëlimi i prurjeve të pikut, rritja e kapacitetit mbajtës të përmbytjeve).	2	2	2	3	2	1	1	1	1	1.67
2.4	Vlerësimi dhe mbrojtja e depozitimeve të substancave të rrezikshme për mjedisin në zonat e rrezikuara nga përmbytjet.	3	3	3	3	1	1	0	0	0	1.55
2.5	Përmirësimi dhe identifikimi i masave teknike të mbrojtjes nga përmbytjet që nuk kanë ndikim negativ tek të tjerët, duke pasur parasysh parimet e solidaritetit.	3	0	1	1	1	3	1	1	1	1.33
3.	Reduktimi i pasojave negative gjatë një përmbytjeje										1.22
3.1	Përmirësimi i aftësisë reaguese të popullatës së prekur dhe menaxherëve të objekteve	3	0	1	1	2	1	1	0	0	1.00
3.2	Përmirësimi i aftësisë reaguese të administratave dhe organizatave të sigurisë në nivel lokal dhe rajonal.	3	0	1	1	2	1	1	0	0	1.00
3.3	Përmirësimi i parimeve organizative dhe burimeve për mbrojtjen civile dhe menaxhimin e fatkeqësive.	3	1	2	2	1	2	2	1	1	1.67
4.	Reduktimi i pasojave negative pas një përmbytjeje										2.00
4.1	Përmirësimi i rregullimit të dëmeve nga ana e administratës dhe organizatave të sigurisë në nivel lokal dhe rajonal; rritja e ekspertizës për llogaritjen dhe dokumentimin e dëmit; gjithashtu, për popullsinë dhe menaxherët e objekteve.	3	2	2	2	2	2	2	2	2	2.11
4.2	Mbrojtja financiare nga fatkeqësitë ekzistuese, nëpërmjet sigurimeve dhe fondeve.	3	1	2	2	1	3	2	1	1	1.78
4.3	Përgatitja e restaurimit/rindërtimit të përshtatur për përmbytjet pas dëmtimeve; përgatitja e menaxhimit të mbetjeve lidhur me përmbytjet.	3	2	2	2	2	2	2	2	2	2.11

5.3. Analiza e përputhshmërisë së Objektivave të PMRRP me Objektivat Mjedisore të VSM

Rezultatet e Tabeles 16 tregojme qe perputhshmeria e objektivave specifike te Planit me ato mjedisore eshte si vijon:

- Objektiv 2.2 ka perputhshmeri te plote me OM
- 14 objektiva te Planit kane perputhshmeri te pjesshme me OM dhe
- 4 objektiva te Planit kane perputhshmeri te zbehte me OM

Tabela 17 më poshtë paraqet një përmbledhje të vlerësimit të përputhshmërisë së objektivave kryesore të PMRRP si shumatore e rezultateve të përputhshmërisë së objektivave specifike të PMRRP në raport me objektivat mjedisore.

Tabela 17: Vlerësimi i përputhshmërisë së Objektivave të PMRRP me Objektivat Mjedisore të VSM - Përmbledhje

Nr.	Objektivat e PMRRP	Vlerësimi numerik Mesatar
0.	Objektiva e përgjithshme: organizimi dhe kapacitetet për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet	1.73
1.	Parandalimi i rreziqeve shtesë në zonat e rrezikuara nga përmbytjet	1.85
2.	Reduktimi i rreziqeve ekzistuese në zonat e rrezikuara nga përmbytjet	1.91
3.	Reduktimi i pasojave negative gjatë një përmbytjeje	1.22
4.	Reduktimi i pasojave negative pas një përmbytjeje	2.00

Siç shihet në tabelë, në këndvështrimin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore, objektivat e PMRRP qëndrojnë si më poshtë:

- 4 (katër) objektiva të PMRRP kanë përputhshmëri të pjesshme me objektivat mjedisore;
- 1 (një) objektivë e PMRRP ka përputhshmëri të ulët me objektivat mjedisore (lidhja mes objektivave është e zbehtë).

Sfidat e Planit janë të mëdha dhe të tilla janë edhe objektivat e vendosura në raport me kërkesat e Direktivës së BE dhe synimet që kërkohet të arrihen nga institucionet së bashku me komunitetet dhe bizneset private lokale. E thënë me fjalë më sistematike, niveli aktual i veprimtarive dhe standartet kërkohet të ngrihen në një nivel më të integruar mes institucioneve palë pjesëmarrëse në këto sfida dhe nga ana tjetër del e qartë që integriteti i objektivave të Planit në raport me kërkesat që rrjedhin nga analiza e objektivave mjedisore gjendet afërsisht pak më lartë se në nivelin e mesëm të përputhshmërisë.

Sfidat më të mëdha janë ato të masave prioritare në kuadrin e forcimit institucional, koordinimit mes palëve, kapacitetet dhe buxhtimi në nivelin e sektorëve dhe sidomos në nivelin e strukturave që operojnë në marrëdhënie mes njësive administrative lokale.

Sfida bëhet më e madhe në raport me planifikimin dhe masat strukturore të cilat krahas objektivave të drejtpërdrejta parandaluese dhe mbrojtëse ndaj popullsisë, pasurisë dhe aseteve në përgjithësi, duhet të specifikohen edhe me masat specifike mjedisore në raport me objektivat mjedisore të fokusuar në biodiversitet, cilësinë dhe sigurinë e ujrave, peisazhin etj., për të mos patur ndikime negative dhe kjo mund të arrihet nëse objektivat kryesore të planit kanë një këndvështrim afatgjatë me masa veprimi të

standartizuara, sic ka nisur puna për të specifikuar masat nga aspekti aktual i emergjencave në ato të mbrojtjes civile. Dinamika e ndryshimeve të kohëve të fundit me ndryshimet ligjore kërkon rishikimin e praktikave krahas procesit të nisur me hartimin e PMRRP, si në sektorët dhe institucionet qendrore ashtu edhe më tepër në strukturat që operojnë në nivelin lokal.

Sidoqoftë, duhet theksuar që objektivat e planit sado që kanë mjaft sfida, janë të pozicionuara mirë dhe përbëjnë një bazë të mirë për të krijuar përputhshmëri më të madhe me objektivat mjedisore në vijim të praktikave që do të realizohen. Përmes procesit të monitorimit të rezultateve në fund të periudhës 6 vjecare do të bëhet e mundur të rishikohen me realizëm plotësimi i masave integrale sipas standarteve që kërkon të realizojë Plani dhe njëkohësisht objektivat specifike.

Së fundmi, në një pjesë të objektivave specifike duhet të shfaqet edhe pasqyrimi i komponentit gjinor dhe të grupeve të marginalizuara, pasi këto do ta bënin planin edhe më të integruar.

6. VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË ZBATIMIT TË PMRRP-SË

Ky seksion përfshin vlerësimin e ndikimeve mjedisore të masave të parashikuara në PMRRP për menaxhimin e rrezikut të përmbytjeve, sipas tematikave / sektorëve të veçantë mjedisorë dhe objektivave mjedisore.

Analiza e masave dhe vlerësimi i ndikimeve të pritshme nga aplikimi i tyre është kryer bazuar në listën e masave të propozuara (shih listën në Tabelën 18), ndërkohë që analiza e detajuar e ndikimeve të masave specifike, dhe përcaktimi i masave të duhura zbutëse për çdo ndikim, bëhet në fazën e hartimit të VNMS-ve përkatëse për çdo masë/projekt.

6.1. Masat e propozuara në PMRRP

Në PMRRP jepet edhe një pasqyrë e katalogut të masave tip të propozuara duke garantuar që të gjitha fushat kryesore të veprimit janë të mbuluara. Tabela tregon edhe karakterin e masave tip: përgjithësisht strukturore ose përgjithësisht jo-strukturore.

Tabela 18: Fushat e veprimit: struktura e katalogut të masave tip për PMRRP në Qarkun e Shkodrës

Nr.	Struktura e katalogut të masave: fushat e veprimit	Karakteri
1.	Aspekti: Parandalimi i rreziqeve	
1.1.	Instrumentet Administrative (për shmangien e rrezikut)	
1.1.1.	Harta e zonave të rrezikuara nga përmbytjet	jo-strukturore
1.1.2.	Kufizimi i ndërtimeve në zonat me rrezik (në planifikimin hapësinor dhe urban)	jo-strukturore
1.1.3.	Mbrojtja e fushave lymore dhe zonave të ujëmbajtjes	jo-strukturore
1.2.	Përshtatja e përdorimit të tokës (për shmangien e rrezikut, largimin, zhvendosjen dhe reduktimin e rrezikut)	
1.2.1.	Përshtatja e përdorimit aktual të tokës në zonat e rrezikuara nga përmbytjet (përfshirë bujqësinë dhe pylltarinë)	jo-strukturore
1.2.2.	Përshtatja e ndërtimeve dhe infrastrukturës në zonat me rrezik (planifikimi dhe ndërtimi i përshtatur për përmbytjet)	kryesisht strukturore
1.2.3.	Konsultimi për rritjen e ndërgjegjësimit me sektorët e bujqësisë dhe pylltarisë	jo-strukturore
1.3.	Parandalimi i rrezikut duke përshtatur ndërtimet sipas përmbytjeve	
1.3.1.	Trajtimi i përshtatur sipas përmbytjeve lidhur me substancat e rrezikshme për ujin	strukturore / jo-strukturore.
2.	Aspekti: Mbrojtja Natyrore nga Përmbytjet	
2.1.	Menaxhimi natyror i përmbytjeve, rregullimi i rrjedhës së ujit	
2.1.1.	Rivitalizimi i shtretërve dhe brigjeve të lumenjve / ish fushat lymore	strukturore
2.1.2.	Ndryshimi i rrjedhës lumore dhe gjendjes së shpateve	strukturore
2.1.3.	Mbrojtja e zonave përgjatë brigjeve të lumenjve	jo-strukturore
2.1.4.	Mbështetje për zhvillimin e fyshave lymore natyrore	jo-strukturore
2.1.5.	Mirëmbajtja e përshtatur gjithëpërfshirëse e lumit	strukturore
2.1.6.	Heqja/shkëputja e trotuareve në zonat urbane / Menaxhimi i ujërave të shirave	strukturore
2.2.	Riaktivizimi i zonave pritëse (rregullimi i rrjedhës së ujit)	
2.2.1.	Shembje e digave/pritave	strukturore
2.2.2.	Vendosja e digave/pritave të pasme	strukturore
2.2.3.	Heqja e brigjeve artificiale	strukturore
2.2.4.	Lidhja me terrenin ujëmbajtës (p.sh. zona ujëmbajtëse, degët e vjetra të lumit)	strukturore
3.	Aspekti: Mbrojtja Teknike nga Përmbytjet	
3.1.	Rregullimi i rrjedhës së ujit / Punimet në zonat lymore (masat pritëse)	
3.1.1.	Ndërtimi i një pellgu pritës	strukturore
3.1.2.	Krijimi i një zone ligatinore të mbyllur	strukturore
3.1.3.	Restaurimi, zgjerimi dhe përmirësimi i sistemeve pritëse ekzistuese (diga / pellgje / zona ligatinore)	strukturore
3.2.	Rregullimi i rrjedhës së ujit / Kanalet (psh. prita, diga, mure mbrojtëse dhe struktura mbrojtëse lëvizëse)	
3.2.1.	Punimet për mbrojtjen nga përmbytjet (prita, diga ose mure mbrojtëse)	strukturore

3.2.2.	Përforcimi i veprave ekzistuese të mbrojtjes nga përmbytjet	strukturore
3.2.3.	Përshtatja e një sistemi të lëvizshëm (stacionar) të mbrojtjes nga përmbytjet	strukturore
3.2.4.	Drenazhimi në zonën e digave dhe mbrojtje për moskthimin e ujërave	strukturore
3.3.	Rregullimi i rrjedhës së ujit / Kanalet (masat në lumenj/mbrojtje lumore)	
3.3.1.	Mbajtja pastër e zonave ku kakryqëzime ujore, sidomos në zonat e banuara	strukturore
3.3.2.	Largimi i pengesave / kalimeve të ngushta në lumenj	strukturore
3.3.3.	Ndërtimi dhe forcimi i kanaleve që shërbejnë si bajpase lumore	strukturore
3.4.	Menaxhimi i ujërave sipërfaqësore (masat e menaxhimit të ujërave urbane)	
3.4.1.	Menaxhimi i ujërave të shirave	strukturore / jo-strukturore.
3.4.2.	Zhvillimi i një sistemi bashkiak të mbajtjes së ujërave (p.sh. kanali i mbajtjes së ujërave të shirave)	strukturore
3.4.3.	Përmirësimi i sistemit të kullimi i përshtatur ndaj përmbytjeve (p.sh. filtër, valvul moskthimi)	strukturore
3.5.	Mbrojtja e objekteve/strukturave	
3.5.1.	Mbrojtja e objekteve/strukturave të ndërtesave individuale	strukturore
3.5.2.	Mbrojtja e objekteve/strukturave të sistemeve infrastrukturore (transport, energji, furnizim me ujë)	strukturore
3.6.	Masa të tjera mbrojtëse	
3.6.1.	Përmirësimi i menaxhimit të sistemeve lumore që grumbullojnë ujin nëpërmjet digave apo rezervuarëve	strukturore / jo strukturore.
3.6.2.	Mbrojtje kundër kullimit dhe ujërave nëntokësore	strukturore
4.	Aspekti: Gatishmëria dhe Informimi	
4.1.	Gatishmëria ekonomike/financiare	
4.1.1.	Masat paraprake financiare nga rezervat dhe sigurimet (sigurimi nga rreziqet natyrore)	jo-strukturore
4.2.	Gatishmëria informative	
4.2.1.	Përmirësimi i parashikimit të përmbytjeve dhe paralajmërimit / mesazheve për përmbytje	jo-strukturore
4.3.	Gatishmëria e lidhur me sjelljen	
4.3.1.	Publikimi i hartave të rrezikut nga përmbytjet pranë zonave të rrezikuara	jo-strukturore
4.3.2.	Vijueshmëria e punës për rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit	jo-strukturore
4.4.	Analizimi, përgatitja dhe përpunimi i lidhur me kontrollin e rrezikut	
4.4.1.	Shtirja dhe optimizimi i skemave të alarmit dhe veprimit (skemat e menaxhimit të fatkeqësive)	jo-strukturore
4.4.2.	Mbrojtja Civile	jo-strukturore
4.4.3.	Grumbullimi dhe analizimi i të gjitha përvojave që lidhen me përmbytjet	jo-strukturore

Burimi: PMRRP

6.2. Analiza e ndikimeve të pritshme

Më poshtë është paraqitur një analizë e ndikimeve që pritet të sjellë në elementët e mjedisit zbatimi i masave tip të parashikuara në PMRRP.

6.2.1. Popullsia dhe shëndeti i njeriut

Masat tip të propozuara mund të kenë efekte të rëndësishme pozitive tek popullsia dhe shëndeti e mirëqenia e njerëzve, duke përfshirë komunitetet më të pafavorizuara dhe të cënueshme, për shkak të reduktimit të rrezikut nga përmbytjet për shtëpitë dhe komunitetet përgjatë vijave ujore, si dhe ato në zonën bregdetare.

Aty ku propozohen masa për mbrojtjen dhe sistemimin e zonave të mbajtjes së ujit, si dhe masat tip për restaurimin e brigjeve lumore dhe zonave të përmbytura, këto mund sjellin përfitime për njerëzit dhe pronat përmes rregullimit më të mirë të rrjedhës së ujit. Këto masa mund të ofrojnë gjithashtu mundësi për akses të zgjeruar ose të përmirësuar në hapësirat brenda vendbanimeve, zonave turistike dhe natyrore. Strukturat mbrojtëse të lumenjve mund të sjellin në efekte të përziera në asetet ekzistuese rekreative, duke përfshirë hapësirën/monopatet përgjatë brigjeve të lumenjve dhe vijen bregdetare, me potencialin, nga njëra anë, për të kufizuar aksesin ekzistues nëpërmjet ndërtimit të strukturave mbrojtëse, ose, nga ana tjetër, për të përmirësuar aksesin duke formalizuar dhe mbrojtur monopatet.

Efektet ka të ngjarë të shtrihen në nivel lokal dhe aty ku janë negative, mund të zbuten përmes përcaktimit të zonave sensitive që në fazën e projektimit (VNMS).

Në përgjithësi, konsiderohet se masat tip të propozuara mund të kenë një **efekt të konsiderueshëm pozitiv** mbi popullsinë dhe shëndetin e njerëzve.

6.2.2. Biodiversiteti

Masat tip të propozuara mund të kenë efekte të përziera në biodiversitet, në varësi të ndjeshmërisë së vendndodhjes dhe llojit të masave të rekomanduara. Në vendet ku propozohen struktura të reja mbrojtëse lumore, ekziston mundësia për efekte negative nëse habitatit humbet ose degradohet. Kjo mund të balancohet me krijimin dhe restaurimin e mundshëm të habitatit si rezultat i restaurimit të lumenjve dhe zonave të përmbytura, si dhe masa të tjera zbutëse që mund të propozohen rast pas rasti.

Efektet e mundshme negative identifikohen kur propozohen masa në zona specifike (apo edhe më gjerë në pellgun ujëmbledhës) që kanë vlerë të lartë të biodiversitetit, e reflektuar në praninë e zonave të mbrojtura kombëtare dhe me rëndësi ndërkombëtare (referuar Liqeni i Shkodrës – IUCN IV: Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror dhe Lumi i Bunës-Velipojë – IUCN V: Peizazh i mbrojtur). Sa i takon masave të propozuara, të cilat parashikohen në vende ku nuk ka zona të përcaktuara kombëtare ose ndërkombëtare, vlerësohet se çdo efekt negativ në biodiversitet do të ishte i lokalizuar. Efektet në zonat e mbrojtura varen nga vendndodhja specifike dhe projekti i detajuar i masës së propozuar, dhe vlerësimi i detajuar do të bëhet përmes VNMS-ve përkatëse, ku do të përcaktohen edhe masat zbutëse ndaj çdo ndikimi.

Në përgjithësi, konsiderohet se masat tip të propozuara të përmbytjeve mund të kenë një **efekt të moderuar / të lartë negativ** në biodiversitet. Masat specifike zbutëse janë të nevojshme të identifikohen që në fazën e projektimit për çdo projekt specifik dhe të aplikohen gjatë fazës së zbatimit.

6.2.3. Toka

Efektet e masave të propozuara në tokë konsiderohen të jenë kryesisht pozitive ose neutrale. Megjithatë, disa masa (p.sh. përshtatja e ndërtimeve dhe infrastrukturës, adoptimi i një sistemi të lëvizshëm të mbrojtjes, pastrimi i kanaleve të rrjedhjes së ujit, eliminimi i ngushtimeve / hapësirave të ngushta në lumenj, mbrojtja e objekteve/strukturave, etj.) janë vlerësuar se do të shkaktojnë ndikim të konsiderueshëm negativ në cilësinë e tokës, dhe në këtë mënyrë është e detyrueshme zbatimi i masave zbutëse, për të eliminuar këto ndikime.

Zbatimi i masave të përshkruara më sipër mund të shkaktojë humbje të sipërfaqeve të vogla të tokës dhe potencial për erozion. Kjo balancohet me veprimet e restaurimit të habitatit, të cilat kanë potencialin për të mbrojtur tokat nga erozioni, për të ruajtur lëndët ushqyese dhe për të mbrojtur dhe përmirësuar tokat e pasura me karbon. Konsiderohet se masat mbrojtëse lumore/bregdetare mund të kenë një efekt në tokë, por mund të ketë edhe përfitime në rastet kur toka bujqësore mbrohet nga përmbytjet. Rëndësia e efekteve do të varet nga gjendja ekzistuese e tokës, nëse ajo është me vlerë të lartë (p.sh. toka bujqësore ose toka torfe), dhe nga natyra, shtrirja dhe vendndodhja e masës.

Në përgjithësi, konsiderohet se shumica e masave të propozuara mund të kenë **efekt neutral** në tokë, ndërkohë që disa masa pritet që të shkaktojnë **ndikime të larta negative** dhe që duhen adresuar përmes aplikimit të masave zbutëse.

6.2.4. Uji

Efektet e masave të propozuara në sektorin e ujit janë kryesisht neutral, ndërkohë që disa masa të caktuara pritet të shkaktojnë efekte negative të larta, në varësi të ndjeshmërisë së zonës ku propozohen masat dhe natyrës së tyre (masave).

Efektet e mundshme pozitive identifikohen aty ku ka mundësi për përmirësim nëpërmjet menaxhimit të përmbytjeve natyrore dhe mbështetjes së objektivave të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (SKMIBU 2018-2027), veçanërisht në zonat ku trupat ujqorë janë identifikuar si të dëmtuar për shkak të gjendjes së tyre fizike. Mund të ketë gjithashtu efekte pozitive që vijnë nga restaurimi i lumenjve dhe fushave të përmbytjes, masat që lidhen me rregullimin e rrjedhës së ujit, etj., duke reduktuar problemet ekzistuese si erozioni dhe zvogëluar rrezikun nga përmbytjet. Efektet negative mund të rezultojnë kur masat tip të propozuar mund të ndërhyjnë në proceset natyrore dhe të shkaktojnë shkëputjen e një pjese ose të gjithë fushës së përmbytjes nga trupat ujqorë, duke çuar në humbjen e habitatit natyror për kapjen, filtrimin dhe riciklimin e lëndëve ushqyese ose ndotësve dhe ulje e cilësisë së ujit. Keto adresohen përmes aplikimit të masave zbutëse specifike.

Në zonën bregdetare mund të ketë efekte të mundshme negative të shkaktuar nga masat që lidhen me mbrojtjen e strukturave përkatëse, por mund të ketë edhe përfitime prej restaurimit të bregdetit sipas morfologjisë së tij. Strukturat mbrojtëse bregdetare mund të reduktojnë erozionin, megjithatë, ato mund të ndërhyjnë në proceset bregdetare, duke ndryshuar shkallën e erozionit dhe depozitimit diku tjetër. Madhësia dhe drejtimi i efekteve të mundshme do të varet nga kushtet ekzistuese dhe ndjeshmëria e zonave specifike përgjatë vijës bregdetare.

Në përgjithësi, konsiderohet se masat tip të propozuara mund të kenë një **efekt të përzier (neutral/pozitiv dhe të lartë negativ)** në ujë. Sa i takon efekteve negative, këto duhet të eliminohen/zbuten përmes zbatimit të masave zbutëse.

6.2.5. Faktorët klimatikë

Aty ku masat tip të propozuara janë të modeluara për të marrë parasysh efektet e ndryshimeve klimatike, parashikohen efekte pozitive në aspektin e faktorëve klimatikë për shkak të përmirësimit të qëndrueshmërisë së pronave dhe infrastrukturës ndaj ndryshimeve të ardhshme klimatike. Sidoqoftë ekziston mundësia që disa masa (p.sh. ndryshimi i rrjedhave të lumenjve, eliminimi i ngushtimeve / hapësirave të ngushta në lumenj, mbrojtja e objekteve/strukturave dhe mbrojtja civile) të rezultojnë në humbjen ose degradimin e habitateve (shtrati lumor, ligatinat e zonave të përmbytura, tokat pyjore ose torfe) që ruajnë karbonin. Këto efekte negative, megjithatë, do të vareshin nga shtrirja dhe vendndodhja e masës, dhe duhet të adresohen në projektet specifike të zbatimit nëpërmjet aplikimit të masave zbutëse përkatëse.

Në përgjithësi, konsiderohet se masat tip të propozuara mund të kenë një **efekt pozitiv** në faktorët klimatikë, duke përjashtuar masat e sipërpërmendura, të cilat parashikohen të kenë **ndikim negativ** dhe për pasojë duhet të aplikohen masa zbutëse në këte drejtim.

6.2.6. Asetet materiale

Masat tip të propozuara parashikohen të kenë **efekte të përziara** në asetet materiale. Pra, disa masa pritet të kenë **efekte të rëndësishme pozitive** për shkak të uljes së rrezikut nga përmbytjet ndaj pronave dhe infrastrukturës, aty ku ajo është e pranishme. Mund të ketë gjithashtu reduktime në konsumin e burimeve të lidhura me veprimet e rikuperimit, riparimit dhe zëvendësimit në rast përmbytjeje.

Nga ana tjetër, një numër i konsiderueshëm masash, siç janë gjithë masat që i përkasin kategorive “Riaktivizimi i zonave të mbajtjes (rregullimi i rrjedhës së ujit)”, “Mbrojtja e objekteve/strukturave”, “Parandalimi i rrezikut duke përshtatur ndërtesat ndaj përmytjeve”, “Rregullimi i rrjedhës së ujit / Punimet e fushës së përmytur (masat e mbajtjes)” si dhe masa të tjera (p.sh. ndryshimi i rrjedhës së lumit, mirëmbajtja e lumit, rregullimi i rrjedhës së ujit/kanalet, menaxhimi i ujërave sipërfaqësore, etj.) që lidhen më shumë me aspektin e përdorimit/konsumit të burimeve natyrore, pritet të kenë **efekte të konsiderueshme negative** për vetë natyrën e këtyre masave

6.2.7. Trashëgimia kulturore

Masat tip të propozuara pritet që të kenë efekte të përziera në trashëgiminë kulturore, në varësi të ndjeshmërisë dhe vlerës së vendndodhjes dhe natyrës së masave të propozuara.

Masat mund të kenë efekte pozitive duke reduktuar rrezikun e përmytjeve për asetet e trashëgimisë kulturore që rrezikohen nga përmytjet. Efektet negative mund të rezultojnë kur propozohen ndërhyrje apo struktura mbrojtëse dhe masa të tjera me karakter strukturor në zona ku gjenden asete të trashëgimisë kulturore (p.sh. rrënojat e Kishës së Shirqit), por edhe brenda komuniteteve urbane, ku masat mund të kenë efekte negative në shtrirjen fizike ose pozicionimin e ndërtesave/vendeve historike. Këto efekte do të lokalizohen dhe mund të zbuten përmes vlerësimit të mëtejshëm gjatë fazës së projektimit dhe hartimit të VNMS-ve përkatëse.

Në përgjithësi, konsiderohet se masat tip të propozuara kanë **efekt të përzier** në trashëgiminë kulturore.

6.2.8. Peizazhi

Masat tip të propozuara mund të kenë efekte pozitive dhe negative në peizazhi, në varësi të ndjeshmërisë dhe vlerës së vendndodhjes dhe natyrës së veprimeve të rekomanduara.

Ekziston mundësia për efekte negative në peizazh në zonat ku propozohen masa lidhur me: përshtatjen e ndërtimeve/infrastrukturës në zonat me rrezik përmytjeje, rivitalizimin e shtretërve dhe ndryshimin e rrjedhave të lumenjve, vendosjen e digave/pritave, mbrojtjen e objekteve/strukturave, etj., pasi këto masa mund të ndikojnë në karakterin e zonave të përcaktuara dhe efektin pamor në to. Projektete e detajuara për zbatimin e këtyre masave duhet të marrin parasysh ndjeshmërinë e elementëve peizazhistikë dhe kështu mund të ndihmojnë në përmirësimin e elementit pamor, veçanërisht në zonat ku vija bregdetare ose korridoret e lumenjve janë modifikuar tashmë. Nga ana tjetër masat që lidhen me restaurimin e lumenjve, zonave bregdetare dhe fushave të përmytjeve kanë potencialin dhe mundësinë për të ofruar një habitat natyror të përmirësuar i cili mund të përmirësojë karakterin e peizazhit dhe komoditetin pamor. Këto dhe masat të tjera zbutëse duhet të identifikohen në detaje për çdo zonë gjatë hartimit të VNMS-ve përkatëse.

Në përgjithësi, konsiderohet se masat tip të propozuara kanë **efekt të përzier** në peizazh, ku **efektet negative** janë dominuese.

6.3. Përmbledhje vlerësimit të ndikimeve të zbatimit të PMRRP-së në OM-të

Tabela 19 paraqet një përmbledhje të vlerësimit të zbatimit të PMRRP-së në lidhje me objektivat mjedisorë. Tabela është strukturuar në bazë të kategorisë së vlerësimit të ndikimit për secilën masë të propozuar në PMRRP, lidhur me objektivin mjedisor përkatës (siç përshkruhet në Seksionin 1.4.2 Metodologjia për përgatitjen e raportit të VSM-së).

Më tej, vlerësimi i ndikimeve të masave ka vijuar me përcaktimin e nivelit të përputhshmërisë së masave të PMRRP-së me objektivat mjedisore. Në Tabelën 20 paraqitet krahasimi i masave në fjalë me OM-të. Vlerësimi paraqitet sipas kategorive të mëposhtme:

Kodi i ngjyrave	Shpjegimi
E gjelbër	Masa është në përputhshmëri të lartë me OM-të
E verdhë	Masa është në përputhshmëri të pjesshme me OM-të
E kuqe	Masa përputhet në mënyrë të kushtëzuar me OM-të
E bardhë	Nuk mund të përcaktohet përputhshmëria

Ekziston një korrelacion ndërmjet gradave (A, B, C dhe X) në Tabelën 19 dhe shkallës së vlerësimit (përputhshmëri e lartë, përputhshmëri e pjesshme, përputhshmëri e kushtëzuar, përputhshmëri e papërcaktuar) në Tabelën 20. Korrelacioni ndërmjet dy tabelave është si më poshtë:

Tabela 19	Tabela 20
Grada A	Përputhshmëri e lartë
Grada B	Përputhshmëri e pjesshme
Grada C	Përputhshmëri e kushtëzuar
Grada X	Nuk mund të përcaktohet përputhshmëria

Numri absolut i gradave përkatëse për secilën masë, d.m.th. numri i A-ve, B-ve, C-ve dhe X-ve në Tabelën 19, është konvertuar në pikë përqindjeje në shkallën e vlerësimit, d.m.th. PL%, PP%, PK% dhe X% në Tabelën 20. Për shembull, **Masa 2.2.1 "Prishja e digave / pritave"** në Tabelën 19 është vlerësuar me **tre A, dy B, dy C dhe dy X**, sipas nëntë OM-ve përkatëse. Prandaj, **Masa 2.2.1** në Tabelën 20 **Përputhet Plotësisht në masën 33.34%, Përputhet Pjesërisht 22.22%, Përputhet në mënyrë të kushtëzuar 22.22% dhe Nuk mund të përcaktohet përputhshmëria në masën 22.22%.**

Tabela 19: Përmbledhje vlerësimit të ndikimeve të zbatimit të PMRRP-së në objektivat mjedisore

Nr.	Masat tip	Objektivat Mjedisore të VSM								
		OM1 Popullsia & shëndeti	OM2 Biodiversiteti	OM3 Toka	OM4 Uji	OM5 Faktorët klimatikë	OM6 Asetet materiale - Prona	OM7 Asetet materiale - Burimet	OM8 Trashëgimia kulturore	OM9 Peizazhi
1.	Aspekti: Parandalimi i rreziqeve									
1.1.	Instrumentet Administrative (për shmangien e rrezikut)									
1.1.1.	Harta e zonave të rrezikuara nga përmbytjet	B	A	A	A	A	C	X	A	A
1.1.2.	Kufizimi i ndërtimeve në zonat me rrezik (në planifikimin hapësinor dhe urban)	C	B	A	A	X	A	A	B	B
1.1.3.	Mbrojtja e fushave lymore dhe zonave të ujëmbajtjes	A	A	A	A	A	A	A	X	A
1.2.	Përshtatja e përdorimit të tokës (për shmangien e rrezikut, largimin, zhvendosjen dhe reduktimin e rrezikut)									
1.2.1.	Përshtatja e përdorimit aktual të tokës në zonat e rrezikuara nga përmbytjet (përfshirë bujqësinë dhe pylltarinë)	A	B	A	B	A	X	X	X	A
1.2.2.	Përshtatja e ndërtimeve dhe infrastrukturës në zonat me rrezik (planifikimi dhe ndërtimi i përshtatur për përmbytjet)	A	C	C	C	A	A	C	C	C
1.2.3.	Konsultimi për rritjen e ndërgjegjësimit me sektorët e bujqësisë dhe pylltarisë	A	A	A	A	A	A	A	A	A
1.3.	Parandalimi i rrezikut duke përshtatur ndërtimet sipas përmbytjeve									
1.3.1.	Trajtimi i përshtatur sipas përmbytjeve lidhur me substancat që rrezikojnë ujin	A	A	A	A	A	C	C	X	C
2.	Aspekti: Mbrojtja Natyrore nga Përmbytjet									
2.1.	Menaxhimi natyror i përmbytjeve, rregullimi i rrjedhës së ujit									
2.1.1.	Rivitalizimi i shtretërve dhe brigjeve të lumenjve / ish fushat lymore	A	C	A	A	A	X	C	X	C
2.1.2.	Ndryshimi i rrjedhës lumore dhe gjendjes së shpateve	C	C	C	C	C	C	C	C	C
2.1.3.	Mbrojtja e zonave përgjatë brigjeve të lumenjve	A	A	A	A	A	A	A	A	A
2.1.4.	Mbështetje për zhvillimin e fyshave lymore natyrore	A	A	A	A	A	A	A	A	A
2.1.5.	Mirëmbajtja e përshtatur gjithëpërfshirëse e lumit	A	C	A	A	A	A	C	B	B
2.1.6.	Heqja/shkëputja e trotuareve në zonat urbane / Menaxhimi i ujërave të shirave	A	C	C	A	A	A	C	C	C
2.2.	Riaktivizimi i zonave pritëse (rregullimi i rrjedhës së ujit)									
2.2.1.	Shembje e digave/pritave	X	B	B	A	A	C	C	X	A
2.2.2.	Vendosja e digave/pritave të pasme	A	B	A	A	A	C	C	B	C
2.2.3.	Heqja e brigjeve artificiale	X	B	B	A	A	C	C	X	A
2.2.4.	Lidhja me terrenin ujëmbajtës (p.sh. zona ujëmbajtëse, degët e vjetra të lumit)	B	A	C	A	A	C	C	C	C
3.	Aspekti: Mbrojtja Teknike nga Përmbytjet									
3.1.	Rregullimi i rrjedhës së ujit / Punimet e fushës së përmbytur (masat e mbajtjes)									
3.1.1.	Ndërtimi i një pellgu pritës	A	C	B	A	A	C	C	X	C
3.1.2.	Krijimi i një zone ligatinore të mbyllur	A	C	B	A	A	C	C	X	C

Plani i Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet - Qarku Shkodër

3.1.3.	Restaurimi, zgjerimi dhe përmirësimi i sistemeve pritëse ekzistuese (diga/pellgje/ligatina)	A	C	B	A	A	C	C	X	C
3.2.	Rregullimi i rrjedhës së ujit / Kanalet (prita, diga, mure mbrojtëse dhe struktura mbrojtëse lëvizëse)									
3.2.1.	Punimet për mbrojtjen nga përmbytjet (prita, diga ose mure mbrojtëse)	A	C	A	A	A	A	C	X	C
3.2.2.	Përforcimi i veprave ekzistuese të mbrojtjes nga përmbytjet	A	C	A	A	A	A	C	X	C
3.2.3.	Përshtatja e një sistemi të lëvizshëm (stacionar) të mbrojtjes nga përmbytjet	A	C	C	C	A	X	C	X	C
3.2.4.	Drenazhimi në zonën e digave dhe mbrojtje për moskthimin e ujërave	A	C	A	A	A	A	C	X	C
3.3.	Rregullimi i rrjedhës së ujit / Kanalet (masat në lumenj/mbrojtje lumore)									
3.3.1.	Mbajtja pastër e zonave ku kakryqëzime ujore, sidomos në zonat e banuara	A	C	A	A	A	A	C	X	C
3.3.2.	Largimi i pengesave / kalimeve të ngushta në lumenj	C	C	C	C	C	C	C	C	C
3.3.3.	Ndërtimi dhe forcimi i kanaleve që shërbejnë si bajpase lumore	C	C	C	C	C	C	C	C	C
3.4.	Menaxhimi i ujërave sipërfaqësore (masat e menaxhimit të ujërave urbane)									
3.4.1.	Menaxhimi i ujërave të shirave	A	B	A	A	A	A	C	B	B
3.4.2.	Zhvillimi i një sistemi bashkiak të mbajtjes së ujërave (p.sh. kanali i mbajtjes së ujërave të shirave)	A	B	A	A	A	A	C	B	B
3.4.3.	Përmirësimi i sistemit të kullimi i përshtatur ndaj përmbytjeve (p.sh. filtër, valvul moskthimi)	A	B	A	A	A	A	C	B	B
3.5.	Mbrojtja e objekteve/strukturave									
3.5.1.	Mbrojtja e objekteve/strukturave të ndërtesave individuale	C	C	C	C	C	C	C	C	C
3.5.2.	Mbrojtja e objekteve/strukturave të sistemeve infrastrukturore (p.sh. transporti, energjia, furnizimi me ujë)	C	C	C	C	C	C	C	C	C
3.6.	Masa të tjera mbrojtëse									
3.6.1.	Përmirësimi i menaxhimit të sistemeve lumore që grumbullojnë ujin nëpërmjet digave apo rezervuarëve	C	C	C	C	C	C	C	C	C
3.6.2.	Mbrojtje kundër kullimit dhe ujërave nëntokësore	A	A	A	A	A	A	A	X	X
4.	Aspekti: Gatishmëria dhe Informimi									
4.1.	Gatishmëria ekonomike/financiare									
4.1.1.	Masat paraprake financiare nga rezervat dhe sigurimet (sigurimi nga rreziqet natyrore)	A	X	A	A	A	A	X	X	X
4.2.	Gatishmëria informative									
4.2.1.	Përmirësimi i parashikimit të përmbytjeve dhe paralajmërimit / mesazheve për përmbytje	A	A	A	A	A	A	X	A	A
4.3.	Gatishmëria e lidhur me sjelljen									
4.3.1.	Publikimi i hartave të rrezikut nga përmbytjet pranë zonave të rrezikuara	A	A	A	A	A	A	A	A	A
4.3.2.	Vijueshmëria e punës për rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit	A	A	A	A	A	A	A	A	A
4.4.	Analizimi, përgatitja dhe përpunimi lidhur me kontrollin e rrezikut									
4.4.1.	Shtirirja dhe optimizimi i skemave të alarmit dhe veprimet (skemat e menaxhimit të fatkeqësive)	A	A	A	A	A	A	A	A	A
4.4.2.	Mbrojtja Civile	A	C	A	A	C	A	C	C	C
4.4.3.	Grumbullimi dhe analizimi i të gjitha përvojave që lidhen me përmbytjet	A	A	A	A	A	A	A	A	A

Tabela 20: Krahasimi i masave tip specifike në varësi të përputhshmëri së tyre me OM-të, përqindjet e ndikimeve të vlerësuara

Nr.	Masat tip	Shkalla e vlerësimit			
		PL%	PP%	PK%	X%
1.	Aspekti: Parandalimi i rreziqeve				
1.1.	Instrumentet Administrative (për shmangien e rrezikut)				
1.1.1.	Harta e zonave të rrezikuara nga përmbytjet	66.67	11.11	11.11	11.11
1.1.2.	Kufizime për ndërtim në zona me rrezik (në planifikim hapësinor / urbanistik)	44.45	33.33	11.11	11.11
1.1.3.	Mbrojtja e fushave të përmbytjeve dhe zonave të mbajtjes	88.89	00.00	00.00	11.11
1.2.	Përshtatja e përdorimit të tokës (për shmangien e rrezikut, largimin ose zhvendosjen dhe reduktimin e rrezikut)				
1.2.1.	Përshtatja e përdorimit ekzistues të tokës në zonat e rrezikuara nga përmbytjet (përfshirë bujqësinë dhe pylltarinë)	44.45	22.22	00.00	33.33
1.2.2.	Përshtatja e ndërtimeve dhe infrastrukturës në zonat me rrezik (planifikimi dhe ndërtimi i përshtatur për përmbytjet)	33.33	00.00	66.67	00.00
1.2.3.	Konsultimi me sektorët e bujqësisë dhe pylltarisë për rritjen e ndërgjegjësimit	100.00	00.00	00.00	00.00
1.3.	Parandalimi i rrezikut duke përshtatur ndërtesat ndaj përmbytjeve				
1.3.1.	Trajtimi i përshtatur ndaj përmbytjeve lidhur me substancat që rrezikojnë ujin	55.56	00.00	33.33	11.11
2.	Aspekti: Mbrojtja Natyrore nga Përmbytjet				
2.1.	Menaxhimi natyror i përmbytjeve, rregullimi i rrjedhës së ujit				
2.1.1.	Rivitalizimi i shtretërve dhe brigjeve të lumenjve / ish fushat e përmbytura	44.45	00.00	33.33	22.22
2.1.2.	Ndryshimi i rrjedhave të lumenjve dhe kushteve të pjerrësisë	00.00	00.00	100.00	00.00
2.1.3.	Mbrojtja e zonave përgjatë brigjeve të lumenjve	100.00	00.00	00.00	00.00
2.1.4.	Mbështetje për zhvillimin e zonave të përmbytjeve natyrore	100.00	00.00	00.00	00.00
2.1.5.	Mirëmbajtja e gjerë e modifikuar e lumit	55.56	22.22	22.22	00.00
2.1.6.	Heqja/shkëputja e trotuareve në zonat urbane / Menaxhimi i ujërave të shiut	44.45	00.00	55.55	00.00
2.2.	Riaktivizimi i zonave të mbajtjes (rregullimi i rrjedhjes / rregullimi i rrjedhës së ujit)				
2.2.1.	Prishja e digave/pritave	33.34	22.22	22.22	22.22
2.2.2.	Vendosja e digave/pritave të pasme	44.45	22.22	33.33	00.00
2.2.3.	Heqja e një bankine artificiale	33.34	22.22	22.22	22.22
2.2.4.	Lidhja me zonën që bën mbajtjen e ujërave (p.sh. ujërat e pasme, degët e vjetra të lumit)	33.34	11.11	55.55	00.00
3.	Aspekti: Mbrojtja Teknike nga Përmbytjet				
3.1.	Rregullimi i rrjedhës së ujit / Punimet e fushës së përmbytur (masat e mbajtjes)				
3.1.1.	Ndërtimi i një pellgu mbajtës	33.34	11.11	44.44	11.11
3.1.2.	Krijimi i një polder mbajtjeje	33.34	11.11	44.44	11.11
3.1.3.	Restaurimi, zgjerimi, përmirësimi i sistemeve ekzistuese të mbajtjes (diga/pellgje/polder)	33.34	11.11	44.44	11.11
3.2.	Rregullimi i rrjedhës së ujit / Kanalet (prita, diga, mure dhe struktura mbrojtëse lëvizëse)				
3.2.1.	Punimet e mbrojtjes nga përmbytjet (prita, diga ose mure)	55.56	00.00	33.34	11.11
3.2.2.	Forcimi i strukturave ekzistuese të mbrojtjes nga përmbytjet	55.56	00.00	33.34	11.11
3.2.3.	Adoptimi i një sistemi të lëvizshëm (stacionar) të mbrojtjes nga përmbytjet	22.22	00.00	55.56	22.22
3.2.4.	Drenazhimi në zonën e digave dhe mbrojtja nga kthimi i ujërave	55.56	00.00	33.33	11.11
3.3.	Rregullimi i rrjedhës së ujit / Kanalet (masat në lumenj/mbrojtje lumore)				
3.3.1.	Pastrimi i kanaleve të rrjedhjes së ujit brenda vendbanimeve	55.56	00.00	33.33	11.11
3.3.2.	Eliminimi i ngushtimeve / hapësirave të ngushta në lumenj	00.00	00.00	100.00	00.00
3.3.3.	Ndërtimi dhe forcimi i një kanali bypass	00.00	00.00	100.00	00.00
3.4.	Menaxhimi i ujërave sipërfaqësore (masat e menaxhimit të ujërave urbane)				
3.4.1.	Menaxhimi i ujit të shiut	55.56	33.33	11.11	00.00
3.4.2.	Zhvillimi i një sistemi të mbajtjes së ujërave (p.sh. kanali i depozitimit të ujit të shiut)	55.56	33.33	11.11	00.00
3.4.3.	Përmirësimi i një sistemi kullimi i përshtatur ndaj përmbytjeve (p.sh. panele bllokuese, kapak që nuk lejon kthimin pas të ujërave)	55.56	33.33	11.11	00.00
3.5.	Mbrojtja e objekteve/strukturave				
3.5.1.	Mbrojtja e objekteve/strukturave të ndërtesave individuale	00.00	00.00	100.00	00.00
3.5.2.	Mbrojtja e objekteve/strukturave të sistemeve infrastrukturore (p.sh. transporti, energjia, furnizimi me ujë)	00.00	00.00	100.00	00.00
3.6.	Masa të tjera mbrojtëse				
3.6.1.	Përmirësimi i menaxhimit të kapaciteteve rezervuarëve / lumenjve me diga	00.00	00.00	100.00	00.00
3.6.2.	Mbrojtje kundër rrjedhjeve/filtimit dhe ujërave nëntokësore	77.78	00.00	00.00	22.22

4.	Aspekti: Gatishmëria dhe Informimi				
4.1.	Gatishmëria ekonomike/financiare				
4.1.1.	Masat paraprake financiare nga rezervat dhe sigurimet (sigurimi nga rreziqet natyrore)	55.56	00.00	00.00	44.44
4.2.	Gatishmëria informative				
4.2.1.	Përmirësimi i parashikimit të përmbytjeve dhe paralajmërimit / mesazheve për përmbytje	88.89	00.00	00.00	11.11
4.3.	Gatishmëria e lidhur me sjelljen				
4.3.1.	Publikimi i hartave të rrezikut nga përmbytjet pranë zonave të rrezikuara	100.00	00.00	00.00	00.00
4.3.2.	Vijueshmëria e punës për rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit	100.00	00.00	00.00	00.00
4.4.	Analizimi, përgatitja dhe përpunimi lidhur me kontrollin e rrezikut				
4.4.1.	Përafrimi ose optimizimi i skemave të alarmit dhe veprimit (skemat e menaxhimit të fatkeqësive)	100.00	00.00	00.00	00.00
4.4.2.	Mbrojtja Civile	44.45	00.00	55.55	00.00
4.4.3.	Mbledhja dhe analiza e përvojave që lidhen me përmbytjet	100.00	00.00	00.00	00.00

Legjenda:

PL% – përqindja e masave në përputhshmëri të lartë,

PP% – përqindja e masave në përputhshmëri të pjesshme,

PK% – përqindja e masave në përputhshmëri të kushtëzuar

X% – përqindja e masave për të cilat nuk mund të përcaktohet përputhshmëria

	përputhshmëri e lartë		përputhshmëri e kushtëzuar
	përputhshmëri e pjesshme		nuk mund të përcaktohet përputhshmëria

Nga analiza krahasuese e masave specifike në varësi të përputhshmëri së tyre me OM-të, rezulton se përqindjet e ndikimeve të vlerësuara ndahen në dy grupe, respektivisht 27 masa me përqindje përputhshmërie të lartë dhe 14 masa me përqindje përputhshmërie të kushtëzuar. Këto të fundit përmbajnë kryesisht elementë të ndërhyrjes strukturore, të cilat sic dihet do të kërkojnë të filtrohen edhe përmes VNSM-ve specifike.

Tabelat 21 dhe 22 me poshtë pasqyrojnë në mënyrë përmbledhëse krahasimin e masave specifike në funksion të përputhshmërisë së tyre me objektivat mjedisore.

Tabela 21: Përputhshmëria në % e masave tip në lidhje me OM-të- Përmbledhje

Përputhshmëria (%)	100.00%	88.89%	77.78%	66.67%	55.56	44.45%	44.44%	33.34%
E lartë	7	2	1	1	10	4	0	2
E kushtëzuar	6	0	0	1	4	0	3	0

Tabela 22: Aspektet dhe nën-aspektet në raport me përputhshmërinë në % të masave në lidhje me OM-të

Aspektet	Përputhshmëria në %	
	E lartë	E kushtëzuar
Parandalimi i rreziqeve		
Instrumentet Administrative	3	0
Përshtatja e përdorimit të tokës	2	1
Përshtatja e ndërtesave ndaj përmbytjeve	1	0
Mbrojtja Natyrore nga Përmbytjet		
Menaxhimi natyror i përmbytjeve	4	2
Riaktivizimi i zonave të mbajtjes	3	1
Mbrojtja Teknike nga Përmbytjet		
Punimet e fushës së përmbytur	0	3
Kanalet (prita, diga, mure dhe struktura mbrojtëse lëvizëse)	3	1
Kanalet (masat në lumenj/mbrojtje lumore)	1	2
Menaxhimi i ujërave sipërfaqësore	3	0
Mbrojtja e objekteve/strukturave	0	2

Masa të tjera mbrojtëse	1	1
Gatishmëria dhe Informimi		
Gatishmëria ekonomike/financiare	1	0
Gatishmëria informative	1	0
Gatishmëria e lidhur me sjelljen	2	0
Analizimi, përgatitja dhe përpunimi lidhur me kontrollin e rrezikut	2	1

Sic vërehet, edhe ato masa të cilat kanë raport përputhshmërie me përqindje të lartë, pesha e tyre specifike nuk është e njëjtë dhe paraqesin një përqindje përputhshmërie nga më e ulta 33.34% deri në 100%.

Masat tip me përputhshmëri të kushtëzuar paraqitën më tepër me ato që kanë elementë të ndërhyrjes strukturore dhe ndikimet që mund të kenë efekte negative në mjedis në raport me përqindjen e përputhshmërisë janë nga 44-44 % deri në 100%. Këto rezultate theksojnë nevojën e një përafrimi të integruar kur do të bëhet zbatimi i masave specifike në raport si me projektet specifike, por edhe nën këndvështrimin kumulativ të efekteve sipas sektorëve të veprimit dhe vendodhjes ku masat tip specifike do të ndërmerren me fokus në funksionimin e ekosistemit.

7. NDIKIMET KUMULATIVE

Ky seksion përshkruan ndikimet kumulative të zbatimit të masave të PMRRP. Vlerësimi i ndikimeve kumulative ka marrë në konsideratë pyetjen kyç: a mbron dhe përmirëson plani kapitalin natyror në nivelin e ekosistemeve? Në mbështetje të kësaj është konsideruar edhe nëse plani mbështet integrimin e kapitalit natyror në vendimmarrje për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet.

Kapitali natyror mund të përkufizohet si elemente të natyrës së ekosistemeve të pranishme që drejtpërdrejt ose tërthorazi prodhojnë vlerë për njerëzit. Ai përfaqëson rezervat tona të burimeve natyrore si uji, ajri, toka, mineralet dhe pyjet dhe proceset natyrore si cikli i ujit dhe cikli i lëndëve ushqyese. Këto asete kapitale natyrore ofrojnë një rrjedhë shërbimesh të ekosistemit duke përfshirë ushqimin, ujin e pastër, rregullimin e përmbytjeve dhe rekreacionin. Njerëzit i përfitojnë në mënyra të ndryshme këto shërbime. Prandaj, kapitali natyror është një qasje e dobishme për të shqyrtuar në mënyrë holistike implikimet e mundshme të planit në gamën e tematikaveve mjedisore të VSM-së.

Vlerësimi i ndikimeve të masave të propozuara në PMRRP, i paraqitur në seksionin e mësipërm, nxjerr në pah një sërë ndërveprimesh mes masave të ndryshme. Në mënyrë specifike, vlerësimi identifikon potencialin për efekte pozitive dhe negative të grup-masave që lidhen me aspektet e përshkruara në listën e masave, por edhe me aspekte më specifike siç është përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, lidhja me proceset natyrore, masat e MRP në nivel lokal dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik.

Këto ndërveprime dhe ndërlidhje janë përmbledhur më poshtë:

Parandalimi i rreziqeve nga përmbytjet

Në përgjithësi, efektet e masave të propozuara pritet që të jenë pozitive, përveç masës që lidhet me përshtatjen e ndërtimeve dhe infrastrukturës në zonat me rrezik, e cila parashikohet të ketë efekt negativ gjatë ndërtimit në biodiversitet, tokë, ujë, asetet materiale, trashëgimi kulturore dhe peizazh. Megjithatë, ky është një ndikim afatshkurtër dhe i lokalizuar. Në afat të gjatë ka të ngjarë të ketë efekte të dobishme në shëndetin e njerëzve, infrastrukturën, pronën, bizneset dhe asetet historike për shkak të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, si dhe nga perspektiva e cilësisë së ujit.

Mbrojtja natyrore/teknike nga përmbytjet

Masat që lidhen me ndryshimin e rrjedhës lumore, shembjen e digave, masat që lidhen me mbrojtjen e objekteve/strukturave, etj., do të shkaktojnë ndikime negative të drejtpërdrejta ose të tërthorta ku, si ndikimet e përhershme ashtu edhe ato të përkohshme do të kërkojnë masa shtesë zbutjeje. Efektet negative përfshijnë humbjen, dëmtimin ose shqetësimin e tokës bujqësore, habitatit, hapësirës rekreative dhe tokës së përdorur nga komuniteti ose toka e identifikuar për zhvillim në të ardhmen, si dhe dëmtim dhe shqetësim brenda kufijve të pronës private dhe ndërprerje të aksesit tek toka/pronat, ndërprerje të vendkalimeve të faunës, sedimenteve etj.

Efekte negative parashikohen edhe për mjediset breglumore dhe bregdetare të cilat mund të dëmtohen përgjithmonë për shkak të ndërhyrjeve të parashikuara.

Gatishmëria dhe Informimi

Masat e parashikuara në këtë aspekt u vlerësuan se kanë një efekt të përgjithshëm pozitiv, veçanërisht në aspektin ekonomik, shëndetësor dhe social. Ndërgjegjësimi për shërbimet e paralajmërimit të përmbytjeve është i rëndësishëm për t'i lejuar njerëzit të përgatiten për një ngjarje përmbytjeje dhe të

kuptojnë se çfarë të bëjnë në një ngjarje përmbytjeje. Gjithashtu ato konsiderohen të dobishme dhe me efekt pozitiv, pasi lejojnë planifikimin e reagimit ndaj emergjencës së përmbytjeve.

Sa më shumë që njerëzit të jenë të vetëdijshëm për rrezikun nga përmbytjet dhe si të reagojnë ndaj tij, aq më shumë përfitime do të ketë në drejtim të mbrojtjes nga përmbytjet. Nëse publiku është i njohur me opsionet e parandalimit të përmbytjeve dhe masat e disponueshme për të zvogëluar efektet e përmbytjeve, ata ka më shumë gjasa që njerëzit t'i përdorin këto për të mbrojtur veten, pronat dhe bizneset e tyre. Këto masa kanë janë të dobishme për reduktimin e ndikimeve dhe pasojave të përmbytjeve, mbrojtjen e aseteve historike, pronave, aseteve dhe bizneseve, duke rezultuar në përfitime për shëndetin e njeriut.

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike është një nga elementët e rëndësishëm të planit. Kjo reflektohet edhe në natyrën e masave të propozuara, të cilat synojnë që zona të krijojë një përshtatshmëri ndaj ndryshimeve klimatike dhe njëkohësisht të jetë në gjendje të menaxhije dhe njëkohësisht të jetë në gjendje të menaxhojë rrezikun ndaj përmbytjeve. Në këtë këndvështrim ka një përputhje të konsiderueshme midis temës së VSM-së që mbulon faktorët klimatikë dhe popullsinë e shëndetin e njeriut, dhe masave të propozuara. Kjo për shkak të kontributit pozitiv që do të japë plani në përshtatjen me rreziqet e ndryshimeve klimatike, e cila, nga ana tjetër sjell efekte pozitive në qëndrueshmërinë e komuniteteve dhe ekonomive lokale, infrastrukturën kryesore nga e cila ata varen dhe shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve.

Për arritjen e përshtatshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike nevojitet një game e gjerë mjetesh që lidhen me infrastrukturën inxhinierike. Këto mjete përfshijnë: menaxhimin e përmbytjeve natyrore, menaxhimin e tokës dhe sistemet e qëndrueshme të kullimit. Këto lloje mjetesh kanë potencialin për të siguruar mbrojtjen dhe restaurimin e kapitalit natyror. Si shembuj mund të përmenden: krijimii i habitatit, zgjerimi i rrjeteve të infrastrukturës së gjelbër, menaxhimi i pyjeve, reduktimi i erozionit të tokës dhe i futjes së sedimenteve dhe ndotësve në rrjedhat ujore. Përfshirja e tyre në nivel rajonal/lpka, por edhe kombëtar, do të ndihmonte në lehtësimin e integritit të kapitalit natyror në vendimmarrje në të gjitha nivelet.

Lidhja me proceset natyrore

Siç u përmend më sipër, mjetet për arritjen e standardeve të përshatshmërisë në nivel lokal, përfshijnë menaxhimin e përmbytjeve natyrore, menaxhimin e tokës dhe sistemet e qëndrueshme të kullimit. Përmes strukturimit dhe propozimeve të tij, plani synon që përmes lidhjes me proceset natyrore dhe përdorimit të këtyre llojeve të mjeteve, të mbështetet mbrojtja dhe restaurimi i kapitalit natyror dhe shërbimeve që ai ofron. Kjo reflektohet në një sërë ndërveprimesh në tematikat e VSM-së, të cilat demonstronjë gjithashtu përfitimet e integritit të kapitalit natyror në vendimmarrje.

Vlerësimi nxjerr në pah një lidhje pozitive midis biodiversitetit dhe shëndetit e mirëqenies së njeriut për shkak të përfitimeve që vijnë nga ndërveprimi me mjedisin natyror. Në zonat urbane në veçanti, ndërhyrjet për menaxhimin e rrezikut mund të ndihmojnë në përmirësimin ose zgjerimin e rrjeteve të infrastrukturës së gjelbër përmes krijimit të habitatit ose sistemeve të qëndrueshme të kullimit. Kjo nga ana tjetër mund të ketë përfitime si për shëndetin fizik ashtu edhe për mirëqenien mendore.

Gjithashtu, ka një ndërlidhje të fortë midis biodiversitetit dhe mjedisit ujor veçanërisht në lidhje me cilësinë dhe sasinë e burimeve ujore. Masat për menaxhimin e rrezikut, të cilat lidhen me proceset natyrore, mund të mbështesin arritjen e objektivave të SKMIBU, me përfitime për habitatet dhe rrjedhat

ujore të lidhura me llojet e florës dhe faunës, zonën bregdetare dhe ligatinat. Krijimi dhe menaxhimi i habitatit, i lidhur ky qoftë me menaxhimin e përmbytjeve natyrore qoftë me menaxhimin e tokës, mund të sjellë përfitime edhe në cilësinë e ujit dhe burimet ujore. Nga reduktimi i erozionit të tokës, i sedimenteve dhe ndotjes së rrjedhave ujore, mund të përfitojë biodiversiteti i lidhur me mjedisin ujor. Ky përbën një element shtesë në gamën e shërbimeve të ekosistemit (përfshirë ofrimin e ujit të pijshëm).

Përfitimet që vijnë nga mbrojtja prej erozionit të tokës reflektohen edhe në cilësinë e ujit, si dhe në menaxhimin e burimeve natyrore (ruajtja e tokës, burimeve ujore, etj.) dhe aseteve materiale (toka bujqësore).

Gjithashtu, masat e propozuara për mbrojtjen nga përmbytjet do të ndikojnë edhe në cilësinë dhe karakterin e peizazhit në zonat urbane dhe rurale, duke u zbatuar direkt aty ku ato (masat) kanë efekte pozitive, apo duke aplikuar masat zbutëse aty ku ato nevojiten. Projektimi dhe më pas zbatimi i masave mbrojtëse do të duhet t'i marrin në konsideratë këto aspekte, qoftë në mënyrë të integruar, qoftë edhe individualisht. Kjo do të ndihmojë që efektet e mundshme negative në karakterin e peizazhit të shmangen ose minimizohen dhe të shtohen mundësitë për përmirësimin e cilësisë së tij.

Masat e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet në nivel lokal

Është e qartë se zbatimi i masave të propozuar për MRP do të shkaktojë efekte/ndërrhyrje në hapësira të caktuara në nivel lokal. Infrastruktura e re ose e përmirësuar për MRP mund të ndikojë në receptorë të ndryshëm. Në varësi të zonës, kjo mund të përfshijë habitatet dhe llojet e florës dhe faunës, hapësirat e gjelbra rekreative dhe asetet e trashëgimisë, por edhe zonën bregdetare. Efekti lidhur me mbrojtjen nga përmbytjet nëpërmjet infrastrukturës së re të përmirësuar, është pozitiv, por ka zona ku potencialisht pritet të ketë ndërrhyrje/efekte negative në elementët e sipërpërmendur (kryesisht në zone bregdetare dhe grykëderdhjen e lumit). Të dyja këto aspekte duhen patur parasysh gjatë hartimit të projektit të zbatimit të masave për MRP, dhe më pas gjatë fazës së ndërtimit.

Detajimi i efekteve të pritshme dhe përcaktimi i masave zbutëse përkatëse do të bëhet në fazën e hartimit të VNMS-ve specifike.

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik

PMRRP, ndër të tjera, synon të forcojë lidhjen mes menaxhimit të rrezikut dhe mundësisë për rritje dhe zhvillim ekonomik. Kjo është e dobishme për komunitetet lokale dhe ekonominë e zonës. Gjithashtu, mund të ndihmojë në rivitalizimin e vendeve historike, duke përfshirë ripërdorimin e ndërtesave historike. Megjithatë, rritja ekonomike mund të ketë edhe implikime negative për receptorët mjedisorë. Një shembull i kësaj është potenciali që një rritje ekonomike të ndikojë në hapësirat e gjelbra ose tokat e ndotura (të dyja me interes në aspektin e mbrojtjes së mjedisit).

Në këtë kuadër, rekomandohet që VNMS-të në nivel mase/projekti specifik të marrin parasysh edhe ndikimet e mundshme të çdo zhvillimi ekonomik të lidhur me zbatimin e masës/projektit.

8. NDIKIMET NDËRKUFITARE

Zona e projektit dhe zona përkatëse me rrezik përmbytjeje kanë dimensione ndërkufitare të ndryshme:

- Baseni i lumit Drin është një basen lumor ndërkufitar siç përshkruhet në Kapitullin 3.
- Lumi i Bunës është kufiri ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi për afërsisht 20 km e fundit përpara se të derdhet në detin Adriatik.
- Zona me rrezik përmbytjeje e Drinit dhe Bunës përfshin, përveç territorit shqiptar, edhe territorin malazez.
- Liqeni i Shkodrës dhe derdhjet e Drinit dhe Bunës ndikohen nga degët lumore në Shqipëri dhe Mal të Zi.

Kuadri ligjor shqiptar për VSM, konkretisht Ligji nr. 91.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, Kreu V, Neni 16 dhe 17 kërkon shprehimisht që: *“Kur ministria merr informacion apo njoftim nga një shtet tjetër në lidhje me një plan ose program të propozuar, i cili mund të ketë pasoja të rëndësishme mbi mjedisin ndërkufitar në Shqipëri, ajo fillon menjëherë bisedimet me palën e origjinës, në përputhje me kërkesat e konventës së Kombeve të Bashkuara “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar (ESPOO)” dhe protokollit të saj “Për vlerësimin strategjik mjedisor (KIEV)”, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.”*

Në këtë kuadër, si dhe nën dritën e direktivës së BE-së për përmbytjet, aspektet ndërkufitare të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet duhet të integrohen në procesin e planifikimit në basenet lumore ndërkombëtare. Efektet ndërkufitare të përmbytjeve dhe masave të planifikuara për menaxhimin e rrezikut, janë:

- Ndikimi i liqenit të Shkodrës (ndërkombëtarisht) në situatën me përmbytjet në rajon;
- Situata ndërkufitare në rrjedhën e poshtme të lumit, që do të thotë se të gjitha masat për mirëmbajtjen dhe rindërtimin e lumit, pritave ose punimeve të tjera mbrojtëse mund të kenë ndikim mbi territorin e shtetit fqinj (në të dy anët: Shqipëria mbi Malin e Zi dhe anasjelltas);
- Masat e parashikimit dhe parandalimit janë ngushtësisht të lidhura ndërmjet pjesës Shqiptare dhe asaj të Malit të Zi në grykëderdhje; Mali i Zi varet nga masat e parashikimit dhe gatishmërisë të palës Shqiptare.

Menaxhimi ndërkufitar i rrezikut nga përmbytjet kërkon hapa bashkëpunimi të ndryshëm:

- Informim të ndërsjellë për rreziqet dhe veprimet përkatëse;
- Vlerësim i përbashkët i rrezikut, modelim dhe sistem paralajmërimi;
- Planifikim i përbashkët, ose i përshtatur bashkërisht, i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet;
- Planifikim i përbashkët i reagimit në raste emergjencash;
- Komunikim dhe bashkëpunim gjatë përmbytjeve/veprimeve të përbashkëta të reagimit në raste emergjencash.

Rrjedhimisht, aktorët dhe palët e interesuara në Malin e Zi ishin pjesërisht të përfshirë në procesin e punës për planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, së pari për arritjen e objektivit minimal të informimit të ndërsjellë dhe për bërjen e hapave drejt një planifikimi të koordinuar. Përfaqësuesit e Malit të Zi nga drejtorja për ujërat dhe koordinatori për njësinë territoriale Bar/Ulqin/ Budva i Drejtorisë për Menaxhimin e Emergjencave në Ministrinë e Brendshme morën pjesë në disa nga takimet e punës. Në të njëjtën kohë, ata po punonin për hartimin e planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet për qytete dhe rajone të ndryshme të Malit të Zi. Plani i Bashkisë së Ulqinit për mbrojtjen nga përmbytjet është më i domosdoshmi në këtë drejtim sepse ky rajon është fqinj me rajonin e Shkodrës.

Zona e projektit si pjesa e poshtme e basenit ndërkombëtar të lumit Drin është subjekt i bashkëpunimit ndërkombëtar të vendeve fqinje. Ministrat përgjegjës për burimet ujore dhe menaxhimin e mjedisit të këtyre vendeve dhe përfaqësues të nivelit të lartë nënshkruan në Tiranë në 25 Nëntor 2011 Memorandumin e Mirëkuptimit për menaxhimin e basenit të zgjeruar ndërkufitar të Drinit. Vizioni strategjik i përbashkët për menaxhimin e basenit të Drinit përbën përmbajtjen e Memorandumit të Mirëkuptimit (MM). Vizioni strategjik i përbashkët, si dhe një numër veprimesh prioritare për promovimin e bashkëpunimit dhe koordinimit shumëpalësh, u formua dhe u zhvillua nëpërmjet dialogut për Drinin. Janë propozuar një sërë veprimesh me synim lehtësimin e zbatimit të memorandumit. Plani i veprimeve5 përcakton dhe përshkruan aktivitetet, objektivat dhe institucionet që do të jenë përgjegjëse për zbatimin e secilës veprimtari, burimet dhe ekspertët që do të angazhohen si dhe rezultatet. Veprimet “afatshkurtra” janë propozuar në planin e veprimeve deri në fund të vitit 2015. Zbatimi i veprimtarive do të përcaktohet nga disponueshmëria e burimeve njerëzore dhe financiare të mjaftueshme. Planifikimi konkret për veprimet “afatmesme” është përcaktuar të bëhet nga fundi i 2015-ës në bazë të vlerësimit të: (a) progresit të zbatimit të veprimeve dhe veprimtarive; (b) rezultatit që do të arrihet si efekt i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i zbatimit të planit të veprimeve; (c) rezultatit që do të arrihet nga vendet fqinje nëpërmjet përpjekjeve të tyre për të adresuar çështjet e menaxhimit të lidhura me ujin. Veprimet përfshijnë llojet e mëposhtme të masave:

1. Përmirësim i mekanizmave të koordinimit ndërmjet palëve;
2. Përmirësim i bazës së njohurive rreth basenit të Drinit;
3. Përmirësim i shkëmbimit të informacionit nëpërmjet ngritjes së një sistemi për shkëmbim të rregullt të informacionit përkatës ndërmjet autoriteteve kompetente të secilës palë;
4. Përmirësimi i bashkëpunimit në fushën e gatishmërisë së rrezikut nga përmbytjet, menaxhimit dhe mbështetjes së ndërsjellë;
5. Forcimi institucional në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore;
6. Promovimi i pjesëmarrjes së publikut dhe angazhimi i palëve të interesuara.

Në zonën që ky plan targeton, bashkëpunimi ndërkufitar i fqinjëve shqiptarë dhe malazez bazohet në takime dhe vizita të rregullta që mbahen në të dy anët e kufirit. PMRRP angazhon gjithashtu edhe partnerë shqiptarë edhe malazez. Në vitin 2013 u zhvilluan një numër workshopesh me pjesëmarrës vendor dhe kombëtarë në Mal të Zi, në të cilat u paraqit metodologjia e MRP-së në përputhje me direktivën e BE-së për përmbytjet, si dhe u diskutua trajnimi për zbatimin e saj. Në një takim të grupit të punës rajonal në Bar, Mal të Zi (10 Tetor 2013) u diskutua strategjia rajonale. Si rezultat i veprimtarive në Mal të Zi, komunitetet zhvilluan hartat e rrezikut nga përmbytjet me mbështetjen e UNDP.

Në përgjithësi, përgatitja e masave të PMRRP-së bëhet në nivel planifikimi dhe përshkrimet e detajuara të ndërhyrjeve nuk janë të disponueshme në këtë fazë. Duke marrë në konsideratë masat e planit vlerësohet se disa prej tyre do të kenë ndikime ndërkufitare. Për projekte specifike që mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në mjedis në Malin e Zi, në fazat e mëtejshme të përgatitjes së dokumentacionit të projekteve specifike me ndikim ndërkufitar, duhet të kryhen procedurat për vlerësimin e ndikimit në mjedis në nivel ndërkufitar dhe ky të komunikohet rregullisht dhe në mënyrë zyrtare me autoritetet e Malit të Zi. Në thelb, kërkohet të vendoset bashkëpunimi ndërkufitar që në fazat e hartimit të PMRRP.

9. MASAT ZBUTËSE

Vlerësimi ka identifikuar efektet e rëndësishme në mjedis që mund të ndodhin si rezultat i zbatimit të PMRRP. Procesi i vlerësimit gjithashtu identifikoi mundësi për të rritur efektet pozitive dhe për të zbutur çdo efekt negativ mjedisor. Në këtë kapitull përshkruhen masat zbutëse që propozohen për këtë qëllim.

Masat zbutëse të propozuara më poshtë janë hartuar bazuar në informacionin që përmbahet në PMRRP. Detajimi i tyre si dhe përcaktimi i masave më specifike dhe më të drejtpërdrejta do të bëhet gjatë hartimit të VNMS-ve përkatëse lidhur me zbatimin e secilës prej masave të propozuara në PMRRP.

9.1. Popullsia dhe shëndeti i njeriut

- Për aksesin në zonën e punimeve, duhet rënë dakort (kur është e nevojshme) me aktorët e interesit (pronarët, qiramarrësit, përdoruesit/pronarët e objekteve të biznesit/shtëpiake).
- Aty ku aksesit ekzistues nuk mund të përdoret, kjo duhet marrë në konsideratë përpara fillimit të punimeve dhe duhen ngritur strukturat e nevojshme përpara se të ndërmerret ndonjë veprim që mund të shkaktojë ndërprerje të punës.
- Të gjitha punimet e ndërtimit dhe mirëmbajtjes do të kryhen në përputhje me dispozitat ligjore shqiptare lidhur me kontrollin e zhurmës dhe dridhjeve në punimet e ndërtimit, dhe kontraktori duhet të marrë masat zbutëse përkatëse në këtë drejtim.
- Elementët e projektimit duhet të promovojnë një qasje të integruar dhe të qëndrueshme, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel pellgu ujëmbledhës, për menaxhimin e rrezikut nga përmytjet me qëllim mbrojtjen e mjedisit natyror dhe përdorimin efikas të burimeve ekonomike.
- Përpara nisjes së punimeve duhet marrë në konsideratë aksesit i banorëve, psh. në tokat bujqësore apo në shërbime të tjera. Aty ku aksesit mund të ndërpritet përkohësisht, do të sigurohen pika aksesit të përkohshme, por të sigurta.
- Grumbullimi, depozitimi, trajtimi, transportimi i mbetjeve ndërtimore sipas dispozitave në fuqi dhe në bashkëpunim me autoritetet përkatëse.
- Duhet ngritur infrastruktura përkatëse në mënyrë që popullsia dhe bizneset të dinë se si dhe ku do të evakohen, si të sigurojnë objektet e tyre, dhe kur mund të rikthehen në to.
- Ruajtja e aksesit ekzistues në zonat bujqësore, pronat private si dhe lëvizja përgjatë akseve rrugore publike. Nëse kjo nuk është e mundur, duhet të sigurohen mënyra alternative aksesimi gjatë periudhës së ndërtimit.
- Minimizimi i marrjes së tokës (të përhershme dhe të përkohshme) aty ku është e mundur, veçanërisht brenda kufijve të pronave private rezidenciale dhe komerciale, si dhe brenda zonave rekreative publike.
- Aksesit dhe koha për mirëmbajtje duhe të minimizohen sa më shumë që të jetë e mundur.
- Duhet hartuar dhe shpërndarë udhëzime për të ndihmuar që bizneset e turizmit, banorët dhe ambientet tregtare të përgatiten për ngjarjet e përmytjeve.
- Do të shpërndahet informacion se si fermerët duhet të reagojnë në rast përmytjeje, duke përfshirë zonat e sigurta për të lëvizur bagëtinë dhe tokat që duhen lënë djerrë për shkak të përmytjeve.
- Restaurimi i të gjitha zonave të prekura, përfshirë edhe ato private, dhe krijimi i peizazhit, aty ku është e përshtatshme
- Toka e marrë përkohësisht gjatë periudhës së ndërtimit do të kthehet në gjendjen e mëparshme pas përfundimit të punimeve.
- Grafiku i punimeve duhet t'i komunikohet pronarëve/përdoruesve të tokës, me qëllim minimizimin e efekteve tek punët në bujqësi.

9.2. Biodiversiteti

- Respektimi i udhëzimeve për parandalimin e ndotjes dhe praktikave më të mira lidhur me materialet e ndërtimit dhe praktikat e punës pranë rrjedhave ujore.
- AKM/ARM dhe bashkitë përkatëse duhet të ndihmohen në detajimin e masave të propozuara në PMRRP për të adresuar se si do të përmbushen objektivat e zonës së mbrojtur pas ngjarjes së përmbytjes.
- Heqja e bimësisë/pemëve do të ndërmerret jashtë sezonit të shumimit të shpendëve, aty ku është e mundur, për të siguruar që foletë e shpendëve me të vegjël ose vezë të mos shkatërrohen. Në çdo rast, nëse kërkohet heqja e bimësisë, pemët dhe shkurret duhet të kontrollohen nga një biolog i kualifikuar, për praninë e zogjve riprodhues/fole aktive.
- Heqja e bimësisë/pemëve duhet të shmanget sa me shumë që të jetë e mundur.
- Para fillimit të punimeve duhet të kryhet një vlerësim i habitateve në zone, nga një ekspert i kualifikuar dhe me përvojë.
- Duhet të merren parasysh masat për përmirësimin e habitatit, që në fazën e projektimit për zbatim të masave të propozuara.
- Ndërtimi duhet të ndjekë të gjitha udhëzimet për parandalimin e ndotjes dhe deklaratat e metodës së punimeve duhet të dakortësohen me AdZM në zonat ku mund të hasen lloje të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Duhet të kryhet kontrolli i rrjedhjeve nga zonat e punimeve.
- Parashikimi i masave për kontrollin e sedimenteve gjatë punimeve, në mënyrë që të mos dalin sedimente, të cilat mund të ndikojnë në habitatet dhe llojet përgjatë rrjedhave ujore.
- Çdo ndërhyrje duhet kryer në konsultim dhe me angazhimin e AKM/ARM/Bashki (drejtoria e mjedisit) dhe AdZM, si dhe aktorët e tjerë të interesit.
- Zhvilluesi duhet të sigurojë:
 - Mbrojtjen e duhur për habitatet ekzistuese ujore nga ngjarjet e përmbytjeve.
 - Parashikimin në projekt të kalimeve të nevojshme për llojet e faunës, duke përdorur praktikën më të mira të projektimit dhe metodave të ndërtimit.
 - Ruajtjen e regjimeve natyrore të rrjedhës ujore dhe transportit të sedimentit, duke e përfshirë këtë në parametrat e projektimit dhe minimizuar rreziqet që në këtë fazë.
- Identifikimi, zbatimi dhe menaxhimi i punimeve për përmirësimin e habitatit aty ku është e mundur.
- Punimet që do të kryhen në rrjedhën ujore duhet të planifikohen për të minimizuar ndikimet tek të gjitha llojet ujore.
- Monitorimi për të garantuar se të gjitha masat zbutëse po funksionojnë ashtu siç duhet.
- Monitorimi për të garantuar se punimet nuk shkaktojnë efekte të dëmshme mbi habitatet dhe llojet e florës dhe faunës.
- Mbjelljet e pemëve ndihmojnë, aq sa është e mundur, në rivendosjen e mbulesës bimore të tokës dhe shtimin e zonave pyjore.
- Programimi i punimeve në mënyrë që të mos përkojë me kohën e rrjedhës së lartë ose të ulët, apo në periudhat kur zona përdoret nga llojet e mbrojtura.
- Projekti i zbatimit hartohet në mënyrë të tillë që të sigurojë përmirësim të regjimit të rrjedhës ujore, të mos ndryshojë regjimin ekzistues normal.
- Aktivitetet e mirëmbajtjes duhen planifikuar të realizohen në periudhën kur ndikimet në bimësi janë minimale.
- Programimi i punimeve në mënyrë të tillë që të shmangen/minimizohen konfliktet me llojet e mbrojtura dhe/ose ato ujore që mund të gjenden në zonën e punimeve.

9.3. Toka

- Aplikimi i procedurave të praktikave të mira në lidhje me gjurmimin, trajtimin dhe depozitimin e kujdesshëm të dheut gjatë proceseve të skarifimit, ndërtimit dhe restaurimit.
- Hartimi dhe zbatimi i deklaratës së metodave të punës duke përfshirë masat e kontrollit të sedimentit.
- Sigurimi që asnjë lloj invaziv të mos hyjë ose dalë jashtë zonës gjatë lëvizjeve të dheut.
- Zbatimi i masave të kontrollit të erozionit dhe sedimentit.
- Kufizimi i periudhës së punimeve gjatë kohës kur moti është i përshtatshëm.
- Kufizimi, sa të jetë e mundur, i shtrirjes dhe vendndodhjes së kantievërve të punës dhe hapësirave të magazinimit.
- Rekuperimi i zonave të prekura/dëmtuara.
- Ruajtja e vegjetacionit në kanale për të maksimizuar mbrojtjen nga erozioni
- Ripërdorimi i materialeve të gërmuara, aty ku është e mundur, në argjinatura dhe peizazh.
- Përdorimi i udhëzimeve dhe praktikave më të mira për të minimizuar rrjedhjen e sedimenteve gjatë punimeve.

9.4. Uji

- Respektimi i udhëzimeve që lidhen me zbutjen e efekteve gjatë ndërtimit, për shembull garantimi që papërshkueshmëria e zonës të mos rritet përkohësisht gjatë ndërtimit.
- Duhet të kryhet një studim mbi kompanitë e shërbimeve publike për të përcaktuar vendndodhjen e shërbimeve ekzistuese në të gjithë zonën e zhvillimit. Respektimi i mëpasshëm i praktikave më të mira të ndërtimit duhet të sigurojë që proceset ndërtimore të marrin parasysh vendndodhjen e shërbimeve, në mënyrë që këto të mos dëmtohen si pasojë e mosnjohjes së vendndodhjes dhe të mos shkaktohen përmbytje të lokalizuara.
- Duhet të studiohen dhe përdoren sisteme të përkohshme të kullimit duke aplikuar praktika ndërtimore, aty ku është e mundur, ose metoda të tjera për të kontrolluar dhe trajtuar rrjedhjet e ngarkuara me llum.
- Ndërtimi duhet të kryhet në përputhje me praktikën më të mira. Kjo do të përfshijë zonat e magazinimit të karburantit dhe zonat e përcaktuara për furnizim me karburant.
- Muret mbrojtëse dhe argjinaturat e reja duhet të orientohen në drejtimin e rrjedhës për t'u mbrojtur nga gjerrja.
- Hartimi dhe zbatimi i deklaratës së metodave të punës duke përfshirë masat e kontrollit të sedimenteve dhe të ndotjes.
- Përpara pozicionimit të mureve mbrojtëse, argjinaturave dhe kanaleve, duhet realizuar një studim për të minimizuar rrezikun e ndotësve dhe sedimenteve të tjera që ndikojnë në rrjedhjen e ujit pranë këtyre strukturave.
- Aktivitetet e ndërtimit duhet të planifikohen në mënyrë të tillë që sipërfaqja dhe kohëzgjatja e ekspozimit të tokës të minimizohen aty ku është e mundur, duke e ndarë në faza kohën e ndërtimit, në mënyrë që seksionet të restaurohen përpara se të kalohet në seksionin/fazën tjetër;
- Lëvizja në kantier e makinerive, impianteve dhe pajisjeve të tjera të ndërtimit duhet të reduktohet sa më shumë që të jetë e mundur.
- Materialet e ndryshme të grumbulluara duhet të depozitohen larg rrjedhave ujore ekzistuese.
- Proceset ndërtimore (psh. depozitimi i materialeve) do të marrin në konsideratë ndikimin tek ujërat nëntokësore.
- Rrjedhjet duhet të bllokohen përpara trajtimit dhe shkarkimit/depozitimit të tyre.
- Përdorimi i udhëzimeve dhe praktikave më të mira për të minimizuar rrjedhjen e sedimenteve gjatë punimeve.

- Adoptimi i procedurave të duhura për kontrollin e ndotjes, në përputhje me udhëzimet përkatëse, për të reduktuar rrezikun e rrjedhjeve të ujërave sipërfaqësore të ngarkuara me sedimente që hyjnë në rrjedhat ujore dhe në ujërat nëntokësore.
- Zbatimi i udhëzimeve teknike për ruajtjen dhe restaurimin e fushave lymore dhe rrjedhave ujore natyrore si një formë e zbutjes nga përmbytjet dhe një burim i rëndësishëm mjedisor dhe social. Garantimi që kjo aplikohet edhe në procesin e vendimmarrjes.

9.5. Faktorët klimatikë

- Qasjet e mëposhtme mund të përdoren për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke përfshirë edhe kombinimin e tyre, kur është e nevojshme dhe/ose e mundshme:
 - koncepte të infrastrukturës “*gr*”, d.m.th. ndërhyrje fizike ose masa ndërtimore kundrejt ngjarjeve të jashtëzakonshme, përmes përdorimit të shërbimeve inxhinierike, për të rritur fleksibilitetin e ndërtesave dhe të infrastrukturës,
 - qasjet strukturore “*të gjelbra*” dhe “*blu*”, që kontribuojnë në fleksibilitet më të madh të ekosistemeve, në mënyrë që të parandalohet humbja e biodiversitetit dhe degradimi i ekosistemit dhe që të rikthehen ciklet e ujit, ndërkohë që shfrytëzohen funksionet dhe shërbimet e ofruara nga ekosistemet;
 - konceptet jostrukturore “*të moderuara*”, sipas të cilave, strategjitë për përdorimin e tokës, shpërndarjen e informacionit dhe incentivat ekonomike për reduktimin ose parandalimin e riskut të fatkeqësive janë projektuar dhe zbatuar.
- Preferohen qasjet e “*gjelbra*” dhe “*të moderuara*”, dhe është i volitshëm një kombinim i tyre në cilësinë e masave zbutëse.
 - Aktualisht, një sërë propozimesh për masat e përshtatjes disponohen në disa dokumente, por duke marrë parasysh dyshimet e shumta lidhur me parashikimet e zhvillimit të ndryshimeve klimatike dhe informacionet e kufizuara aktuale për këtë dukuri, monitorimi i zhvillimeve dhe reagimi në mënyrë fleksibel ndaj informacioneve të reja do të jetë i nevojshëm. Në bazë të informacioneve dhe njohurive të reja, informacionet aktuale duhet të korrigjohen/përditësohen, ose duhet të merren masa të reja për përshtatjen.
- Kontraktori duhet të garantojë përdorim dhe mirëmbajtje të rregullt të makinerive dhe pajisjeve, me qëllim minimizimin e emetimeve të gazrave në ajër.

9.6. Asetet materiale

- Përpara nisjes së punimeve do të kryhen konsultime dhe studime mbi shtrirjen e rrjetit të kabllave elektrikë dhe shërbimeve publike (furnizim me ujë, kanalizime, etj.).
- Hartimi i Planit të Menaxhimit të Trafikut.
- Komunikimi/konsultimi me kompanitë e shërbimeve publike lidhur me gërmimet dhe punime të tjera.
- Projekti i zbatimit do të synojë të minimizojë mbetjet dhe të maksimizojë ripërdorimin e materialeve të përshtatshme në vend.
- Do të hartohet dhe zbatohet Plani i Menaxhimit të Mbetjeve, aty ku kërkohet.
- Për të minimizuar mbetjet, aty ku kërkohet për rrugët e aksesit dhe zonat e punimeve, dherat e sipërme do të skarifikohen përpara punimeve dhe do të grumbullohen në vend. Pas përfundimit të ndërtimit, ato do të rikthehen në vendin e mëparshëm dhe për këtë arsye asnjë shtresë e sipërme e dheut nuk do të hiqet nga zona e punimeve.
- Grumbullimi, transporti dhe depozitimi i mbetjeve do të bëhet në zonat e caktuara dhe të licencuara nga autoritetet vendore
- Marrja e tokës (e përhershme apo e përkohshme) do të minimizohet sa më shumë që të jetë e

mundur.

- Elementët e projektimit duhet të promovojnë një qasje të integruar dhe të qëndrueshme, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel pellgu ujëmbledhës, për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, e cila (qasja) kontribuon në përdorimin efikas të burimeve ekonomike dhe synon të mbrojë investimin brenda zonave të rrezikuara nga përmbytjet, duke garantuar që janë aplikuar masat e mjaftueshme dhe të përshtatshme për të zbutur dhe menaxhuar rreziqet e përmbytjeve.
- Autoritetet lokale si dhe kompanitë e shërbimeve publike do të konsultohen dhe informojnë mbi devijimin e transportit në zona të paprekura dhe menaxhimin e shërbimeve publike përgjatë periudhës së ndërtimit, me qëllim minimizimin e ndërprerjes së shërbimeve.

9.7. Trashëgimia kulturore

- Kontrata e ndërtimit duhet të përfshijë masat e përgjithshme që do të zbatohen nga Kontraktori për të mbrojtur karakteristikat dhe zonat e interesit të njohura dhe të panjohura.
- Në rast se nevojitet, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, do të kërkohen shërbimet e një arkeologu apo eksperti të trashëgimisë kulturore.
- Do të mbahen konsultime të rregullta, që në fazat e hershme të studimit dhe projektimit të masave të propozuara, me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si organ statutor në këtë fushë.
- Elementët e projektimit duhet të promovojnë një qasje të integruar dhe të qëndrueshme, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel pellgu ujëmbledhës, për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, e cila (qasja) kontribuon në ruajtjen e arkeologjisë dhe trashëgimisë ndërtimore.
- Roli i autoritetit përgjegjës për situatën e përmbytjeve do të promovohet vashdimisht, përfshirë edhe shpërndarjen e informacionit tek komunitetet e rrezikuara, lidhur me vetë-veprimin e tyre dhe adoptimin e pronave/ndërtesave për t'u mbrojtur nga përmbytjet.
- Do të hartohet një plan veprimi në rast përmbytjesh për ndërtesat historike dhe monumentet e kulturës. Gjithashtu, duhet të sigurohen edhe mjetet dhe burimet e nevojshme (njerëzore, ligjore/institucionale, financiare) për ta zbatuar këtë plan.
- Nëse artefaktet/reliqet do të ruhen/depozitohen, duhet të identifikohet fuqi punëtore dhe një vend i sigurt për t'i paketuar dhe zhvendosur ato, përpara njoftimit për evakuim.

9.8. Peizazhi

- Në dokumentat e kontratës së punimeve do të parashikohet edhe plani i restaurimit të peizazhit të prekur/ndyshuar/dëmtuar.
- Në zonat ku është skarifikuar bimësia dhe është prekur peizazhi, bimësia do të zëvendësohet dhe do të bëhen mbjellje me bimë të zonës, me qëllim përmirësimin dhe integrimin e peizazhit dhe elementëve pamorë.
- Dheu i gërmuar dhe depozituar do të ripërdoret në mënyrë që të minimizohet ndërhyrja tek elementët pamorë.
- Në zonat e kanaleve apo ku ka tombino do të aplikohen elementët peizazhistikë me qëllim integrimin në peizazhin e zonës.
- Elementët e projektimit duhet të promovojnë një qasje të integruar dhe të qëndrueshme, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel pellgu ujëmbledhës, për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, e cila (qasja) kontribuon në mbrojtjen e mjedisit natyror.
- Roli i autoritetit përgjegjës për situatën e përmbytjeve do të promovohet vashdimisht, përfshirë edhe shpërndarjen e informacionit tek komunitetet e rrezikuara, lidhur me vetë-veprimin e tyre dhe adoptimin e pronave/ndërtesave për t'u mbrojtur nga përmbytjet.

10. MONITORIMI

Sistemi i monitorimit i ndikimeve të konsiderueshme në mjedis, që vijnë si rezultat i zbatimit të planit, është një mjet i thjeshtë i monitorimit efikas.

Synimi i programit të monitorimit në kuadër të këtij raporti është që të disponojë një grup të dhënash në lidhje me masat e PMRRP-së, si dhe veprimet në lidhje me to, për të cilat mund të identifikohen ndikimet e mundshme negative në mjedis.

Monitorimi bazohet në tregues, të cilët matin ndryshimet në mjedis, veçanërisht ndryshimet që janë kritike për sa i përket cilësisë së mjedisit. Treguesit e përdorur duhet të jenë realë dhe lehtësisht të matshëm. *“Një tregues mjedisor është një vlerë numerike që ndihmon në dhënien e një pasqyre të gjendjes së mjedisit ose shëndetit të njeriut. Treguesit zhvillohen bazuar në matjet sasiore ose statistikat e gjendjes mjedisore që gjurmohen me kalimin e kohës. Treguesit mjedisorë mund të zhvillohen dhe përdoren në një gamë të gjerë shtrirjeje gjeografike, nga niveli lokal në atë rajonal dhe kombëtar.”¹⁵*

Monitorimi i ndikimit është tejet i rëndësishëm për zbatimin e planit, dhe si sipas ligjit 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, zbatimi i një plani ose programi duhet të monitorohet, në mënyrë që të identifikohen efektet e konsiderueshme ose efektet negative të paparashikuara, të cilat bëjnë të mundur neutralizimin e tyre në kohën e duhur dhe përshtatjen për aq sa është e mundur.

Për të përmbushur funksione të veçanta dhe për të matur cilësinë/sasinë e burimeve mjedisore mund të përdoren disa lloje treguesish:

- Treguesit mbi gjendjen e mjedisit, të cilët pasqyrojnë cilësinë e mjedisit, ose sasinë e dukurive fizike, biologjike ose kimike;
- Treguesit e stresit, të cilët pasqyrojnë efektet e zhvillimit;
- Treguesit e performancës, të cilët mund të përdoren për të vlerësuar arritjet afatgjata në menaxhimin dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Treguesit e zhvillimit të qëndrueshëm, të cilët sjellin një dimension të ri në dhënien e informacionit, lidhur me atë që, ata kërkojnë të përshkruajnë dhe të matin marrëdhëniet kyçe ndërmjet faktorëve ekonomikë, socialë dhe mjedisorë.

Në të gjitha rastet, treguesit duhet të kuantifikojnë dhe thjeshtojnë informacionin, duke e bërë atë më të aksesueshëm për hartuesit e politikave dhe publikun.

Mbledhja e të dhënave sugjerohet që të bazohet në dy burime:

- (a) në të dhënat primare të gjeneruara nga matja e parametrave mjedisorë; dhe
- (b) në vlerësimin e treguesve mjedisorë.

Në procesin e marrjes së të dhënave përmes matjes mund të përfshihen autoritetet rajonale (qarqet), por edhe autoritetet kombëtare (p.sh. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit), autoritetet vendore, organet shkencore dhe profesionale, si dhe organet e shërbimeve publike (p.sh organet menaxhuese të venddepozitimeve, AdZM, drejtoritë e shëndetit publik, etj.). Matja e treguesve mjedisorë është një proces kompleks; d.m.th. është një proces i rregullt ose një proces i vazhdueshëm.

¹⁵ <http://www.epa.gov/igateway/whatIndicator.html>

Një sërë parametrash monitorohen përmes kushteve të lejeve mjedisore dhe përmes programeve të monitorimit në nivel kombëtar/qarku/vendor; këto të dhëna mund të jenë të dobishme.

Është e rëndësishme të theksohet se, të dhënat mjedisore të gjeneruara nga programi i monitorimit duhet të raportohen, publikohen dhe të bëhen të disponueshme për publikun.

Masat e mëposhtme propozohen si pjesë e kësaj VSM-je për monitorimin e efekteve në mjedis si pasojë e zbatimit të planit. Ato (masat) janë hartuar të lidhura me objektivat mjedisore dhe ndikimeve të pritshme të planit në faktorët mjedisorë. Masat përfshijnë synimet dhe pragjet që përcaktojnë se ku mund të nevojiten veprime korrigjuese, në mënyrë që të arrihet synimi i përcaktuar dhe të përmbushet objektivi mjedisor.

Tabela 23: Modeli i programit të monitorimit të ndikimeve të konsiderueshme në mjedis nga PMRRP-ja

Objektivat Mjedisore	Treguesit	Autoriteti Përgjegjës	Frekuenca e Monitorimit	Synimet	Veprime Korrigjuese
Popullsia dhe shëndeti i njeriut					
OM1 Mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së njerëzve përmes përmirësimit të cilësisë së mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të dhëna për ndryshimet në numrin e familjeve dhe bizneseve në rrezik nga përmbytjet ▪ Vitet e jetëgjatësisë me shëndet të mirë ▪ Numri i incidenteve lidhur me përmbytjet ▪ Përqindja e njerëzve që jetojnë nën kufirin minimal të jetesës. 	Prefektura Drejtoria përkatëse në bashki	Çdo vit	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e sigurisë së jetës dhe përbalimit të rreziqeve nga përmbytjet - Rritja e cilësisë së jetës për komunitetet në zonë. - Rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Rishikimi i masave të parashikuara në plan ✓ Konsultime të shpeshta dhe të rregullta me komunitetet që preken ✓ Ngritje kapacitetesh në nivel hartimi dhe zbatimimi të politikave dhe planeve.
Biodiversiteti					
OM2 Ruajtja dhe, sipas rastit, përmirësimi i llojeve, habitateve dhe biodiversitetit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Statusi i mbrojtjes së habitateve dhe specieve siç kërkohet në legjislacionin përkatës ▪ Numri i habitateve të rëndësishme që janë në kushte të kënaqshme ▪ Statusi i biodiversitetit, në krahasim me BE-në (numri i llojeve endemike dhe të rralla) ▪ Numri dhe madhësia e sipërfaqes natyrore 	Strukturat menaxhuese të zonave të mbrojtura Drejtoritë kompetente të bashkive	Sipas planit të menaxhimit Çdo vit	<ul style="list-style-type: none"> - Ruajtja e statusit të favorshëm të mbrojtjes për të gjitha habitatet dhe llojet e mbrojtura sipas legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar. - Identifikimi në nivel lokal i zonave me biodiversitet të lartë dhe korridoreve ekologjike. 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Rishikimi i planit duke përfshirë objektivat dhe masat në mbështetje të zonave të Natura 2000. ✓ Detyrimi për zbatim i ligjeve dhe rregulloreve përkatëse.
Toka					
OM3 Mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i funksionit dhe cilësisë së tokës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sasia e tokës së degraduar ▪ Ripërdorimi i strukturave, që është parimi më themelor i ruajtjes së tokës në zonat urbane. ▪ Sasitë e mbetjeve të prodhuara, grumbulluara dhe asgjësuara në venddepozitime 	Autoritetet kompetente të qarkut/bashkisë Strukturat menaxhuese të venddepozitimeve	Çdo vit	<ul style="list-style-type: none"> - Përqendrimi i zhvillimit (zbatimit të masave) në zonat e përcaktuara dhe inkurajimi i ripërdorimit të zonave ku aktualisht janë kryer ndërhyrje 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Rishikimi i planit (masave), sipas nevojës ✓ Detyrimi për zbatim të rregulloreve, aty ku është e nevojshme
Uji					
OM4 Parandalimi i përkeqësimit, mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i mjedisit ujor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësorë ▪ Monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësorë ▪ Përdorimi i ujit sipas sektorit ▪ Përqindja e popullsisë së lidhur me impiantet e trajtimit të ujërave të përdorura (ITUP) 	Drejtoritë kompetente të bashkive Organet menaxhuese të ITUP-eve MTM	Kampionimi dhe matjet në përputhje me kushtet mjedisore të çdo ITUP. Sistemi kombëtar i monitorimit të cilësisë së ujërave	<ul style="list-style-type: none"> - Mbrojtja dhe restaurimi i zonave të identifikuar në Planin e Menaxhimit të Basenit Drin-Bunë, që kërkohen për të arritur statusin "mirë" për cilësinë e ujit në përputhje me objektivat e SKMIBU dhe Direktivës Kuadër të Ujit. - Të mos ketë përkeqësim të niveleve të përputhshmërisë me standardet e 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Rritje e shpeshtësisë së monitorimit, sipas nevojës. ✓ Përmirësimi i ITUP dhe monitorimi i vazhdueshëm mbi plotësimin e kushteve të licencës lidhur me

Plani i Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet - Qarku Shkodër

				cilësisë së ujit të pijshëm.	shkarkimet prej tyre
Faktorët klimatikë					
OM5 Kontribut në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri i strukturave/ndërtesave të përmirësuara në kuadër të përshtatshmerisë ndaj ndryshimeve klimatike. ▪ Adoptimi i teknologjive të rinovueshme 	Drejtoritë kompetente të bashkive MTM	Në vijim	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e numrit të strukturave / ndërtesave të përmirësuara në kuadër të përshtatshmerisë ndaj ndryshimeve klimatike. - Shtimi dhe përmirësimi i mjeteve dhe mënyrave të prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme. 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Plotësimi me rigorozitet i kërkesave specifike ✓ Rishikimi i planit sipas nevojës
Asetet Materiale					
OM6 Kontribut në mbrojtjen e pronës dhe infrastrukturës OM7 Reduktim i konsumit të burimeve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri i aseteve (publike, private, infrastrukturore) të mbrojtura nga rreziku i përmbytjeve. ▪ Vlerësimi i sasisë dhe cilësisë së burimeve të përdorura për zbatimin e masave të planit. 	Strukturat përkatëse të qarkut/bashkive	Në vijim	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e numrit të aseteve të mbrojtura nga rreziku i përmbytjeve. - Aplikimi i praktikave inxhinierike / ndërtimore që kërkojnë shfrytëzim minimal të murimeve. 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Modifikimi/rishikimi i planit, sipas nevojës
Trashëgimia Kulturore					
OM8 Mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i karakterit, diversitetit dhe cilësive të veçanta të trashëgimisë kulturore dhe mjedisit historik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri i Monumenteve të listuara në PMRRP dhe zonat me potencial arkeologjik që janë regjistruar ose janë objekt eksplorimi si rezultat i zbatimit të planit. ▪ Numri i monumenteve dhe zonave arkeologjike të dëmtuara për shkak të zbatimit të planit. ▪ Numri dhe statusi i mbrojtjes së strukturave të përfshira në listën e monumenteve të kulturës. ▪ Numri i ndërtesave të konservuara dhe të ripërdorura. ▪ Numri i strukturave të mbrojtura të dëmtuara për shkak të zbatimit të planit. 	Drejtoritë përkatëse në qark/bashki Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore	Në vijim	<ul style="list-style-type: none"> - Ruajtja dhe rritja e numrit të veçorive arkeologjike të regjistruara dhe të mbrojtura. - Mosdëmtimi i strukturave apo monumenteve dhe zonave rreth tyre për shkak të zbatimit të planit. - Rritja e numrit dhe ruajtja e statusit të mbrojtjes për monumentet e kulturës në zonë. 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Çdo dëmtim i monumenteve të kulturës të regjistruara, apo i çdo elementi tjetër të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike, si dhe i zonës rreth tyre, do të konsiderohet si shkelje dhe do të aplikohen sanksionet sipas legjislacionit në fuqi.
Peizazhi					
OM9 Mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i karakterit, diversitetit dhe cilësive të veçanta të peizazheve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Cilësia e mjedisit urban dhe rural 	Drejtoritë kompetente të bashkive	Në vijim	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e cilësisë së mjedisit urban dhe rural. 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Detyrimi për zbatim të parashikimeve në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe planet e tjera zhvillimore për çdo bashki.

Monitorimi i ndikimeve në mjedis për çdo masë të parashikuara në PMRRP do të bëhet sipas programit të monitorimit dhe mund të përfshijë informacione të shprehura në formë tabelore, sipas modelit në tabelën e mëposhtme.

Masa e zbatuar sipas PMRRP-së	Treguesit mjedisorë	Parashikim i ndikimeve kumulative (sipas rastit)	Ndikimi total i planit
Masa 001			
Masa 002			
Masa 003			
Masa...			

11. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

11.1. Përfundime

- ✚ Vlerësimi i efekteve të mundshme në mjedis, i paraqitur në këtë raport, do të mbështesë vendimmarrjen e mëtejshme për prioritetet në nivelin strategjik dhe të planifikimit. Ai nuk zëvendëson ndonjë vlerësim për ndikimet mjedisore nga projekte të detajuara të ardhshme në lidhje me legjislacionin kombëtar ose direktivat Evropiane.
- ✚ Vlerësimi i efekteve mjedisore të mundshme të masave të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet tregon se shumë masa, si p.sh. masa administrative, organizative, informuese nuk do të kenë asnjë efekt të rëndësishëm negativ, madje print efekte pozitive mbi faktorët mjedisorë. Nëse këto masa do të kenë gjithashtu ndikim të konsiderueshëm në reduktimin e rrezikut nga përmbytjet, ato mund të kenë prioritetin për zbatim.
- ✚ Sa i takon rritjes së qëndrueshmërisë ndaj fatkeqësive natyrore, në nivel lokal, vlen të përmendet se qëndrueshmëria në nivel lokal mbetet ende kryesisht e papërcaktuar si një objektivi i politikës në Shqipëri. Koncepti është përfshirë tashmë në legjislacionin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë (Ligji për mbrojtjen civile), prandaj pritet të adresohet edhe në Strategjinë Kombëtare për mbrojtjen civile. Në këtë fazë nuk është e qartë nëse strategjia do të përfshijë gjithashtu objektiva dhe masa që prekin edhe sektorët e tjerë, duke marrë kështu një qasje të integruar ndaj qëndrueshmërisë në nivel lokal.¹⁶
- ✚ Struktura institucionale për qëndrueshmërinë lokale vijon të jetë e fragmentuar, si reflektim i kuadrit ligjor. Ligji për mbrojtjen civile përcakton një sërë institucionesh në nivel kombëtar dhe vendor që kanë përgjegjësinë për t'u marrë me reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe rrjedhimisht edhe qëndrueshmërinë. Megjithatë, arritja e qëndrueshmërisë socio-ekologjike dhe territoriale është një detyrë shumëdimensionale dhe shumësektoriale. Ndërkohë që ende nuk ka përfunduar ngritja e institucioneve vendore të mbrojtjes civile, bazuar në legjislacionin përkatës, edhe sektorët e tjerë publikë duhet të krijojnë struktura që të koordinohen me ato të mbrojtjes civile për të arritur qëndrueshmëri në nivel lokal dhe kombëtar.¹⁷
- ✚ Për masat më teknike dhe konstruktive, që shpesh kanë një efekt të qartë për reduktimin e rrezikut, efektet negative për florën, faunën, biodiversitetin dhe tokën si dhe disa efekte të tjera të vogla mund të shkaktohen nga masat për parandalimin e përmbytjeve. Në këto raste, kërkohet një analizë dhe vlerësim mjedisor i mëtejshëm gjatë procesit të planifikimit dhe zbatimit të mëtejshëm si pjesë e procedurave të miratimit.
- ✚ Zbatimi i aktiviteteve që lidhen me parandalimin e përmbytjeve vlerësohet se ka një ndikim negativ në periudhë afatshkurtër, për shkak të ndikimeve në ndërtim dhe ndryshimeve në përdorimin e tokës. Në periudhë afatgjatë, ka të ngjarë të ketë ndikime pozitive për shkak të përfitimeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, përfitimit të biodiversitetit, shëndetit të njeriut dhe peizazhit. Këto aktivitete kanë gjithashtu përfitime të mundshme sinergjike nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së ujit, gjë që mbështet edhe arritjen e objektivave të DKU.

¹⁶ Building Resilience for Local Governments in Albania: Legal and Institutional Challenges. DOI: 10.32034/CP-PPRESI-P01-01

¹⁷ Po aty

- ✦ Sa i takon masave që lidhen me mbrojtjen nga përmbytjet (masat strukturore), ndikimet e shkaktuara prej tyre vlerësohen si negative për elementët e biodiversitetit dhe asteve materiale. Masat zbutëse, siç janë praktikatat e mira të punës, metodologjia e miratuar e punës dhe zbatimi i tyre do të minimizojnë ndikimet.
- ✦ Masat që lidhen me gatishmërinë dhe informimin do të kenë një efekt pozitiv në pothuajse të gjitha tematikat e analizuarat të VSM-së. Këto janë të rëndësishme, pasi zbatimi i tyre përfshin edhe angazhimin e strukturave të tjera në nivel qarku apo bashkie, si dhe vetë grupet komunitare.
- ✦ Burimet financiare për mbrojtjen e integruar civile, siç kërkohet nga ligji përkatës, janë të kufizuara në të dy nivelet e qeverisjes, madje edhe më të pakta në nivel vendor. Deri më tani, bashkitë nuk arrijnë të buxhetojnë as fondin e emergjencës të kërkuar me ligj prej 4% të buxhetit të tyre. Për më tepër, mungesa aktuale e dokumenteve kyçe si, vlerësimi i rrezikut dhe cenueshmërisë, strategjitë për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe planet emergjente nuk i lejon bashkitë të planifikojnë fondet për të gjitha fazat e mbrojtjes civile. Prandaj, ato thjesht kufizohen në fondet e emergjencës.¹⁸
- ✦ Për më tepër, meqenëse qëndrueshmëria në nivel lokal nuk është një detyrë specifike e qeverisjes vendore dhe veprimet për të duhet të shpërndahen në funksionet e ndryshme të qeverisjes vendore, bashkitë vështirë se mund të arrijnë ndonjë planifikim financiar dhe gjurmim të shpenzimeve për qëndrueshmërinë lokale. Kjo mund të nënkuptojë se: 1) nëse do të bëhej një analizë e plotë e veprimeve të elasticitetit të zbatuara gjatë ofrimit të shërbimeve vendore dhe do të gjurmoheshin shpenzimet përkatëse, me shumë mundësi shpenzimet e elasticitetit do të ishin më të larta se sa janë konceptuar aktualisht; 2) planifikimi ndërsektorial për qëndrueshmërinë lokale do të zbulonte se bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet sektorëve çon në disa veprime të thjeshta që garantojnë qëndrueshmëri dhe efikasitet financiar brenda buxheteve aktuale.¹⁹
- ✦ Ndryshimet klimatike ndikojnë në ndryshimet e regjimeve të lumenjve. Infrastruktura e re që parashikohet të instalohet duhet të marrë parasysh regjimet e ndryshuara klimatike të parashikuara.
- ✦ Duke iu referuar planit të veprimit dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, duhet të përgatiten studime nga ekspertët (studime lidhur me cenueshmërinë sipas sektorëve dhe bashkive).
- ✦ Së fundi, njohuritë lokale mbi rreziqet natyrore, rreziqet nga fatkeqësitë dhe cenueshmërinë lokale janë të kufizuara. Prandaj, ekspertët vendas me njohuri historike të territoreve kanë mjaft informacione të cilat nuk janë të organizuara në baza të veçanta të dhënash dhe transferohen verbalisht tek ekspertët më të rinj. Në disa raste, bashkitë kanë raporte të ekspertëve të dorëzuara gjatë zbatimit të projekteve të mbështetura nga donatorët. Institucionet kombëtare që monitorojnë dhe kryejnë studime për klimën, hidrologjinë, gjeologjinë, ngjarjet sizmike etj. kanë bazat e tyre të të dhënave të cilat nuk janë lehtësisht dhe në kohë reale të aksesueshme për bashkitë. Për më tepër, këto baza të të dhënave nuk janë të gjitha të përditësuara dhe mikro-të dhënat nuk ofrohen për të gjithë territorin.²⁰

¹⁸ Building Resilience for Local Governments in Albania: Legal and Institutional Challenges. DOI: 10.32034/CP-PPRESI-P01-01

¹⁹ Po aty

²⁰ Po aty

11.2. Rekomandime specifike sipas sektorëve mjedisorë të VSM

11.2.1. Popullsia dhe shëndeti i njeriut

- Në nivel lokal, masat e propozuara për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet do të duhet të zbatohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës dhe VNMS-ve përkatëse.
- Gjatë projektimit për zbatim të masave të propozuara, rekomandohet të merren parasysh të dhënat lokale për popullsinë dhe indekset e privimit. Kjo do të ndihmojë në harmonizimin e prioriteteve për zonat në rrezik më të lartë nga përmbytjet dhe komunitetet e grupet sociale më të cenueshme.
- Këshillohet që alokimi i fondeve të reja dhe financimi për menaxhimin e rrezikut të ruajë një nivel prioritizimi lidhur me financimin për menaxhimin e rrezikut në zonat me rrezik të lartë. Kjo duhet të pasqyrohet në planifikimet përkatëse buxhetore në të gjitha nivelet.
- Në zhvillimin e studimeve për përmbytjet dhe projektimin e masave dhe punimeve përkatëse, duhet të merren parasysh mundësitë për përfitime rekreative dhe përmirësimin e aksesit në mjedisin natyror dhe hapësirën e gjelbër, kjo për të përmirësuar cilësinë e jetës. Masat duhet të synojnë të mbështesin propozimet lokale të rigjenerimit dhe të synojnë ofrimin e mundësive drejt komuniteteve më të pafavorizuara.
- Rekomandohet që t'i kushtohet më shumë rëndësi rolit përfitues nga mjedisi natyror në zonat urbane. Kjo mund të përfshijë, për shembull, zgjerimin dhe përmirësimin e rrjeteve të infrastrukturës së gjelbër dhe aplikimin e sistemeve të qëndrueshme të kullimit që përdorin hapësirën e gjelbër.
- Për të siguruar që të gjithë grupet e komunitetit të angazhohen në një mënyrë gjithëpërfshirëse, mund të nevojiten mbështetje dhe veprime shtesë në nivel lokal për ta lehtësuar këtë, ndërkohë që kjo mbështetje e këto veprime duhet të përshtaten sipas kontekstit specifik.
- Ekziston mundësia që autoritetet mjedisore në nivel qendror, rajonal dhe lokal të ndajnë dhe të shpërndajnë praktikën e mira përkatëse. Kjo mund të përfshijë nxitjen e angazhimit gjithëpërfshirës dhe aplikimin e elementëve të barazisë në planifikimin, hartimin dhe ofrimin e zgjidhjeve për menaxhimin e rrezikut.

11.2.2. Biodiversiteti

- Efektet e mundshme negative mund të zbuten përmes identifikimit të ndikimit, projektimit të përshtatshëm grafik të zbatimit të masave kundër përmbytjeve, me qëllim për të shmangur ose minimizuar efektet në habitatet dhe kafshët e egra; shoqëruar këto edhe me konsultimin me organizatat përkatëse.
- Në nivel lokal, masat e propozuara lidhur me menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet do të duhet gjithashtu të jenë në përputhje me kërkesat e parashikuara në VNMS-të përkatëse. Ky proces vlerësimi do të ndihmojë në identifikimin e mënyrave për të shmangur, reduktuar ose zbutur ose kompensuar çdo efekt negativ të identifikuar.
- Detajimi dhe hartimi i projekteve të zbatimit për masat e propozuara duhet të përfshijë mjete që kanë potencialin për të sjellë përfitime për biodiversitetin. Kjo përfshin elementë të

adoptimit/elasticitetit që lidhen me proceset natyrore, përdorin përafrimin e menaxhimit të përmbytjeve natyrore dhe adoptojnë menaxhimin e qëndrueshëm të tokës. Në nivel rajonal/lokal zhvillimi i tyre i mëtejshëm duhet të përfshijë edhe autoritetet mjedisore rajonale/lokale.

- Këshillat dhe mbështetja praktike për një përafrim adoptues në plan duhet të promovojnë mjetet që kanë potencialin për të sjellë përfitime për biodiversitetin. Gjithashtu, duhet që këshilla të ngjashme të përfshihen edhe në planet e sektorëve të tjerë (bujqësi, pylltari, etj.) që lidhen me menaxhimin e rrezikut të përmbytjeve, në mënyrë sigurohet vlerësimi i financimit, zhvillimi i qëndrueshëm dhe planifikimi.
- Në trajtimin e mënyrave të reja të financimit të aktiviteteve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, rekomandohet që kërkesa për të demonstruar një fitim neto për biodiversitetin të përfshihet si pjesë e procedurave të aplikimit për fonde, dhe të sigurimit.
- Për të ndihmuar në arritjen e një përfitimi neto në biodiversitet, rekomandohet që elementët e biodiversitetit të përfshihen në trajnime në të ardhmen dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional, si dhe në bashkëveprimin me komunitetet. Gjithashtu duhet të merren parasysh në zhvillimin e aftësive praktike dhe burimeve në të gjithë sektorin. Kjo përfshin edhe këshillimin me ekspertë të fushës, si biologë të specializuar në ekologjinë e ujërave të ëmbla dhe detare dhe ekspertë të peshkimit.
- Duhet të shtohet një masë e re për rinatyalizimin e lumenjve dhe rrjedhave ujore për t'i rikthyer në gjendjen e tyre natyrore, aty ku ndërhyrjet aktuale në lumenj dhe zona bregore janë të vjetra, të panevojshme ose që sjellin shkatërrim të mëtejshëm. Ajo duhet të parashikojë edhe një mekanizëm për marrjen/blerjen e zonave bregore për të mundësuar zona natyrore të përmbytjeve dhe për të ndryshuar politikën lidhur me mbrojtjen e zonave bregore, duke bërë kështu të mundur që lumenjtë të transportojnë sedimentet në mënyrë natyrore.

11.2.3. Toka

- Modelimi i proceseve natyrore mund të ndihmojë në parashikimin dhe zbutjen më të mirë të efekteve të mundshme negative në tokë. Kjo duhet të merret parasysh gjatë studimeve të përmbytjeve dhe në projektimin e zbatimit të masave të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.
- Projektimi dhe detajimi i mëtejshëm i masave të propozuara duhet të përfshijë marrjen në konsideratë të ndërveprimeve të mundshme që lidhen me mbrojtjen dhe ruajtjen e tokës. Rekomandohet gjithashtu përfshirja e organizatave kombëtare dhe rajonale/lokale të fermerëve.
- Këshillat dhe mbështetja praktike për një përafrim adoptues në plan duhet të promovojnë mjetet që kanë potencialin për të sjellë përfitime për tokën. Gjithashtu, duhet që këshilla të ngjashme të përfshihen edhe në planet e sektorëve të tjerë (bujqësi, pylltari, etj.) që lidhen me menaxhimin e rrezikut të përmbytjeve, në mënyrë sigurohet vlerësimi i financimit, zhvillimi i qëndrueshëm dhe planifikimi
- Në nivel lokal, forcimi bashkëpunimit brenda një pellgu ujëmbledhës do të lehtësojë identifikimin e prioriteteve për ruajtjen e tokës dhe mënyrën se si mjetet e ndryshme të menaxhimit të rrezikut mund t'i mbështesin më së miri këto prioritete. Gjithashtu

rekomandohet angazhimi që në fazat e para i aktorëve kryesorë të interesit, me qëllim informimin dhe ndihmën në procesin e vendimmarrjes.

- Rekomandohet që plani të përfshijë politika proaktive për zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo do të shërbejë për të nxitur përdorimin efikas të tokës dhe për të reduktuar mbetjet. Kjo gjithashtu duhet të marrë parasysh ekonominë qarkulluese dhe kostot e aseteve. Në të njëjtën mënyrë, rekomandohet që kuadri i prokurimit për infrastrukturën kundër përmbytjeve dhe asaj bregdetare të kërkojë respektimin e praktikave të qëndrueshme të ndërtimit.
- Investimi në aftësimin, trajnimet dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional duhet të përfshijë njohuri se si mjetet e ndryshme të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet mund të sjellin përfitime për një menaxhim të qëndrueshëm të tokës. Autoritetet mjedisore në të gjitha nivelet, përmes rolit të tyre të strategjik duhet të demonstrojnë gjithashtu se si mund të projektohet dhe zbatohet infrastruktura për të reduktuar mbetjet dhe për të maksimizuar efikasitetin e burimeve.

11.2.4. Uji

- Efektet e mundshme negative në mjedisin ujor mund të zbuten duke kuptuar efektet në proceset fizike, duke përfshirë rrjedhat ujore dhe erozionin në zonat bregore lumore dhe bregdetare; minimizuar humbjen e habitatit; dhe krijuar habitate përmes zbatimit të masave të propozuara. Efektet negative duhet të adresohen gjatë studimeve të përmbytjeve dhe projektimit të masave përkatëse.
- Këshillat dhe mbështetja praktike për një përafrim adoptues në plan duhet të promovojnë mjetet që kanë potencialin për të sjellë përfitime për burimet ujore. Gjithashtu, duhet që këshilla të ngjashme të përfshihen edhe në planet e sektorëve të tjerë (bujqësi, pylltari, etj.) që lidhen me menaxhimin e rrezikut të përmbytjeve, në mënyrë sigurohet vlerësimi i financimit, zhvillimi i qëndrueshëm dhe planifikimi. Rekomandohet që këshillat të përfshijnë mënyrën se si masat dhe vlerësimet e tyre të marrin parasysh dispozitat dhe konsideratat e legjislacionit për menaxhimin e burimeve ujore.
- Dispozitat rregullatore ekzistuese kërkojnë kryerjen e vlerësimit të burimeve ujore për të siguruar përputhshmërinë me objektivat përkatës kur kjo është e mundur. Rekomandohet që shembujt e praktikave të mira në vlerësimet e DKU-së të shpërndahen gjerësisht tek të gjithë aktorët e përfshirë në aktivitetet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.
- Rekomandohet që t'i kushtohet më shumë rëndësi rolit përfitues nga mjedisi natyror në zonat urbane. Kjo mund të përfshijë, për shembull, zgjerimin dhe përmirësimin e rrjeteve të infrastrukturës së gjelbër dhe aplikimin e sistemeve të qëndrueshme të kullimit që përdorin hapësirën e gjelbër.
- Kriteret për të demonstruar ofrimin e përfitimeve mjedisore duhet të mbështesin çdo mënyrë që lidhet me alokimin e fondeve dhe financimin e aktiviteteve për menaxhimin e rrezikut.
- Investimi në aftësimin, trajnimet dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional duhet të përfshijë njohuri se si mjetet e ndryshme të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet mund të sjellin përfitime për cilësinë e ujit dhe burimet ujore. Gjithashtu, këshillohet që aktivitetet e angazhimit në nivel lokal të marrin në konsideratë edhe menaxhimin e burimeve ujore.

- Masat që mund të ndikojnë në mjedisin e ujërave të ëmbla (siç janë masat për mbledhjen e ujërave të përmbytjeve), të cilat synojnë mbrojtjen e mjedisit ujor, rregullohen sipas kuadrit ligjor përkatës dhe zbutja konsiderohet si pjesë e procesit të vlerësimit. Disa masa, veçanërisht ato që konsiderohen si zhvillim, rregullohen sipas sistemit të planifikimit të përdorimit të tokës; dhe efektet mjedisore do të adresohen përmes VNMS-ve në nivel projekti specifik.

11.2.5. Faktorët klimatikë

- Masat e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet duhet të projektohen/detajohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh ndikimet afatgjata të ndryshimeve klimatike.
- Rekomandohet të shtohet një masë e re që lidhet me inkurajimin e zbatimit të PMRRP për të arritur qasje me karbon të ulët ose zero. Kjo do të shërbente për të zyrtarizuar dhe për t'i dhënë efekt njërit prej parimeve që përdoret në proceset zhvillimore në ditët e sotme, aspirimit për të qenë neutral ndaj karbonit.
- Këshillat dhe mbështetja praktike për një përafrim adoptues në plan duhet të promovojnë mjetet që ndihmojnë për të adresuar përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo përfshin lidhjen me proceset natyrore, zgjerimin e menaxhimit të përmbytjeve natyrore, menaxhimin e tokës dhe krijimin e habitatit. Gjithashtu, duhet që këshilla të ngjashme të përfshihen edhe në planet e sektorëve të tjerë (bujqësi, pylltari, etj.) që lidhen me menaxhimin e rrezikut të përmbytjeve, në mënyrë sigurohet vlerësimi i financimit, zhvillimi i qëndrueshëm dhe planifikimi. Gjithashtu rekomandohet që marrja në konsideratë e emetimeve të karbonit të përfshihet edhe në procese të tjera. Kjo përfshin vlerësimin mjedisor të projekteve në nivel lokal si dhe procedurat e sigurimit.
- Këshillohet që burimet e reja të financimit për menaxhimin e rrezikut të jenë plotësisht të informuara dhe të bazuara në standarde të qëndrueshme për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
- Gjatë projektimit/detajimit të masave të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet duhet të shmangen ato zgjidhje inxhinierike të cilat mund të ndikojnë negativisht në emetimet e gazeve serrë dhe të minimizohet përdorimi i burimeve të energjisë jo të rinovueshme në proceset e ndërtimit dhe mirëmbajtjes.
- Investimi në aftësimin, trajnimet dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional duhet të përfshijë njohuri se si mjetet e ndryshme të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet mund të sjellin zgjidhje me karbon të ulët ose zero. Gjithashtu, këshillohet që aktivitetet e angazhimit në nivel lokal të marrin në konsideratë edhe adoptimin ndaj ndryshimeve klimatike.

11.2.6. Asetet materiale

- Gjatë detajimit të masave të propozuara për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet duhet të shqyrtohen mundësitë për të minimizuar gjenerimin e mbetjeve dhe përdorimin e burimeve.
- Zhvillimi/detajimi i mëtejshëm i masave të propozuara duhet të marrë në konsideratë implikimet e mundshme në tokën bujqësore. Bashkëpunimi me aktorët kryesorë, siç janë fermerët në zonë, mund të ndihmojë në arritjen e një komunikimi më të gjerë me sektorin e bujqësisë.

- Rekomandohet gjithashtu angazhimi i hershëm me komunitetin bujqësor. Kjo do të ndihmojë për të përshtatur mbështetjen dhe për të maksimizuar mundësitë e ofruara duke forcuar lidhjen midis praktikave të menaxhimit të tokës dhe atyre të menaxhimit të rrezikut.
- Këshillohet që alokimi i fondeve të reja dhe financimi për menaxhimin e rrezikut të ruajë një nivel prioritizimi lidhur me financimin për menaxhimin e rrezikut në zonat me rrezik të lartë. Kjo duhet të pasqyrohet në planifikimet përkatëse buxhetore në të gjitha nivelet.

11.2.7. Trashëgimia kulturore

- Efektet e mundshme negative në trashëgiminë kulturore mund të zbuten përmes identifikimit të çdo elementi të trashëgimisë (përfshirë arkeologjinë) dhe vlerësimit të tyre që në fazat e para të detajimit dhe zbatimit të masave të propozuara për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet.
- VNMS-të individuale për secilën nga masat e propozuara (kur është e përshtatshme) do të ofrojnë kërkesa specifike për vlerësimin e trashëgimisë kulturore. Ky proces do të ndihmojë në identifikimin e mënyrave për të shmangur, reduktuar ose zbutur çdo efekt negativ të identifikuar.
- Do të ishte e dobishme të qartësohej shkalla e ofrimit të përfitimit neto mjedisor, që mund të përfshijë aspektin historik/kulturor. Kjo duhet të theksohet në plan. Gjithashtu, kjo do të ndihmonte që zbatimi i masave dhe arritja e objektivave të planit të reflektojnë të gjitha aspektet përkatëse mjedisore dhe të qëndrueshmërisë.
- Kriteret për të demonstruar ofrimin e përfitimeve mjedisore duhet të mbështesin çdo mënyrë që lidhet me alokimin e fondeve dhe financimin e aktiviteteve për menaxhimin e rrezikut.
- Përfshirja e kërkesave për masat e mbrojtjes nga përmbytjet në standardet e ndërtesave dhe materialeve ndërtimore, duhet të marrë parasysh edhe ndjeshmërinë e ndërtesave historike.
- Angazhimi në nivel lokal duhet të përfshijë aktorët kryesorë të interesit, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel rajonal/lokal. Kjo do të ofronte mundësinë për të përdorur një sërë të dhënash të disponueshme për mjedisin historic, gjë që informon dhe ndihmon në vendimmarrje. Kjo përfshin të dhëna edhe për karakterin e peizazhit historik dhe atij urban.
- Masat mund të përmirësohen duke përfshirë njohjen e qartë të rolit të aktorëve të interesit, lidhur me mbështetjen dhe kontributin për reagimin dhe rikuperimin e çdo incidenti.
- Rekomandohet që elementët e trashëgimisë kulturore të përfshihen në trajnime në të ardhmen dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional, si dhe në bashkëveprimin me komunitetet. Gjithashtu duhet të merren parasysh në zhvillimin e aftësive praktike dhe burimeve në të gjithë sektorin. Kjo përfshin edhe këshillimin me ekspertë të fushës si arkeologë dhe specialistë të trashëgimisë kulturore.

11.2.8. Peizazhi

- Efektet e mundshme negative në peizazh duhet të adresohen gjatë detajimit/projektit të zbatimit të masave të propozuara për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet.

- Rekomandohet konsultimi me autoritetet mjedisore dhe komunitetet e prekura.
- VNMS-të individuale për secilën nga masat e propozuara (kur është e përshtatshme) do të ofrojnë kërkesa specifike për vlerësimin e peizazhit. Ky proces do të ndihmojë në identifikimin e mënyrave për të shmangur, reduktuar ose zbutur çdo efekt negativ të identifikuar.
- Mundësitë për përmirësimin e peizazhit lokal dhe hapësirave publike duhet të merren parasysh duke përfshirë zgjerimin e infrastrukturës së rrjetit të gjelbër, aty ku është e përshtatshme. Masat që lidhen me fushat lymore/ujëmbledhëse duhet të identifikojnë edhe mundësitë e përmirësimit të peizazhit.
- Do të ishte e dobishme të qartësohej shkalla e ofrimit të përfitimit neto mjedisor, që mund të përfshijë përfitime edhe për peizazhet urbane dhe rurale. Kjo do të ndihmonte që zbatimi i masave dhe arritja e objektivave të planit të reflektojnë të gjitha aspektet përkatëse mjedisore dhe të qëndrueshmërisë.
- Rekomandohet që t'i kushtohet më shumë rëndësi kontekstit urbane dhe mënyrës sesi karakteri i peizazhit mund të përmirësohet nëpërmjet mënyrave që, gjithashtu ndihmojnë në uljen e rrezikut nga përmbytjet. Kjo mund të përfshijë, për shembull, përmirësimin e rrjeteve të infrastrukturës së gjelbër dhe futjen e sistemeve të qëndrueshme të kullimit që përdorin hapësirën e gjelbër.
- Rekomandohet që elementët e peizazhit të përfshihen në trajnime në të ardhmen dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional, si dhe në bashkëveprimin me komunitetet. Gjithashtu duhet të merren parasysh në zhvillimin e aftësive praktike dhe burimeve në të gjithë sektorin. Kjo përfshin edhe këshillimin me ekspertë të fushës si arkitektë dhe projektues të peizazhit.

12. BIBLIOGRAFIA DHE REFERENCAT

Kuadri legjislativ

- Ligji nr. 111, i vitit 2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"
- Ligji nr.73 / 2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"
- Ligji nr.8906, datë: 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura"
- Ligji nr.9734, datë: 14.05.2007 "Për turizmin"
- Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit"
- Ligji nr. 91/2013, datë 28.2.2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor"
- Ligji nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"
- Ligji nr. 11/2015 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen shumëpalëshe ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore për zbatimin e konventës "Për vlerësimin e ndikimit mjedisor në kontekst ndërkuftar"
- VKM nr. 247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore"
- VKM nr. 598, datë 01.07.2015 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkuftar"
- VKM nr. 620, datë 07.07.2015 "Për miratimin e rregullave, përgjegjëse dhe proceduarve të detajuara për vlerësimin strategjik mjedisor në kontekstin ndërkuftar"
- VKM nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjëse e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore"
- VKM nr. 507, datë 10.06.2015, "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor"
- VKM nr. 219, datë 11.03.2015 "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor".
- VKM Nr. 849, datë 4.11.2020 "Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujqor Drin-Bunë"

Direktivat e BE-së

- Direktiva 2000/60/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 23 Tetor 2000 "Për krijimin e një kuadri ligjor për veprimet komunitare në fushën e politikës së ujërave"
- Vendimi i Komisionit nr. 2010/2/BE "Për përcaktimin e një liste të sektorëve dhe nënsektorëve të cilët mendohet të jenë të ekspozuar ndaj një risku të konsiderueshëm të rrjedhjes së karbonit";
- Vendimi i Këshillit 2002/358/KE "Për miratimin, në emër të Komunitetit Evropian, të Protokollit të Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe përmbushjen e përbashkët të angazhimeve në përputhje me to";
- Direktiva e Këshillit 85/337/KE "Për vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private në mjedis";
- Direktiva 1999/94/KE "Për disponueshmërinë e informacionit të konsumatorit mbi ekonominë e lëndës djegëse dhe emetimet e CO2 në lidhje me tregtimin e makinave të reja të pasagjerëve";
- Direktiva 2000/53/KE "Për automjetet në fund të jetës"
- Direktiva 2000/60/KE "Për ngritjen e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave";
- Direktiva 2001/42/KE "Për vlerësimin e pasojave mjedisore të planeve dhe programeve të caktuara";

- Direktiva 2001/81/KE "Për tavanet kombëtare të shkarkimeve për disa ndotës atmosferikë";
- Direktiva 2002/96/KE dhe Direktiva 2012/19/BE "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike";
- Direktiva 2003/35/KE "Për garantimin e pjesëmarrjes së publikut në hartimin e planeve dhe programeve të caktuara lidhur me mjedisin dhe që ndryshon direktivat 85/337/KEE dhe 96/61/KE për sa i përket pjesëmarrjes së publikut dhe aksesit në drejtësi";
- Direktiva 2003/4/KE "Për aksesin e publikut në informacionin mjedisor";
- Direktiva 2003/87/KE "Për krijimin e një skeme për tregtinë e lejeve për shkarkimet e gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit dhe që ndryshon Direktivën e Këshillit 96/61/KE";
- Direktiva 2004/101/KE "Për krijimin e një skeme për tregtinë e lejeve për shkarkimet e gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit në zbatim të mekanizmave të Protokollit të Kiotos";
- Direktiva 2004/35/KE "Për përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin";
- Direktiva 2005/55/KE "Për përfrimin e legjislacionit të vendeve anëtare në lidhje me masat që do të ndërmerren kundër shkarkimeve të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje me kompresion dhe motorët me ndezje pozitive që djegin gaz natyral apo të lëngshëm për përdorim në automjete";
- Direktiva 2006/118/KE "Për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe degradimi";
- Direktiva 2006/21/KE "Për menaxhimin e mbetjeve nga industria e nxjerrjes";
- Direktiva 2006/66/KE "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre";
- Direktiva 2006/7/KE "Për menaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes";
- Direktiva 2007/60/KE "Për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet";
- Direktiva 2008/50/KE "Për cilësinë e ajrit në mjedis dhe një ajër më të pastër në Evropë";
- Direktiva 2008/98/KE "Për mbetjet";
- Direktiva 2009/147/KE "Për ruajtjen e shpendëve të egra";
- Direktiva 2009/29/KE "Për ndryshimin e Direktivës 2003/87/KE në mënyrë që të përmirësojë dhe zgjerojë skemën tregtare të kompensimit të njërive të lejuara të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të Komunitetit";
- Direktiva 92/43/KE "Për ruajtjen e habitateve natyrore, të florës dhe faunës së egër";
- Direktiva 98/83/KE "Për cilësinë e ujit të pijshëm";

Konventat ndërkombëtare:

- Konventa CITES (1975): Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër
- Konventa e Aarhusit (Konventa mbi të Drejtën për Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe të Drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës për Çështjet Mjedisore) (1998)
- Konventa e Barcelonës (1976); Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Zonës Bregdetare të Detit Mesdhe
- Konventa e Bernës (1976): Ruajtja e Faunës së Egër dhe Mjedisit Natyror Evropian
- Konventa për Diversitetin Biologjik (1992)
- Konventa e Bonit (1979); Konventa për Ruajtjen e Llojeve Shtegtare të Kafshëve të Egra
- Konventa e ESPOOS (1991): Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar së bashku me Amendimet dhe Protokollat
- Konventa e Ramsarit për Ligatinat (1971)
- Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK)
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore

Literatura teknike:

- Bogdani, M (2006) Risk assessment from flooding in the rivers of Albania - Proceedings of Balwois conference 2006
- Building Resilience for Local Governments in Albania: Legal and Institutional Challenges. DOI: 10.32034/CP-PPRESI-P01-01
- Dhora Dh, 2005, Liqeni Shkodres dhe Libri kuq I Faunes Shqiptare
- Guidat e CIS janë publikuar në http://ec.europ.eu/environment/water/flood_risk.implem.htm
- http://iktk.gov.al/site/wp-content/uploads/2020/10/Monumentet-_Qarku-Shkoder.pdf
- <http://geoportal.asig.gov.al>
- <http://www.epa.gov/igateway/whatIndicator.html>
- INFRASTRUKTUR & UMWELT, projekti i BE STRIMA 2014, i ndryshuar
- INSTAT Censusi 2011
- Komunikimi i Tretë Kombëtar i Republikës së Shqipërisë për Ndryshimet Klimatike, 2016
- LEAP i Velipojës – REC, 2006
- LWI (2014) Institute for Water Management IfW GmbH, Braunschweig, Germany, in cooperation with Leichtweiss Institute for Hydraulic Engineering and Water Resources, University of Braunschweig, Germany: Development and Application of a (Rough) Hydrological Model for the Drin/Drim – Buna/Bojana Basin; on behalf of GIZ, draft September 2014
- Mott MacDonald (2011) Inception report for the post-disaster comprehensive flood risk assessment and management study
- Mott MacDonald (2012a) Final Report of the post-disaster comprehensive flood risk assessment and management study
- Mott MacDonald (2012b) Phase 2 report / of the post-disaster comprehensive flood risk assessment and management study
- Mott MacDonald (2019). Drini-Buna Final River Basin Management Plan. Tirana (Albania): Ministry of Agriculture and Rural Development.
- Plani i Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet, Qarku Shkodër
- Plan veprimi i vitit 2017 për shërbimet e kanaleve kulluese në Bashkinë Shkodër: http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/plan_veprimi_per_sherbimin_e_kullimit_1373.pdf
- PPV për Bashkinë Shkodër për periudhën kohore 2015-2030
- PPV për Bashkinë Vau i Dejës për periudhën kohore 2015-2030
- REC (2013) Regional Environmental Center Albania - Rapid Assessment Report: "Identification of municipalities / communes in need of support for flood risk management and drought risk management in Albania and Kosovo."
- Schwarz, U. (2009) Rapid Assessment of proposed Hydropower Plants on Drin River near Ashta (south of Shkodër)
- Sustainability 2020, 12, 4039; doi:10.3390/su12104039
- VSM e PPV, Bashkia Shkodër
- VSM e PPV Bashkia Vau i Dejës

13. SHTOJCAT

- Shtojca 1 – Kuadri Institucional për Menaxhimin e Basenit Ujor Drin-Bunë
- Shtojca 2 – Konsultimet ndërkufitare: Praktika e Bashkeveprimit Ndërkufitar sipas Konventës ESPOO

13.1. Shtojca 1 – Kuadri Institucional për Menaxhimin e Basenit Ujor Drin-Bunë²¹

(ekstraktuar nga VKM Nr. 849, datë 4.11.2020)

2.5. Kuadri Institucional

Strukturat e administrimit dhe menaxhimit të ujërave janë të disponueshme në nivel kombëtar dhe vendor. Figura 2.1 përshkruan marrëdhënien aktuale ndërmjet ministrive dhe agjencive vendore²². Në nivel kombëtar, Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) është organi ekzekutiv qendror. Duke qenë se Shqipëria është një vend kandidat për pranimin në BE, ajo ka nevojë t'i përfaqësojë përputhshmërisë me një numër të konsiderueshëm të direktivave të BE-së që lidhen me menaxhimin e ujërave. Vendi ndahet në gjashtë basene ujore, ku secili ka një Këshill të Basenit Ujor (KBU) dhe një Zyrë të Administrimit të Basenit Ujor. Kjo strukturë është e favorshme në parim për të neutralizuar fragmentimin e menaxhimit të burimeve ujore dhe për të promovuar një administrim efektiv në nivel lokal.

2.5.1. Institucionet e nivelit qendror

Ministria përgjegjëse për ujitjen dhe për kullimin është përgjegjëse për menaxhimin e ujitjes dhe aktivitetet e kullimit dhe kryen detyrat e mëposhtme:

- përcakton politikën kombëtare mbi sistemet e ujitjes dhe kullimit;
- mbikëqyr veprimtarinë dhe aktivitetet e organizatave, dhe bordeve e kullimit nga perspektiva ligjore dhe financiare;
- mbikëqyr aspektet teknike të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit;
- propozon ngritjen e Bordeve të Kullimit;
- autorizon transferimin e sistemeve të ujitjes dhe kanaleve kryesore të ujitjes;
- ndërmerr veprime të nevojshme për të siguruar funksionimin e objekteve dhe digave të mbrojtjes nga përmbytjet si pjesë e sistemeve të ujitjes;
- mban bazën e të dhënave të bordeve të kullimit, komunitetin;
- këshillon dhe udhëzon organizatat, komunitetin dhe bordet e kullimit, duke vepruar gjithmonë në kërkesën e këtij të fundit për çështje ligjore, teknike dhe financiare;
- mbikëqyr përzgjedhjen e administratës së bordeve për organizatat dhe komunitetin;
- kryen auditimin financiar të organizatave, dhe Bordeve të kullimit;
- kryen inspektime të gjendjes teknike dhe fizike të sistemeve të ujitjes, kanaleve kryesore, sistemeve kryesore të kullimit dhe punëve të mbrojtjes nga përmbytjet;
- monitoron cilësinë e ujitjes, ujërave të kullimit dhe tokave.

KKU-ja është ngritur në vitin 1996. Ky është organi ekzekutiv qendror për menaxhimin e burimeve ujore duke ofruar një forum të nivelit të lartë për planifikimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në një mënyrë të integruar. KKU-ja tani siguron pjesën më të madhe të anëtarëve të Grupit për Menaxhimin e Integruar të Politikave për Ujin, ngritur me Urdhër të Këshillit të Ministrave nr. 129, datë 21,09,2015. Vendimi Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 4, i datës 2 dhjetor 2015, ka ngritur katër nëngrupe tematike (respektivisht, uji për njerëzit, për ushqim, për mjedis dhe për industri). Përgjegjësitë e tyre janë përcaktuar, për më tepër sigurimin e fleksibilitetit të nevojshëm për t'ju përgjigjur situatave komplekse në kohë, për veprime efektive. Në parim, ata duhet të takohen dy herë në muaj ose sipas nevojës.

²¹ VKM Nr. 849, datë 4.11.2020 "Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujor Drin-Bunë"

²² Janë përfshirë ndryshimet e fundit të pozicionit në të dyja bordet e kullimit dhe autoritetet e baseneve ujore.

Ligji 111/2012 për “Menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, si dhe ligji nr. 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 111/2012 për “Menaxhimin e integruar të burimeve ujore” krijojnë KKU-në si organ të lartë përgjegjës për përcaktimin e linjave kryesore të politikës dhe vendimmarrjes. Kryeministri kryeson KKU-në, dhe në përputhje me nenin 5(2) të LBU-së, përbërja e tij duhet të përcaktohet nga Këshilli i Ministrave. Anëtarët e KKU-së janë si më poshtë:

- Kryeministri (Kryetari); ose në mungesë të tij zëvendëskryeministri;
- Ministri i Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministri i Financave dhe Ekonomisë;
- Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministri i Mbrojtjes;

Funksionet e KKU-së përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm te:

- përgatitja e propozimeve për draftligjet dhe rregulloret për çdo lloj aktiviteti që lidhet me burimet ujore;
- miratimi i kuadrit ligjor, teknik dhe rregullator për të zbatuar LBU-në, dhe për më tepër draftudhëzimeve, dhe ndërmarrja e masave të tjera të nevojshme për zbatimin e planit kombëtar për burimet ujore;
- miratimi dhe menaxhimi i planeve të Baseneve Ujore;
- lëshimi i lejeve dhe autorizimeve të shkarkimit të ujit dhe shkarkimit të ujërave të zeza kur veprimtaritë përkatëse ndodhin përtej kufijve të një baseni ujqor;
- miratimi i rregullave funksionale për Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshillat e Baseneve Ujore dhe Zyrat e Administrimit të Basenit Ujqor; Miratimi i planeve dhe projekteve ndër-rajonale dhe kombëtare në fushën e bujqësisë, planifikimit urban, zhvillimit industrial dhe territorial me efekte në mbrojtjen dhe menaxhimin e ujërave;
- përcaktimi i kufijve të baseneve ujore dhe krijimi i zyrave për secilin prej tyre, ku do të mbahet Regjistri për Burimet Ujore;
- krijimi i agjencive ose njësive të tjera organizative, nën kontrollin e Këshillit, për të lehtësuar menaxhimin e burimeve ujore dhe zbatimin e ligjit;
- propozimi dhe përshtatja e duhur e masave për zbatimin e marrëveshjeve ose konventave për burimet ujore ku Republika e Shqipërisë është palë nënshkruese; dhe
- miratimi i koncesioneve për burimet ujore sipas dispozitave të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur burimet ujore kanë rëndësi kombëtare, dhënia me koncesion do të hyjë në fuqi vetëm me miratimin e Parlamentit.

KKU-ja mbështetet nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, sipas ligjit 6/2018, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”. Megjithëse fillimisht nën ministrinë përgjegjëse për çështjet mjedisore, funksionet aktuale të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore si organi ekzekutiv i Këshillit Kombëtar të Ujit janë nën varësinë e Kryeministrit. Gjithashtu, zëvendëskryeministri është anëtar i KKU-së dhe kryeson takimin në mungesë të Kryeministrit.

Ndër të tjera, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është përgjegjëse për:

- zbatimin e politikave kombëtare të burimeve ujore të miratuara nga KKU;
- zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare për burimet ndërkufitare të ujit në të cilat Shqipëria është palë;
- zhvillimi i një inventari kombëtar të burimeve ujore, duke përfshirë aspektet e sasisë dhe cilësisë;

- aplikimet e shqyrtimit për përdorimin e ujit dhe shkarkimet e ujërave të ndotura dhe autorizimet që do të lëshohen nga KKU;
- promovimi i pjesëmarrjes së përdoruesve të ujit në menaxhimin e burimeve ujore;
- promovimi i studimeve dhe kërkimeve;
- identifikimin e fushave kërkimore dhe burimet përkatëse të financimit, në koordinim me institucionet kërkimore;
- koordinimin dhe mbikëqyrjen e punës së Këshillave të Baseneve dhe Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor;
- monitorimin e zbatimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujore.

Sipas VKM-ve nr. 91 dhe 92, datë 4.2.2015, përgjegjësia e “Drejtorisë së Politikave të Ujërave” kaloi nga ministria përgjegjëse për mjedisin në varësinë e ministrisë përgjegjëse për burimet ujore dhe ujitjen, menaxhimin e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet.




Figura 13.1: Struktura organizative dhe institucionale për menaxhimin e burimeve ujore

Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e ujësjellës-kanalizimeve përgatit politika dhe strategji për sektorin e furnizimit me ujë dhe për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Këto bazohen mbi programet qeveritare dhe strategjitë sektoriale, planet dhe investimet për ndërtimin dhe rehabilitimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura dhe impiantet e mbetjeve të ngurta. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e ujësjellës-kanalizimeve vlerëson nevojat për subvencione dhe ndjek shpërndarjen e tyre nëpërmjet institucioneve të saj vartëse.

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK) është një institucion që raporton te ministria përgjegjëse për infrastrukturën e ujësjellës-kanalizimeve, duke qenë se është e specializuar në furnizimin me ujë të pijshëm, mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura. AKUK-ja asiston me ndihmë

teknike politikat e ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën e ujësjellës-kanalizimeve, sipas legjislacionit në fuqi dhe politikave të përcaktuara në strategjitë përkatëse sektoriale, përfshirë politikat e menaxhimit të ujit dhe mbrojtjen e cilësisë së ujit, në bashkëpunim me autoritetet e tjera kombëtare në nivel qendror dhe lokal. Brenda strukturës së saj organizative, AKUK-ja përfshin Drejtorinë Teknike, Drejtorinë Ekonomike, Drejtorinë për Projekte të Huaja, Drejtorinë e Monitorimit dhe tri drejtori rajonale.

Ministria përgjegjëse për çështjet e energjisë luan një rol të rëndësishëm në sektorin e ujërave; duke qenë se ajo është përgjegjëse për prodhimin e energjisë hidrike, që përfaqësojnë mbi 97% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike. Ministria është përgjegjëse për miratimin e hidrocentraleve të reja. Ministria mund të ndërhyjë në rritjen e shpërndarjes për të përmirësuar sigurinë e shërbimit dhe për të rritur eksportet e mundshme (BB, 2009a).

Ministria përgjegjëse për çështjet shëndetësore ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor²³. Ndër të tjera, ministria përgjegjëse për çështjet shëndetësore harton, propozon për miratim dhe zbaton akte ligjore dhe nënligjore për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Në zbatim të akteve ligjore në fuqi, ministria përgjegjëse për çështjet shëndetësore kryen monitorimin, inspektimin dhe ekspertizën e cilësisë së ujit të pijshëm nëpërmjet institucioneve në varësi të saj, përkatësisht Strukturave Rajonale të Shëndetit Publik (SRSHP), Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) dhe Institutit të Shëndetit Publik (ISHP).

Ministria përgjegjëse për mbrojtjen civile kryen aktivitetet e saj sipas legjislacionit për parandalimin, reduktimin dhe lehtësimin e efekteve negative të emergjencave civile mbi popullsinë, bagëtinë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin. Ministria ka në përbërje të strukturës së saj Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, që zbaton Planin Kombëtar të Emergjencave Civile, duke marrë parasysh ekspozimin e Shqipërisë ndaj katastrofave natyrore që përfshijnë përmbytjet dhe katastrofat që lidhen me aktivitetin e njeriut. Ministria përgjegjëse për mbrojtjen civile nëpërmjet institucionit të Prefektit koordinon aktivitetin e institucioneve qendrore në nivel vendor dhe funksionet e deleguara me NJQV-të në nivel bashkiak dhe qarku (GoA, 2015b).

Ministria përgjegjëse për financat akordon, bazuar te prioritetet e qeverisë, burime financiare për sektorin e ujërave, duke i dhënë prioritet menaxhimit të duhur të burimeve ujore për përmbushjen e nevojave të shoqërisë. Ministri përgjegjës për financat është anëtar i KKU-së.²⁴

2.5.2. Institutet kombëtare të përfshira në monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së ujërave.

Organizimi i monitorimit të cilësisë së ujërave (burimeve) është i ndërlikuar, me mbi 20 institucione qeveritare të ndryshme të përfshira aktualisht në mbledhjen e të dhënave për një numër të kufizuar parametrash me mbulim gjeografik të pjesshëm.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), nën varësinë e Ministrisë përgjegjëse për çështjet e mjedisit, është përgjegjëse për monitorimin cilësor dhe sasior të burimeve ujore. Ajo mbikëqyr punën e instituteve përkatëse për monitorimin e aktiviteteve dhe është përfituesja kryesore e të dhënave të siguruaruara nëpërmjet institucioneve të mëposhtme:

²³ VKM nr. 940, datë 9.10.2013, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrisë përgjegjëse për çështjet shëndetësore".

²⁴ Sipas nenit 5(2) të LBU-së.

- Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, (ish Instituti Hidrometeorologjik), nën varësinë e ministrisë përgjegjëse për arsimin, monitoron parametrat hidrometeorologjikë dhe është përgjegjës për kryerjen e monitorimit të sasisë së ujërave sipërfaqësorë për lumenjtë dhe liqenet. Rrjeti meteorologjik i IGJEUM-it përbëhet tashmë nga stacione automatike. Të dhënat dhe alarmet hidrologjike (treguesit për rrezikun nga përmbytjet dhe zjarri në pyje) u janë shpërndarë aktorëve dhe janë publikuar online;
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), nën varësinë e ministrisë përgjegjëse për çështjet e energjisë, monitoron cilësinë e ujërave nëntokësorë dhe detarë, vlerëson rrezikun dhe monitorimin e ndotjes së tokës;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), e cila është nën varësinë e ministrisë përgjegjëse për energjinë, përqendrohet në monitorimin e hidrocentraleve;
- Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), qendër e kërkimit shkencor, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare dhe qendër informacioni, në varësi administrative të ministrisë përgjegjëse për shëndetësisë, ndër të tjera është përgjegjës për sigurimin e ekspertizave dhe pjesëmarrjen në formimin e burimeve njerëzore në shëndetin publik²⁵. Mbështet Strukturat Rajonale të Shëndetit Publik me ekspertizë në monitorimin e jashtëm të cilësisë së ujit të pijshëm, survejancën epidemiologjike dhe trajnimin e vazhdueshëm, si dhe Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) me ekspertizë dhe ekzaminime laboratorike. ISHP, në kontratë me AKM kryen vlerësimin mikrobiologjik të cilësisë së ujërave bregdetare të larjes. Ky vlerësim bëhet në bazë të ngarkesës bakteriale të tyre (*Escherichia coli*, *Enterococcus intestinalis*), si dhe inspektimit të mjedisit për vlerësimin e faktorëve të rrezikut që ndikojnë në ndotjen e tyre.
- Enti Rregullator i Ujit është një institucion i pavarur, i krijuar nga Parlamenti. Detyrat kryesore përfshijnë lëshimin e licencave për furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizime, miratimin e tarifave për ujin e pijshëm.

Në vitin 2009, u miratuan rregullat dhe procedurat për Monitorimin Kombëtar Mjedisor nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave (nr. 1189, plotësuar me VKM nr. 267, duke ofruar kuadrin për monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësorë (lumenj, liqene, dhe ujëra detarë të plazheve), nëntokësorë dhe shkarkimeve të ujërave të ndotura VKM nr. 267, datë 7.5.2014 miraton listën e substancave prioritare që monitorohen si pjesë e këtyre përpjekjeve, duke transpozuar direktivën 2008/105/EC mbi standardet e cilësisë së mjedisit.

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor është krijuar në vitin 2013, sipas ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, përgjegjësitë e tij kryesore janë:

- Zbatimi i politikave kombëtare për infrastrukturën informative gjeohapësinore;
- Përgjegjës për projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe azhurnimin e Kornizës Gjeodezike;
- Vendime për grumbullimin, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor nga autoritetet publike, duke përfshirë sektorin e ujit;
- Vendos standarde dhe rregulla uniforme për krijimin e GIS-it për fusha të ndryshme, duke përfshirë sektorin e ujit dhe për krijimin e GIS kombëtar në përputhje me standardet përkatëse evropiane;
- Përgatit rregullat që lidhen me krijimin, përditësimin, ndarjen, qasjen dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor dhe shërbimeve përkatëse;
- Administron informacionin gjeohapësinor të mbledhur, përpunuar dhe përditësuar nga autoritetet publike në fusha të ndryshme;

²⁵ Ligji nr. 10 138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, i ndryshuar.

- Siguron koordinimin e punës, mbështet iniciativat dhe aktivitetet në lidhje me informatat gjeohapësinore në sektorin publik dhe privat;
- Zhvillon dhe administron Geoportalin Kombëtar dhe garanton qasje publike sipas dispozitave të ligjit 72/2012.

2.5.3. Njësitë e qeverisjes vendore, këshillat e baseneve ujore dhe zyrat e administrimit të baseneve ujore

Që prej zgjedhjeve vendore të vitit 2015, organizimi i qeverisjes vendore ka ndryshuar. Përpara hyrjes në fuqi të ligjit për ndarjen e re administrative dhe territoriale (ligji nr. 115/2014), ishte e ndarë në 308 fshatra, 65 bashki dhe 12 qarqe. Reforma administrative dhe territoriale nuk solli ndryshime në nivelin e qarkut duke mos ndryshuar numrin prej 12, por u ndërmorën ndryshime radikale në nivelin e komunave dhe bashkive. Sipas ndarjes së re administrative dhe territoriale janë krijuar 61 bashki të reja. Bashkitë janë njësitë bazë të qeverisjes vendore, duke përfaqësuar kështu nivelin e parë të qeverisjes. Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) janë të organizuara në njësi administrative përbërëse (ish fshatrat) dhe si nën ndarje administrative të bashkive. Nga pikëpamja e planifikimit të territorit, bashkitë do të vijojnë të organizohen në qytete dhe fshatra.

Ndikimi i zhvillimit social dhe ekonomik në nivel rajonal dhe roli i institucioneve rajonale ka qenë i dobët në të shkuarën si pasojë e mungesës së një modeli të qartë për veprimtarinë rajonale, mungesës së burimeve financiare, aseteve dhe kapaciteteve të pamjaftueshme institucionale. Organet e decentralizuara në nivel vendor përfaqësohen nga dy institucione, përkatësisht i. Prefekti; dhe ii. drejtoritë/zyrat rajonale/vendore të ministrive të linjës. Menaxhimi i Ujërave është i organizuar në nivelin e Baseneve Ujore nëpërmjet gjashtë Këshillave të Baseneve Ujore (KBU), ndërsa Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore janë 4 (Vjosë, Shkumbin–Seman, Ishëm–Erzen–Mat, Drin–Bunë).

Secili nga Këshillat e Baseneve Ujore (KBU) kryesohet nga një prej prefektëve përgjegjës dhe është i përbërë nga 29 anëtarë që përfaqësojnë institucione të ndryshme vendore, NJQV-të, bizneset dhe konsumatorët e basenit. (VKM nr. 342, datë 4 Maj 2016; “Për miratimin e kufijve territorialë e hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre”).

Neni 12 i ligjit nr. 111/2012, si dhe ligji nr. 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit 111/2012 për “Menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, theksojnë se çdo KBU duhet të sigurojë:

- Mbrojtje, zhvillim dhe veprimtari të arsyeshme me burimet ujore brenda kufijve të basenit të tij
- Shpërndarje të drejtë brenda kufijve të basenit të tij në përputhje me qëllimin e përdorimit dhe administrimit efikas të tyre;
- Mbrojtje të burimeve ujore nga ndotja, keqpërdorimi dhe mbipërdorimi.

Këshillat e Baseneve Ujore asistohen nga Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore, që funksionojnë si një Agjenci Menaxhimi për KBU-në. Ato janë përgjegjëse për zbatimin e ligjit për Burimet Ujore. Ato ndërmarrin vlerësimin teknik të aplikimeve për përdorimin e ujit (ujëra sipërfaqësorë dhe nëntokësorë) dhe japin rekomandime për miratim nga KBU-të, mbështesin bashkitë për zgjidhjen e problematikave të lidhura me burimet ujore dhe janë përgjegjëse për inspektimin e të gjitha veprimtarive që kanë të bëjnë me përdorimin e burimeve ujore. Megjithatë, Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore kanë autoritet të kufizuar për të zbatuar procedurat ligjore dhe rregullatore.

Pjesëmarrja/përfshirja e përdoruesve përfundimtarë në menaxhimin e burimeve ujore rregullohet nga vendimi nr. 2 i Këshillit Kombëtar të Ujit (KKU), datë 21.6.2006, që shprehet se përfaqësuesit e përdoruesve të ujit përbëjnë 30% të anëtarësisë së KKU-së. Për më tepër, takimet e KBU-së mbahen me dyer të hapura. Në praktikë, publiku i gjerë dhe grupet e vogla të përdoruesve mund të marrin pjesë në mënyrë shumë të kufizuar në proceset formale të menaxhimit të burimeve ujore. Furnizimi me Ujë të Pijshëm është përgjegjësi e 57 ndërmarrjeve të ujësjellësit që veprojnë nën Njësitë e Qeverisjes Vendore (VKM nr. 342, datë 4 maj 2016, “Për miratimin e kufijve territorialë e hidrografike të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre”).

Në vitin 2010²⁶, një vendim i Këshillit të Ministrave ka transferuar pronësinë e 305 rezervuarëve të vegjël bujqësorë te NJQV-të, duke i bërë kështu përgjegjës për funksionimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Dhënia e lejeve dhe zbatueshmëria e legjislacionit mjedisor është përgjegjësi e dymbëdhjetë Agjencive Rajonale Mjedisore (ARM).

Në vitin 2015, u miratua me VKM nr. 1108, datë 30.12.2015, “Për transferimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, personelit dhe asetëve nga Bordet Rajonale të Kullimit”, duke qenë se shërbimet e ujitjes dhe kullimit kishin ende nevojë për përmirësim. Duke i transferuar infrastrukturën e vogla të ujitjes te bashkitë dhe fshatrat, do të përmirësohet vendimmarrja lidhur me sistemet e ujitjes dhe kullimit.

Meqenëse vetëm infrastrukturën kryesore të ujitjes dhe kullimit dhe digat menaxhohen tashmë nga ministria përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin, bashkitë do të bashkëpunojnë dhe do të bashkërendojnë me strukturat rajonale të kësaj ministrie përgjegjëse dhe BRK-të, aktivitetet planifikuese për kërkesën vjetore për ujë për ujitje, përdorimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit²⁷. Organizimi i sotëm institucional për ujitjen dhe menaxhimin e kullimit përfshin fshatrat/bashkitë si një lidhje e rëndësishme, që sjell si rezultat tri nivele menaxhimi:

- Qeverisjen qendrore, ministria përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin dhe Bordet e Kullimit kanë kompetencat më të larta të nivelit të administrimit mbi asetet parësore dhe digat;
- Bashkitë si një nivel i ndërmjetëm administrimi për asetet dytësore dhe tretësore; dhe
- Organizatat e përdoruesve të ujitjes dhe bashkimet e tyre si niveli më i ulët i administrimit.

Lidhja e ndërmjetme midis qeverisë qendrore dhe strukturave të saj vendore nga njëra anë, dhe SHPU-ve/OPU-ve nga ana tjetër, është përmirësuar, gjë e cila mungonte nga reforma e mëparshme bujqësore. Bordet e Kullimit dhe njësitë e reja të qeverisjes vendore dhe bashkitë do të punojnë në partneritet me SHPU-të për të përmirësuar kapacitetet vendore.


²⁶ Nr. 567, datë 14.7.2010, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

²⁷ Strategjia Kombëtare Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015–2020.

13.2. Shtojca 2 – Konsultimet ndërkufitare: Praktika e Bashkeveprimit Ndërkufitar sipas Konventës ESPOO

Konventa kërkon që të ndiqen një sërë hapash procedural, siç përshkruhet në nenet 3, 4, 5, 6 dhe 7 të saj dhe ilustruar në grafikun me poshtë:

Grafiku rrjedhës për përcaktimin e ndikimeve të mundshme të rëndësishme negative ndërkufitare për qëllimin e njoftimit




Burimi: ECE/CEP/9

Ne rastin e PMRRP:

- ❖ Aneksi II – PO
- ❖ Aneksi V: NUK DIHET (Vendi fqinj duhet të pozicionohet për impaktin)
- ❖ Aneksi VII: PO

Grafik
Konventa, hapat kryesorë të procedurës



Burimi: ECE/CEP/9

Ndërkohë nëse i referohemi hapave sipas Konventës, pasi është bërë njoftimi, ato në përgjithësi mund të paraqiten si më poshtë:

Secila nga fazat duhet të përgatitet paraprakisht dhe një plan i të gjithë procedurës duhet të parashtrohet paraprakisht për të ruajtur rezultatet përfundimtare. Legjisllacioni kombëtar luan një rol të rëndësishëm, por mund të kërkojnë detaje të fazave të procedurës për të thjeshtuar procedurën ndërkufitare. Detaje të tilla mund të marrin formën e dokumenteve të detajuara të politikave ose të rregullohen, shumë më përpara, rast pas rasti. Çështjet e hollësishme që duhen marrë parasysh janë përshkruar në Udhëzuesin për Zbatimin Praktik të Konventës Espoo.

Procesi i VSM ndërkufitare mund të inicohet nga secila prej Palëve të interesuara, domethënë, Pala e origjinës, e cila është vendi ku do të zhvillohet zhvillimi, ose Pala e prekur, e cila është vendi ku ndërtimi dhe ndërtimi dhe funksionimi i zhvillimit mund të ketë një ndikim.

Njoftimi zakonisht konsiderohet si hapi i parë për të filluar zbatimin e Konventës. Megjithatë, një sërë procedurash formale ose joformale mund të ndërmerren nga njëra ose të dyja palët e procesit për të përgatitur një hap të tillë, për shembull (edhe pse jo domosdoshmërisht në këtë renditje):

- a. **Ekzaminimi:** vendimi nëse një zhvillim i caktuar do të kalojë apo jo përmes procedurës ndërkufitare të VSM. Ky hap duhet të ndërmerret në mënyrë që të vendoset se kërkohet kontakt me palën tjetër. Në shumicën e rasteve përdoret lista e aktiviteteve të përfshira në Konventë ose në një marrëveshje dypalëshe. Në rastin e VSM të PMRRP të qarkut Shkodër ekziston Komisioni Teknik dhe Marrëveshja e 2019 midis Shqipërisë dhe Malit të Zi. Përkufizimet e disa aktiviteteve në Shtojcën I të Konventës mund të bëhen më të sakta bazuar në përvojën praktike nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe. Përkufizimi i "rëndësisë", vendimtar për çështjen e zbatimit të Konventës, ka qenë gjithmone çështje shqetësuese. Udhëzimet për termin "i rëndësishëm" mund të jepen nga ligji kombëtar ose në përmbajtjen e marrëveshjes dypalëshe. Bashkëpunimi i mirë ndërmjet vendeve dhe shkëmbimi i hershëm i informacionit rreth projekteve të mundshme janë thelbësore në këtë aspekt;
- b. **Njoftimi fillestar dhe konfirmimi i pjesëmarrjes:** në këtë fazë nevojiten një minimum rregullimesh institucionale për të ecur normalisht procesi, veçanërisht kur të dy vendet e përfshira delegojnë përgjegjësinë tek autoritetet e niveleve të ndryshme. Informacioni në lidhje me përcaktimin e autoriteteve që duhet të marrin pjesë në këto komunikime, marrëveshjet e detajuara për përkthimet dhe afatet kohore duhet të shkëmbehen ndërmjet Palëve. Faza në të cilën ky shkëmbim informacioni mund të ndodhë është gjithashtu i rëndësishëm dhe, ndërkohë që të gjitha Palët bien dakord që ai duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur, shpesh autoritetet bëhen të vetëdijshme për një zhvillim të propozuar vetëm kur të fillojë procedura e vendndodhjes, duke përfshirë VNSM e projekteve të vecanta. Duhet të merret parasysh se fillimi i një procedure kombëtare zakonisht përfshin fillimin e një procedure administrative, e cila duhet të përfundojë brenda një periudhe të caktuar, shpesh duke mos lejuar kohën shtesë të kërkuar për një procedurë ndërkufitare (e nevojshme për shkëmbime informacioni, konsultimet e brendshme brenda vendit të prekur, përkthimin, etj.);
- c. **Transmetimi i informacionit në lidhje me mjedisin potencialisht të prekur në Palën e prekur:** ky informacion duhet të vihet në dispozicion me kërkesë të Palës së origjinës, për t'u përdorur në përgatitjen e një VSM. Çështjet procedurale dhe kohore të përmendura më sipër zbatohen edhe në këtë rast;
- d. **Pjesëmarrja e publikut:** Konventa kërkon që publikut të Palës së prekur t'i jepet një mundësi e barabartë me atë që i jepet publikut të Palës së origjinës për të marrë pjesë në procedurë. Një çështje që kërkon hetim të mëtejshëm është mundësia e ankimit në një procedurë ndërkufitare. Aktualisht, për arsye procedurale, ankesat e shtetasve dhe rezidentëve të huaj janë shumë të kufizuara. Kur qëllimi dhe koha e përfshirjes së publikut ndryshojnë ndërmjet vendeve, problemi i reciprocitetit dhe ekuivalencës kërkon vëmendje të veçantë në marrëveshjet dypalëshe;

- e. **Përgatitja e dokumentacionit të VSM-së dhe shpërndarja e tij:** dokumentacioni i përgatitur në një procedurë ndërkufitare duhet të mbulojë të paktën pikat e renditura në Shtojcën II të Konventës. Më pas, dokumentacioni duhet të shpërndahet në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe t'u ofrohet për komente autoriteteve dhe publikut të Palës së prekur. Mënyra në të cilën rregullohet përkthimi i dokumentacionit, shpërndarja e tij dhe rrjedha e informacionit që rezultojnë ndërmjet Palëve të interesuara, ndikon drejtpërdrejt në efektivitetin e të gjithë procesit;
- f. **Konsultimet ndërmjet palëve:** për të siguruar një rrjedhë të qetë informacioni duke pasur parasysh ndryshimet në kërkesat dhe traditat kulturore në lidhje me vendimin;
- g. **Vendimi dhe transmetimi i vendimit përfundimtar:** vendimi përfundimtar merret në çdo rast nga autoriteti i Palës së origjinës, i cili ka detyrimin t'ia komunikojë këtë vendim dhe justifikimin e tij Palës së prekur;
- h. **Analiza pas projektit:** në disa sisteme kombëtare të VSM analiza pas projektit nuk është e detyrueshme dhe Palët e interesuara mund të kenë pikëpamje të ndryshme për nevojën për të. Marrëveshjet për një analizë pas projektit mund të jenë pjesë e një plani të përgjithshëm për një procedurë ndërkufitare ose mund të vendosen vetëm në fund.

Duke qenë se vende të ndryshme kanë procedura të ndryshme administrative dhe dispozita të VSM-së, **hapat e përcaktuar në Konventë** mund të përdoren për të krahasuar procedurat e tyre kombëtare, në mënyrë që të qartësohen ngjashmëritë dhe divergjencat.

Baza ligjore për marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe përcaktohet në nenin 8 të Konventës, e cila inkurajon Palët të përdorin marrëveshjet ekzistuese, si dhe të krijojnë marrëveshje të reja, në mënyrë që të përmbushin detyrimet e tyre sipas Konventës.

Elementë të këtyre marrëveshjeve janë propozuar në Shtojcën VI të Konventës. Ato përfshijnë:

- ✓ Marrëveshjet institucionale, administrative dhe të tjera në secilin prej Shteteve;
- ✓ Harmonizimi i politikave dhe masave dhe standardeve të mbrojtjes së mjedisit;
- ✓ Metodot e identifikimit, matjes, parashikimit dhe vlerësimit të ndikimeve dhe analizave pas zbatimit të projekteve specifike;
- ✓ Metodot dhe programet për mbledhjen, analizën, ruajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave të krahasueshme në lidhje me cilësinë e mjedisit;
- ✓ Përcaktimi i niveleve të pragut dhe kriterëve të specifikuar për përcaktimin e rëndësisë së ndikimeve ndërkufitare;
- ✓ Vlerësimi i përbashkët, programet e monitorimit, ndërkalibrimi i pajisjeve monitoruese dhe harmonizimi i metodologjive;
- ✓ Aspekte procedurale se si të përfshihet publiku i Palës së prekur; paraqitjen e komenteve; dëgjimet publike dhe konsultimet ndërmjet Palëve (pjesëmarrësit, subjektet); vendimi (si të pasqyrohen komentet e autoriteteve dhe publikut, publikimi, mundësitë e ankimimit); analiza pas projektit; parandalimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve; VSM e përbashkët; përkthimi; aspektet financiare.

Informacioni minimal që duhet të përgatitet dhe t'u komunikohet Palëve të tjera për një zbatim efektiv të Konventës përfshin:

- ✓ Autoritetet përgjegjëse për VSM;

- ✓ Autoritetet që do të përfshihen në fazat e ndryshme të procesit të VSM (me një tregues se kush bën çfarë);
- ✓ Një grafik që përshkruan fazat e ndryshme dhe kornizat kohore të procesit kombëtar të VSM.

Gjithashtu konsiderohet e dobishme të ketë:

- a. Takime të rregullta të ekspertëve (mundësisht si një grup i përbashkët ekspertësh) për të diskutuar statusin aktual dhe ndryshimet e parashikuara në legjislacion dhe procedura; një zgjidhje e tillë ndihmon në krijimin e një marrëdhënie pune dhe lehtëson punën e ardhshme në afate të ngushta;
- b. Akses në informacionin mjedisor, duke përfshirë standardet mjedisore, nivelet e ndotjes në sfond dhe vendndodhjen e zonave të mbrojtura.

Koha mbetet një faktor i diskutueshëm: përderisa Pala e origjinës është e detyruar nga koha e procedurave të saj administrative dhe duhet të përmbushë të drejtën e zhvilluesit për të marrë një përgjigje për aplikimin e tij në kohën e duhur, kurse pala e prekur duhet të ketë kohë të mjaftueshme. të konsultohet me autoritetet e saj dhe të lejojë pjesëmarrjen e publikut. Koha e vendimmarrjes mund të ndikojë gjithashtu në të drejtën e publikut të Palës së prekur për të apeluar.

Përkthimi i dokumenteve është gjithashtu një çështje e rëndësishme. Në këtë rast kriteret e përfshira përfshijnë kostot, kohën dhe cilësinë. Edhe pse shumica e dokumenteve ofrohen nga Pala e origjinës për informacionin e Palës së prekur, fluksi i informacionit është në të dy drejtimet. Mund të jetë gjithashtu e vlefshme që të sigurohen dy rryma komunikimi: të tilla si komunikimet e drejtpërdrejta ndërmjet autoriteteve të përfshira, të cilat mund të përdorin një gjuhë të mirëkuptueshme, dhe komunikimi me publikun, i cili patjetër duhet të përkthehet. Probleme shtesë mund të lindin në zonat ku pakicat e rëndësishme etnike ose gjuhësore përdorin një gjuhë që është e ndryshme nga gjuha zyrtare e vendit dhe gjuha e përdorur nga administrata.